Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Prishtinë, 2020

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Prishtinë, 2020

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është rishikuar dhe plotësuar nga:

-	Lah Nitaj	AKK
-	Milot Hasangjekaj	AKK
-	Bleta Kadriu	AKK
-	Kaltrina Mulliqi	AKK
-	Donjeta Nimani Binçe	AKK
-	Anita Rukovci	AKK
-	Avni Gashi	AKA
-	Teuta Danuza	Konsulente e jashtme

Procesi i rishikimit të dokumentit të KKK u mbështet nga:
DVV International Country Office Kosovo

DVV International

Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

Përmbajtja:

1. Hyrje....11

2. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve....15

2.1 Përshkrim i përgjithshëm i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve....15
2.2 Roli i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për KKK....16
2.2.1 Përgjegjësitë institucionale për KKK....17
2.3. Dimensioni evropian i KKK....18
2.3.1 Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK)....18
2.3.2 Sistemi Evropian i Kredive....19
2.3.3 Korniza Evropiane Referuese për Sigurim të Cilësisë për AAP (KERSC - EQARF)....19
2.3.4 Korniza për Kualifikime në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (KKHEAL)....20
2.4 Struktura e sistemit të kualifikimeve në Kosovë....20
2.4.1 Fushat kryesore të arsimit dhe aftësimit në Kosovë....20
2.4.2 Çka është një kualifikim?....21
2.4.3 Certifikata e arritshmërisë, certifikata dhe diploma....22
2.4.4 Llojet e kualifikimeve në KKK....22
2.4.5 Struktura modulare e kualifikimeve....31
2.4.6 Rregullat e kombinimit të moduleve brenda kualifikimeve....32
2.4.7 Vlera e kredive në module dhe kualifikime....33

3. Nivelet e KKK....37

3.1 Nivelet e kualifikimit....37
3.2. Vendosja e kualifikimeve në nivelet e KKK....38
3.3 Përparimi dhe transferimi në KKK....50
3.3.1 Fushëveprimi i KKK....50
3.3.2 Konceptet për qasje, përparim dhe transferim në KKK....51
3.3.3 Rrugët e përparimit....52
3.3.4 Qasja në arsim dhe aftësim për kandidatë me aftësi të kufizuara....52

4. Zhvillimi i kualifikimeve sipas KKK....55

4.1 Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm....55
4.2.Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit dhe aftësimit profesional....55
4.2.1 Kriteret e AKK për validimin e kualifikimeve profesionale për përfshirje në KKK....56
4.3 Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit të lartë....57

5. Sistemi i Kredive....61

5.1 Zhvillimi i sistemit të kredive për AAP në Kosovë....61
5.2 Qëllimi i sistemit të kredive....61
5.2.1 Integrimi i sistemit të kredive në KKK....61

5.2.2 Çka është kredia?....62
5.2.3 Shfrytëzimi i marrëveshjes së pikëve të kredive për ndarjen e vlerës së kredisë në kualifikime dhe module....63
5.2.4 Vlera e kredisë si numër i plotë....64
5.2.5 Dizajnimi i kualifikimeve për akumulim dhe transferim të kredive....64
5.2.6 Kush mund të hartojë kualifikime dhe të caktojë kredi?....64
5.2.7 Si ndahet kredia?....65
5.2.8 Regjistrimi i kredive....66
5.2.9 Si transferohen kreditë....66

6. Njohja e mësimit paraprak....71

6.1 Synimet e NjMP-së....72
6.2 Procesi i NjMP-së....72
6.3 Sigurimi i cilësisë së NjMP-së....74
6.4 Kostoja e procesit të NjMP-së....75

7. Standardet në KKK....79

7.1 Standardet për kualifikimet e AAP....79
7.2 Standardet e profesionit....79
7.2.1 Përkufizimi i standardeve të profesionit....79
7.3 Metoda e analizës funksionale....81
7.4 Metoda DACUM 81
7.5 Parimet për zhvillimin e standardeve të profesionit....83
7.6 Formati i kualifikimit profesional....85

8. Vlerësimi dhe certifikimi në KKK....89

8.1 Vlerësimi i kualifikimeve të AP-së....89
8.2 Vlerësimi i kualifikimeve profesionale....89
8.2.1 Funksioni i vlerësuesve....91
8.2.2 Procesi i vlerësimit....91
8.3.3 Metodat e vlerësimit....92
8.2.4 Ofrimi i kushteve për vlerësim për kandidatët me aftësi të kufizuara....94
8.2.5 Mbledhja e dëshmive....94
8.2.6 Gjykimi dhe regjistrimi i rezultateve të vlerësimit....96
8.2.7 Ankesat....97
8.2.8 Certifikimi....97
8.3 Vlerësimi i kualifikimeve të arsimit të lartë....98

9. Rregullimi i kualifikimeve dhe institucionet në KKK....101

9.1 Vendosja e kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm në KKK....101
9.2 Vendosja e kualifikimeve të AAP në KKK....101
9.3 Vendosja e kualifikimeve të arsimit të lartë në KKK....104

10. Sigurimi i cilësisë në KKK.....109

10.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë.....109
10.1.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin e përgjithshëm.....109
10.1.2 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional.....110
10.1.3 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin e lartë.....111

11. Monitorimi 117

11.1 Monitorimi i insitucioneve të arsimit të përgjithshëm.....117
11.2 Monitorimi i insitucioneve të AAP 117
11.3 Monitorimi i insitucioneve të AL.....118

12. Fjalori i termave.....121

Shtojcë: Grupi punues për rishikimin e KKK.....126

Lista e shkurtesave

QEZTP	Qendra Evropiane për Zhvillim të Trajnimit Profesional
KAAP	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
KE	Komisioni Evropian
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
SETKAAP	Sistemi Evropian për Transferim të Kredisë për Arsimin & Aftësimin Profesional
KEK	Korniza Evropiane për Kualifikime
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
UE	Unioni Evropian
IPA	Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (i UE-së)
KSNA	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim për Arsimin e Lartë
HFP	Hulumtimi i Fuqisë Punëtore
MGjGjJ	Mësimi Gjatë Gjithë Jetës
MAShT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata Joqeveritare
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
SC	Sigurimi i Cilësisë
NVM	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
AT	Asistencë Teknike
ANT	Analizë për Nevoja të Trajnimit
TR	Termat e Referencës
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

HYRJE

HYRJE

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është hartuar në vitin 2011 nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), me mbështetjen e projektit "EU KOSVET -V-" dhe me financim nga Bashkimi Evropian (BE).

Hartimi i KKK është bërë nga stafi i AKK, i mbështetur nga ekspertë dhe konsulentë të ndryshëm. Në këtë proces kanë dhënë kontribut edhe aktorë relevantë si: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ministritë e linjës: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave. Poashtu, ndihmë kanë dhënë edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, HandiKos-i, Shkollat profesionale, Universitetet publike, Kolegjet private, Qendrat e aftësimit profesional dhe partnerët tjerë socialë. Mbështetje kanë dhënë organizatat e ndryshme evropiane dhe partnerët tanë zhvillimorë.

Rishikimi dhe plotësimi i KKK ka filluar në vitin 2017. Dokumenti i rishikuar dhe i plotësuar i KKK përfshinë ndryshimet dhe zhvillimet në sistemin kombëtar të kualifikimeve në përshtatje me nevojat e tregut të punës në Kosovë dhe në linjë me politikat dhe zhvillimet në BE.

Rishikimi dhe plotësimi i këtij dokumenti është përkrahur nga "DVV International" - Zyra në Kosovë.

KKK është aprovuar nga Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në vitin 2019.

AKK në vazhdimësi do të kujdeset për implementimin e KKK në Kosovë si dhe do ti adresojë kërkesat dhe nevojat e sistemit kombëtar të kualifikimeve në të ardhmen.

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

2. KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është një komponentë e rëndësishme e sistemit të kualifikimeve në Kosovë dhe ndihmon procesin e reformave në këtë fushë. Me të synohet që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, por edhe përmbushja e kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë në vendin tonë.

KKK promovon ngritjen e cilësisë në arsim dhe aftësim, duke zhvilluar kualifikime të cilat janë të bazuara në standarde të krahasueshme ndërkombëtare. KKK ofron transparencë të sistemit të kualifikimeve kombëtare, duke qartësuar llojet dhe tipat e kualifikimeve dhe ndërlidhjen e tyre. KKK mbështet procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke ofruar qasje dhe përparim të vazhdueshëm si dhe promovon punësimin nëpërmjet vlerësimit dhe certifikimit si dhe nëpërmjet njohjes së mësimit paraprak.

KKK shërben si bazë për bashkëpunim dhe njohje reciproke ndërmjet kualifikimeve të KKK në Kosovë dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

2.1 Përshkrim i përgjithshëm i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve dhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve janë themeluar në bazë të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060). Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka Këshillin Drejtues (KD), i përbërë nga 13 anëtarë që përfaqësojnë ministritë relevante, universitetet publike, partnerët socialë, organizatat joqeveritare dhe ofrues privatë. KD mban përgjegjësinë për politikat zhvillimore dhe vendimmarrjen lidhur me KKK-në.

KKK përbëhet prej tetë niveleve të kualifikimeve. Secili nivel i KKK është i përcaktuar me përshkrues të niveleve. Përshkruesit e niveleve janë të ndarë në tri komponentë: njohuri, shkathtësi dhe kompetenca.

KKK përfshinë të gjitha llojet e kualifikimeve, ku secili nivel përmban kualifikime të tipave dhe përmbajtjeve të ndryshme të cilat zhvillohen për qëllime dhe nevoja të ndryshme.

Një kualifikim në KKK është i definuar sipas Ligjit për kualifikimet si: "Njohje zyrtare e të arriturave me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimit, ose realizimi i kënaqshëm në një test apo provim". Për t'u përfshirë në KKK të gjitha kualifikimet duhet të bazohen në rezultatet e të nxënit dhe duhet të jenë subjekt i vlerësimit të sigurimit të cilësisë.

Varësisht nga lloji i kualifikimit, vendosja në një nivel të KKK bëhet nëpërmjet procesit të validimit dhe akreditimit. Çdo kualifikim/modul ka një vlerë të kredisë bazuar në sistemin e kredive ECTS dhe ECVET. Kualifikimet e KKK ofrohen vetëm nga institucionet e akredituara, përveç kualifikimeve të cilat i takojnë llojit të kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm.

Të nxënit që shpie në këto kualifikime mund të fitohet në kontekste formale, joformale dhe informale. Ndërsa, vlerësimi dhe certifikimi i kualifikimeve bëhet nëpërmjet institucioneve si: Shkollat e mesme të ulëta, gjimnazet dhe shkollat profesionale, qendrat për aftësim profesional, ndërmarrjet, ofruesit privatë të arsimit dhe aftësimit, institucionet profesionale postsekondare, universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë.

Vlerësimi dhe certifikimi i kualifikimeve/moduleve në KKK iu nënshtrohen mekanizmave të sigurimit të cilësisë për t'u siguruar se procesi i vlerësimit dhe certifikimit është korrekt dhe objektiv, fleksibil dhe i besueshëm, transparent dhe praktik.

Sigurimi i cilësisë përbëhet nga mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Mekanizmat e brendshëm zhvillohen dhe zbatohen nga vetë institucioni i cili ofron, vlerëson dhe certifikon kualifikime, ndërsa, mekanizmat e jashtëm të cilësisë varësisht nga lloji i kualifikimit zhvillohen dhe zbatohen nga AKK, AKA dhe MAShT.

Secili kualifikim në KKK shpie në një certifikatë apo diplomë. Të gjitha certifikatat dhe diplomat përmbajnë të dhëna të caktuara si dhe dokumente shtesë si certifikata/diploma plotësuese të cilat e specifikojnë përmbajtjen e një kualifikimi.

Implementimi i KKK realizohet përmes këtyre funksioneve:

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja;
- Verifikimi i standardeve të profesionit;
- Validimi i kualifikimeve për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve;
- Akreditimi i institucioneve për ta zbatuar njohjen e mësimit paraprak (NjMP);
- Monitorimi i institucioneve të akredituara.

2.2 Roli i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për KKK

AKK ka përgjegjësinë e zhvillimit strategjik të KKK. Ligji për Kualifikimet Kombëtare i jep AKK përgjegjësinë për rregullimin e KKK (neni 14). Neni 3, paragrafi 2 i këtij ligji, thekson se "Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, i themeluar me dispozitat e këtij ligji, krijon dhe kujdeset për kornizën gjithëpërfshirëse të kualifikimeve".

AKK është përgjegjëse për:

- Përcaktimin e niveleve të Kornizës, llojet dhe tipat e kualifikimeve të aprovuara në KKK;
- Sigurimin e përputhshmërisë me KEK;
- Përcaktimin e kritereve dhe procesin e verifikimit të standardeve të profesionit;
- Përcaktimin e kritereve dhe procesin e validimit të kualifikimeve për përfshirje në KKK;
- Përcaktimin e kritereve dhe procesin e akreditimit të institucioneve për ofrimin e kualifikimeve në KKK;
- Përcaktimin e kritereve dhe procesin e akreditimit të institucioneve për zbatimin e NjMP;
- Përcaktimin e kritereve dhe procesin e monitorimit të institucioneve të akredituara;
- Verifikimin dhe vulosjen e certifikatave dhe diplomave të lëshuara për kualifikime/module në KKK;
- Këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmerisë dhe barasvlerës.

2.2.1. Përgjegjësitë institucionale për KKK


Ligji për Kualifikime Kombëtare (neni 3, paragrafi 3) përcakton se përgjegjësitë e AKK në raport me zbatimin e KKK janë të përbashkëta me institucionet e tjera: "Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve i krijuar sipas dispozitave të këtij ligji rregullon edhe dhënien e kualifikimeve brenda Kornizës, me përjashtim të kualifikimeve të cilat rregullohen me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe kualifikimet që rregullohen saktësisht edhe me dispozitat e ligjeve të tjera".

Përgjegjësitë implementuese për KKK janë të përbashkëta për tri institucione:

- AKK për kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional;
- MAShT për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm;
- AKA për kualifikimet e arsimit të lartë.

Institucionet gjegjëse AKK, AKA dhe MAShT kanë role të ndara në lidhje me zhvillimin, validimin dhe akreditimin e llojeve të veçanta të kualifikimeve. Ky është një parim i rëndësishëm i menaxhimit të KKK sepse këto role dhe përgjegjësi përcaktohen sipas llojit të kualifikimit dhe nivelit të kualifikimit.

Struktura e menaxhimit të KKK është e prezantuar në diagramin në vijim:



2.3. Dimensioni evropian i KKK

KKK ofron bazë për bashkëpunim dhe njohje reciproke ndërmjet Kosovës dhe vendeve evropiane duke siguruar përputhshmëri me:

• Kompetencat kryesore për të mësuarit gjatë gjithë jetës;
• Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësim gjatë gjithë jetës (KEK) dhe Kornizën për Kualifikime në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (KKHEAL);
• Sistemin Evropian të Kredive për Arsim dhe Aftësim Profesional (ECVET) si dhe Sistemin Evropian për Akumulim dhe Transferim të Kredive (ECTS);
• Kornizën Evropiane Referuese për Sigurimin e Cilësisë, për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (KERSCAAP) si dhe Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë (SUESCFAL);
• Klasifikimin ndërkombëtar të standardeve të profesionit (KNSP);
• Pakon e dokumenteve Europass për transparencën e diplomave, certifikatave dhe kompetencave.
AKK ndjek zhvillimet ndërkombëtare në lidhje me kornizat e kualifikimeve dhe siguron që KKK ti përvetësojë praktikat më të mira në zhvillim, zbatim dhe menaxhim.

2.3.1 Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK)

Korniza Evropiane e Kualifikimeve zyrtarisht është prezantuar në vitin 2008 dhe ka tetë nivele.
KEK është një mjet reference që përdoret për ti ndërlidhur sistemet e kualifikimeve të shteteve të ndryshme evropiane dhe shërben si një mjet për ti bërë kualifikimet më të krahasueshme dhe më të kuptueshme nga vendet dhe sistemet e ndryshme evropiane.

KEK ka dy qëllime kryesore:
• Nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe krijon mundësi të barabarta në shoqëri të bazuar në dije;
• Bën integrimin e tregut evropian të punës, duke respektuar diversitetin e sistemeve arsimore kombëtare të shteteve të ndryshme.

Komisioni Evropian (KE) ka rekomanduar shtetet anëtare të BE-së që ti ndërlidhin sistemet kombëtare të kualifikimeve me KEK duke i zhvilluar kornizat kombëtare të kualifikimeve në pajtim me legjislacionin dhe praktikat kombëtare.

Në fund të vitit 2016 është bërë referencimi apo lidhja zyrtare e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Kjo është bërë një vit pas anëtarësimit të Kosovës në grupin këshillëdhënës të KEK.

Referencimi apo lidhja zyrtare e KKK me KEK është rezultat i procesit katërvjeçar të përpilimit të raportit të referencimit nën udhëheqjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Raporti është hartuar në përputhje me metodologjinë dhe kriteret rigoroze të KEK dhe është rezultat i një procesi të gjatë konsultativ me të gjitha palët e interesit, përfshirë ekspertët ndërkombëtarë.

Referencimi do të thotë se sistemi ynë i arsimit dhe aftësimit është transparent, i qartë dhe i besueshëm për shtetet anëtare të BE-së dhe mundëson që kualifikimet e programeve të studimeve dhe trajnimeve, të jenë të krahasueshme nëpërmjet KEK me kualifikimet e vendeve të BE-së.

Ky proces e lehtëson njohjen dhe qasjen e të rinjve tanë të kualifikuar në tregun rajonal dhe evropian të punës dhe ofron mundësi vazhdimi të arsimimit dhe aftësimit të mëtejmë.
Njohja dhe krahasueshmëria e diplomave dhe certifikatave vlen vetëm për kualifikimet që janë pjesë e KKK dhe ofrohen nga institucionet e akredituara nga AKK dhe AKA.

2.3.2 Sistemi Evropian i Kredive

Sistemi Evropian i Kredive për Arsim dhe Aftësim Profesional (SEKAAP - ECVET) është zhvilluar nga shtetet anëtare të BE-së dhe Komisioni Evropian për ta bërë më të lehtë njohjen e rezultateve të të nxënit të arritura nga individët, në kontekste të ndryshme të mësimit apo nëpërmjet periudhave të mësimit dhe aftësimit profesional jashtë vendit.
ECVET është mekanizëm vullnetar dhe i decentralizuar i cili synon një zonë evropiane pa kufij për mësim gjatë gjithë jetës, duke ua lehtësuar individëve njohjen, transferimin dhe akumulimin e vlerësimeve drejt kualifikimeve. ECVET ka për qëllim njohjen e përvojave dhe llojeve të mësimit në institucione dhe vende të ndryshme. ECVET i përshkruan kualifikimet në kuadër të moduleve të rezultateve të të nxënit të cilat do të vlerësohen dhe validohen.
Sistemi Evropian për Akumulimin dhe Transferimin e Kredive (ECTS) në arsimin e lartë fokusohet te studentët me qëllim të grumbullimit dhe transferimit të kredive, bazuar në parimin e transparencës së proceseve të mësimit, mësimdhënies dhe vlerësimit.
Qëllimi i ECTS-së është ta lehtësojë planifikimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e programeve të studimit dhe lëvizjen e studentëve duke njohur arritjet e mësimit dhe kualifikimet si dhe periudhat e të nxënit.
Europass është një tërësi prej pesë dokumenteve (CV, pasaporta e gjuhëve, lëvizshmëria-Europass, certifikata plotësuese dhe diploma plotësuese) që synojnë ti bëjnë aftësitë dhe kualifikimet më të qarta dhe të kuptueshme në Evropë.

2.3.3 Korniza Evropiane Referuese për Sigurim të Cilësisë për AAP (KERSC-EQARF)

Korniza Evropiane Referuese për Sigurim të Cilësisë për Arsim dhe Aftësim Profesional është zhvilluar nga shtetet anëtare dhe BE-së, për të shërbyer si instrument i referimit dhe për të ndihmuar në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të AAP. KERSC synon ta inkurajojë besimin e ndërsjellë në AAP brenda një hapësire pa kufij.

KERSC mbështet strategjinë për mësim gjatë gjithë jetës, integrimin e tregut evropian dhe promovon kulturën e përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet, duke respektuar shumëllojshmërinë e sistemeve kombëtare të arsimit.

KERSC është hartuar që ti ndihmojë shtetet anëtare që ta promovojnë dhe monitorojnë përmirësimin e cilësisë në AAP dhe ta sigurojë bazën e përbashkët për parimet e cilësisë, kriteret e referimit dhe treguesit e performancës. Kjo konsiderohet si një instrument që mund ti ndihmojë politikëbërësit për ta pasur një pasqyrë më të mirë lidhur me funksionimin e modeleve aktuale të sigurimit të cilësisë, identifikimit, përmirësimit dhe vendimmarrjes së bazuar në referencat e përbashkëta.

KERSC përbëhet nga një strukturë dhe metodologji e cila bazohet në procesin e vetëvlerësimit të kombinuar me vlerësimin e jashtëm të cilësisë.

2.3.4 Korniza për Kualifikime në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (KKHEAL - QF-EHEA)

Korniza për Kualifikime në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë ka tri cikle të kualifikimeve në arsimin e lartë të përcaktuara në kuadër të kualifikimeve dhe Sistemit Evropian për Akumulim dhe Transferim të Kredive (ECTS). Një vit akademik korrespondon me 60 pikë të kredive ECTS. Një vit akademik kryesisht ka 1500 - 1800 orë mësimi.

Ciklet e kualifikimeve janë:

- Cikli i 3-të: nuk ka ECTS të definuar - Shkalla e doktoratës
- Cikli i 2-të: zakonisht 60-120 ECTS kredi - Shkalla master
- Cikli i 1-rë: 180-240 ECTS kredi - Shkalla bachelor
- Cikli i shkurtër brenda ciklit të 1-rë: zakonisht përfundon me 120 kredi ECTS - kualifikim i cili është më i ulët sesa shkalla bachelor

Sipas procesit të Bolonjës, sistemet e arsimit të lartë në shtetet evropiane duhet të organizohen në mënyrë të tillë që, të mundësojnë lëvizje më të lehtë të studentëve nga njëri vend në tjetrin brenda Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Secili shtet, lëshon diplomat apo dokumentet e tjera përcjellëse sipas Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve përkatëse dhe kritereve të Bolonjës.

Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ka zhvilluar "Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurim të Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë" të mbështetur nga Komisioni Evropian. ENQA është një organizatë ombrellë e cila përfaqëson organizata të sigurimit të cilësisë nga vendet anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). ENQA promovon bashkëpunimin evropian në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe shpërndan informacione dhe ekspertizë midis anëtarëve të saj dhe ndaj palëve të interesuara në mënyrë që të zhvillojë dhe shkëmbejë praktika të mira dhe ta nxisë dimensionin evropian të sigurimit të cilësisë.

2.4 STRUKTURA E SISTEMIT TË KUALIFIKIMEVE NË KOSOVË


2.4.1 Fushat kryesore të arsimit dhe aftësimit në Kosovë

Sistemi i arsimit dhe aftësimit në Kosovë përbëhet nga:

- Arsimi parashkollor dhe parafillor: (mosha 0-6 vjeç);
- Arsimi fillor (klasat 1-5);
- Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9);
- Arsimi i mesëm i lartë (gjimnazet dhe shkollat profesionale/qendrat e kompetencës klasat 10-12);
- Arsimi dhe aftësimi profesional postsekondar;
- Arsimi i lartë (universitetet dhe kolegjet);
- Aftësimi profesional (qendrat e kompetencës, shkollat profesionale, qendrat për aftësim profesional);
- Arsim për shkrim lexim bazik, kompensues për të rritur, për ata të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin fillor (klasat 1-5), të ofruar kryesisht nga OJQ-të dhe nga shkollat në koordinim me MAShT-DKA;

• Aftësim profesional specifik për persona me aftësi të kufizuar të ofruar nga qendrat burimore apo qendrat e aftësimit;
• Aftësim profesional i mësimdhënësve dhe stafit udhëheqës të shkollave për punën në shkollë dhe programet me të rritur të ofruar nga institucionet e aprovuara nga MAShT;
• Si dhe lloje të tjera të aftësimit, si: gjuhë, artizanale, arte, muzikë, kulturë, etj. që ofrohen nga ofrues të ndryshëm.

Diagrami i mëposhtëm tregon fushat kryesore të arsimit dhe aftësimit, kualifikimet dalëse në çdo fushë dhe mundësitë/rrugët për përparim.



2.4.2 Çka është një kualifikim?

Ligji për Kualifikimet Kombëtare e definon kualifikimin si: "Njohje zyrtare e të arriturave me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimit, ose realizimi i kënaqshëm në një test ose provim".

Kualifikimet në KKK mund të shërbejnë për më shumë se një qëllim si për:

• Zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive në fusha të ndryshme profesionale dhe përgatitjen për arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm;
• Zhvillimin personal dhe ndërlidhjen me të mësuarit;
• Përgatitjen për punësim;
• Aprovimin e kompetencave profesionale, etj.

2.4.3 Certifikata e arritshmërisë, certifikata dhe diploma

Për modulet/kualifikimet e arritura në KKK jepen: Certifikata e arritshmërisë, Certifikata dhe Diploma. Këto kategori të certifikimit janë dokumente zyrtare të lëshuara për nxënës/kandidatë/studentë të cilët i janë nënshtruar me sukses vlerësimit të rezultateve të të nxënit të modulit/kualifikimit. Ato mund të arrihen me anë të mësimit formal, joformal apo nga njohja e mësimit paraprak.

Certifikata e arritshmërisë

Certifikatat e arritshmërisë përmbush dy qëllime:
(i) kandidatët të cilët nuk janë në gjendje ti përfundojnë të gjitha modulet e një kualifikimi të plotë në një kohë të caktuar për arsye të ndryshme;
(ii) kandidatët të cilët kanë kualifikimin e plotë, por kanë nevojë ose dëshirojnë të marrin module për ti avancuar njohuritë dhe aftësitë profesionale.

Certifikatat e arritshmërisë jepen për kualifikime të pjesshme, për kandidatë të cilët i janë nënshtruar me sukses vlerësimit të rezultateve përkatëse të të nxënit në përputhje me KKK.

Certifikata

Përgjithësisht certifikata mund të jepet për çdo nivel në kornizë. Certifikata për nivelet 5 dhe më lart mund të ketë vlerë të kredive me më pak se 120 kredi ECTS/ECVET (më pak se dy vjet të plota të studimeve teorike dhe praktike).
Certifikata për nivelet 1-4 mund të ketë vlerë të ndryshme të kredive varësisht nga madhësia e kualifikimit.

Diploma

Niveli dhe vlera e kredive të diplomës bachelor, master dhe të doktoratës përcaktohen nga Ligji për Arsimin e Lartë. Diploma për nivelin 5 duhet të ketë vlerë ekuivalente së paku 120 kredi ECTS/ECVET (së paku dy vjet të plota të studimeve teorike dhe praktike).
Diplomat mund të jepen vetëm për nivelin 4 ose më lart të kornizës.
Diploma për kualifikimet e kombinuara në nivelin 4 duhet të ketë vlerë të kredive ekuivalente me së paku 180 kredi ECVET (tri vjet të plota të studimeve teorike dhe praktike).
Për diplomat e kualifikimeve të përgjithshme në nivelin 4 kërkohen së paku tri vjet të plota të studimeve teorike dhe praktike.

2.4.4 Llojet e kualifikimeve në KKK

Qasja gjithëpërfshirëse e KKK nënkupton se ajo përfshinë të gjitha llojet dhe titujt e kualifikimeve. Përcaktimi i kualifikimeve sipas llojeve, titujve dhe sipas niveleve i bënë më të kuptueshme për:

• Krahasimin e kualifikimeve;
• Ndërlidhjen e kualifikimeve të sistemit të arsimit dhe aftësimit me tregun e punës;
• Identifikimin e shtigjeve të kualifikimeve dhe mundësitë për përparim dhe transferim.

Neni 5, paragrafi 1.2 i Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, thekson se transparenca arrihet "duke e bërë të qartë natyrën e kualifikimeve dhe marrëdhënien ndërmjet kualifikimeve dhe ofrimin e bazës për krahasimin e të gjitha të arriturave në nivelet e sistemit të arsimit dhe aftësimit".

Për regjistrim në kornizë, të gjitha kualifikimet dhe modulet duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare dhe ti plotësojnë kërkesat minimale të AKK për aprovim.

Llojet e kualifikimeve përcaktohen në bazë të rezultateve, nxënësit/kandidatët e synuar, karakteristikat dhe veçoritë e tjera, si:

• Rezultatet përfshijnë; rezultatet e arsimit të përgjithshëm, njohuri ose shkathtësi të një fushe profesionale, punë apo profesion specifik, shkathtësi të përgjithshme, shkathtësi bazë apo kompetenca kyçe;
• Qëllimet përfshijnë; përgatitje për mësim të mëtutjeshëm, hyrje në tregun e punës, fusha profesionale ose roli i punës specifike, zgjerimi i përvojës profesionale (për më shumë përgjegjësi ose për përvetësim të ndryshimeve teknologjike) etj.;
• Nxënësit/kandidatët e synuar përfshijnë; të rinjtë në shkollë, të papunët, të rriturit që kërkojnë të rikualifikohen, të punësuarit të cilët kërkojnë të përfitojnë shkathtësi të reja etj.;
• Karakteristikat përfshijnë; madhësinë, nivelin, gjerësinë dhe përmbajtjen e kualifikimit, ose kombinimin e këtyre faktorëve.

Ekzistojnë 6 lloje të kualifikimeve në KKK:

• Kualifikimet e Arsimit të Lartë (A)
• Kualifikimet e Arsimit të Përgjithshëm (B)
• Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C)
• Kualifikimet Kombëtare Profesionale (D)
• Kualifikimet e Bazuara në Standarde Ndërkombëtare (E)
• Kualifikimet e Përshtatura (F)

Kualifikimet e Arsimit të Lartë

Karakteristikat e kualifikimeve të arsimit të lartë janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen në përputhje me rregullat e Kornizës së Bolonjës;
•Qëllimi i kualifikimeve ndryshon. Ato u mundësojnë studentëve që ti ndjekin studimet akademike, të fitojnë nivel më të lartë të njohurive dhe shkathtësive dhe kompetencave personale dhe profesionale;
• Përmbajtja e këtyre kualifikimeve bazohet në fushat akademike ose profilet profesionale të nivelit më të lartë;
• Këto kualifikime mund të jenë të vendosura në nivele 5 deri 8 të KKK, të cilat kanë vlerë të kredive ECTS në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë;

• Përveç Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, ato rregullohen edhe me Ligjin për Arsimin e Lartë;
• Këto kualifikime ofrohen nga institucionet e akredituara nga AKA.

Titujt e kualifikimeve të arsimit të lartë janë:

- Cikli i shkurtër i arsimit të lartë;
- Bachelor;
- Master;
- Doktoratë

Përshkrimi i titujve në arsimin e lartë

Cikli i shkurtër i arsimit të lartë
Niveli - Ky cikël është në nivelin 5
Përmbajtja: Ndërlidhen me nivelin ekzistues Bachelor dhe sigurojnë përparim në programet e nivelit Bachelor e më lart. Në raste të caktuara mund të kërkohen njohuri dhe shkathtësi të veçanta për pranim në nivelin Bachelor ose më lart.

Vlera kredive: Varësisht nga kualifikimi (certifikatë apo diplomë) ato kanë vlerë më pak apo 120 kredi ECTS.

Niveli Bachelor
Niveli - Këto diploma janë në nivel të 6 të kualifikimeve në KKK
Vlera e kredive - Kanë vlerë prej 180 deri në 240 kredi ECTS.

Niveli Master
Niveli - Këto diploma janë në nivel të 7 të kualifikimeve në KKK
Vlera e kredive - Kanë vlerë prej 60 deri në 120 kredi ECTS.

Niveli i Doktoratës
Niveli - Këto diploma janë në nivel të 8 të kualifikimeve në KKK
Vlera e kredive - Nuk kanë vlerë të përcaktuar të kredive për këto kualifikime.

Titujt e ciklit të shkurtër në arsimin e lartë përbëhen nga emri dhe lloji i kualifikimit, niveli dhe fusha kryesore e studimit. Shembull: Certifikatë në Arsimin e Lartë në Administrim Biznesi - niveli 5 ose Diplomë për ciklin e shkurtër në Arsimin e Lartë në Administrim Biznesi - niveli 5.

Titulli i të tri niveleve duhet ta përmbajë emrin dhe llojin e kualifikimit, nivelin dhe fushën e studimit (psh. fusha e arteve, shkencave, inxhinierisë, drejtësisë, hulumtimit) dhe fusha kryesore të studimit.

Shembull: Bachelor i Arteve në Politikë dhe Ekonomi, Bachelor i Shkencave të Aplikuara në Bujqësi, Master i Arteve në Administrim Biznesi, Master i Kërkimeve në Psikologji Sociale, Doktor i Inxhinierisë, etj.

Kualifikimet e arsimit të përgjithshëm

Karakteristikat e kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës;
• Qëllimi i tyre është që nxënësit ta vazhdojnë arsimin e lartë dhe të fitojnë nivel më të lartë të njohurive dhe shkathtësive dhe kompetencave personale dhe profesionale;
• Përmbajtja e kualifikimeve bazohet në lëndët shkollore dhe kompetenca ndërkurrikulare;[1]
• Këto kualifikime mund të vendosen në nivelet 1, 2, 3 dhe 4 të KKK dhe nuk kanë vlerë të kredive;
• Përveç Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, ato rregullohen me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore sipas legjislacionit në fuqi;
• Ato ofrohen nga institucionet publike dhe private dhe mbikëqyren nga MAShT dhe DKA.

Titujt e kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm janë:

- Dëftesa e kryerjes së arsimit fillor;
- Dëftesa e arsimit të mesëm të ulët;
- Diploma e kryerjes së arsimit të mesëm të lartë dhe Certifikata e Maturës.

Përshkrimi i titujve

Dëftesa e kryerjes së arsimit fillor
Niveli - Ky kualifikim është në nivelin 1 në KKK
Përmbajtja - Bazohet në Kornizën Kurrikulare të Kosovës
Vlera e kredive - Për momentin asnjë vlerë e kredive nuk jepet për këtë kualifikim.

Dëftesa e kryerjes së Arsimit të Mesëm të Ulët
Niveli - Këto kualifikime janë në nivelin 2 në KKK
Përmbajtja - Bazohet në Kornizën Kurrikulare të Kosovës
Vlera e kredive - Për momentin asnjë vlerë e kredive nuk jepet për këto kualifikime.

Diploma e kryerjes së Arsimit të Mesëm të Lartë
Niveli - Këto kualifikime janë në nivelin 4 në KKK
Përmbajtja - Bazohet në Kornizën Kurrikulare të Kosovës
Vlera e kredive - Për momentin asnjë vlerë e kredive nuk jepet për këto kualifikime.

Pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë nxënësi/kandidati pajiset me diplomë, ndërsa pas kalimit të maturës shtetërore merr certifikatë të maturës shtetërore e cila i mundëson vazhdimin në arsimin e lartë.

Kualifikime Kombëtare të Kombinuara

Karakteristikat e kualifikimeve kombëtare të kombinuara janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen që të ofrohen në një mjedis formal, përfshirë praktikën reale në vendin e punës apo të simuluar.

[1] *Kompetencat ndërkurrikulare janë: Shkathtësitë jetësore dhe edukimi personal; Edukimi për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut; Edukimi për ndërmarrësi; Edukimi shëndetësor; Edukimi mjedisor; Edukimi për TIK; Edukimi medial.*

Të gjitha kualifikimet kombëtare të kombinuara përfshijnë module të bazuara në standardet kombëtare të profesionit si dhe rezultatet që lidhen me Kornizën Kurrikulare të Kosovës;
• Qëllimi kryesor i këtyre kualifikimeve është që nxënësit të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca profesionale bazuar në standarde kombëtare të profesionit. Poashtu, do të fitojnë edhe njohuri të përgjithshme teorike, shkathtësi dhe kompetencë personale dhe shoqërore bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës;
• Përmbajtja e këtyre kualifikimeve bazohet në standardet kombëtare të profesionit, kompetencat ndërkurrikulare dhe kornizën kurrikulare sektoriale;
• Këto kualifikime vendosen në nivelin 3 dhe 4 të KKK. Ato kanë vlerë të kredive ECVET në përputhje me Ligjin e Arsimit Profesional;
• Përveç Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, rregullohen nga Ligji për AAP, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsimin për të Rritur, Ligji për provimin përfundimtar dhe Ligji për maturën shtetërore;
• Ato ofrohen nga institucionet e akredituara nga AKK dhe të licencuara nga MAShT.

Titujt e kualifikimeve të kombinuara kombëtare janë:

- Certifikata Kombëtare e Kombinuar
- Diploma Kombëtare e Kombinuar dhe
- Certifikata e Maturës.

Përshkimi i titujve

Certifikata Kombëtare e Kombinuar
Niveli - Këto kualifikime janë në nivelin 3 të KKK
Përmbajtja - Dizajnohen në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe Standardet Kombëtare të Profesionit (SKP)
Vlera e kredive - Ato do ta kenë vlerën e kredive të bazuar në vlerën e moduleve të arritura.

Diploma Kombëtare e Kombinuar
Niveli - Këto kualifikime janë në nivelet 4 dhe 5 të KKK
Përmbajtja - Dizajnohen në përputhje me Kornizën e Kurrikulare së Kosovës dhe SKP
Vlera e kredive - Pas përfundimit të nivelit 3 të KKK, nxënësi/kandidati fiton 120 kredi, ndërsa pas përfundimit të nivelit 4 të KKK merr në kumulativ 180 kredi ECVET.

Pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë nxënësi/kandidati pajiset me diplomë, ndërsa pas kalimit të maturës shtetërore merr certifikatë të maturës shtetërore e cila i mundëson vazhdimin në arsimin e lartë.

Titujt e kualifikimeve kombëtare të kombinuara përbëhen nga emri dhe lloji i kualifikimit, niveli dhe roli i punës apo fusha e kompetencës. Shembull: Certifikata Kombëtare e Kombinuar në Ndërtimtari - niveli 3, Diploma Kombëtare e Kombinuar në Financa - niveli 4, Diploma Kombëtare e Kombinuar në Infermieri - niveli 5.

Kualifikimet Kombëtare Profesionale

Karakteristikat e kualifikimeve kombëtare profesionale janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen në përputhje me Standardet Kombëtare të Profesionit;

• Qëllimi i kualifikimeve është që kandidatët ti fitojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat profesionale që ndërlidhen me një profesion të veçantë ose rol të punës;
• Përmbajtja e këtyre kualifikimeve janë: njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e bazuara në Standardet Kombëtare të Profesionit;
• Këto kualifikime mund të vendosen në nivelet 2, 3, 4 dhe 5 të KKK;
• Përveç Ligjit për Kualifikime Kombëtare, ato rregullohen me Ligjin për AAP dhe atë për të rritur;
• Ato ofrohen nga institucionet e akredituara nga AKK.

Titujt e kualifikimeve kombëtare profesionale janë:

- Certifikata Kombëtare Profesionale
- Diploma Kombëtare Profesionale
- Certifikata e arritshmërisë

Përshkrimi i titujve

Certifikata Kombëtare Profesionale
Niveli - Në parim këto kualifikime mund të jenë në çfarëdo niveli në KKK
Përmbajtja - Bazohen në Standardet Kombëtare të Profesionit
Vlera e kredive - Kanë vlerë deri 120 kredi ECVET.

Diploma Kombëtare Profesionale
Niveli - Këto kualifikime janë në nivelet 4 apo më lart në KKK
Përmbajtja - Bazohen në Standardet Kombëtare të Profesionit
Vlera e kredive - Kanë vlerë ekuivalente me 120 apo më shumë kredi ECVET.

Certifikata e arritshmërisë
Niveli - Në parim këto kualifikime mund të jenë në cilindo nivel të KKK
Përmbajtja - Bazohen në Standardet Kombëtare të Profesionit
Vlera e kredive - Nuk ka kufizime mbi vlerën e kredive për certifikatën e arritshmërisë, por ajo përcaktohet në procesin e zhvillimit dhe validimit të kualifikimeve.

Titujt e kualifikimeve kombëtare profesionale përbëhen nga emri dhe lloji i kualifikimit, niveli dhe roli i punës apo fusha e kompetencës. Shembull: Certifikata Kombëtare Profesionale në Hortikulturën dekoruese - niveli 2; Certifikata e arritjeve në floktari - ngjyrosje dhe grim - niveli 3; Diploma Kombëtare Profesionale në Pylltari - niveli 4; Diploma Kombëtare Profesionale në Menaxhimin Financiar - niveli 5.

Kualifikimet bazuar në Standardet Ndërkombëtare

Karakteristikat e kualifikimeve të bazuara në standardet ndërkombëtare janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe në përputhje me Kornizën e Kurrikulare të Kosovës në raste të caktuara;
• Qëllimi i kualifikimeve është që kandidatët të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të përgjithshme apo profesionale;

• Rezultatet e këtyre kualifikimeve janë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat në bazë të standardeve të vendeve të tjera, ose standardet ndërkombëtare të cilat janë të pranuara dhe të përdorura brenda një profesioni ose fushe të njohur të kompetencave; [2]
• Në parim, këto kualifikime mund të vendosen nga niveli 1-5 i KKK. Ato kanë vlerë të kredive ECVET;
• Përveç Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, ato rregullohen edhe me udhëzimet administrative të AKK;
• Ofrohen në institucionet e akredituara nga AKK.

Titujt e kualifikimeve ndërkombëtare janë:

- Certifikata;
- Diploma;
- Certifikata e arritshmërisë

Përshkrimi i titujve

Certifikata
Niveli - Në parim këto kualifikime mund të jenë në çfarëdo niveli në KKK
Përmbajtja - Dizajnohet në përputhje me standardet relevante që njihen ndërkombëtarisht
Vlera e kredive - Kanë vlerë ekuivalente deri në 120 kredi ECVET.

Diploma
Niveli - Këto kualifikime mund të jenë në nivelin 4 apo më lart në KKK
Përmbajtja - Dizajnohen në përputhje me standardet relevante që njihen ndërkombëtarisht dhe në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës në raste të caktuara.
Vlera e kredive - Kanë vlerë ekuivalente me 120 apo më shumë kredi ECVET.

Certifikata e arritshmërisë
Niveli - Në parim këto kualifikime mund të jenë në çfarëdo niveli në KKK
Vlera e kredive - Nuk ka kufizime në vlerën e kredive të certifikatave të arritshmërisë, por ajo përcaktohet në procesin e zhvillimit dhe validimit të kualifikimeve.
Titujt e kualifikimeve të bazuara në Standarde Ndërkombëtare do të përbëhen nga kategoria e certifikimit, roli i punës apo fusha e kompetencës, niveli i KKK dhe origjina e standardeve.
Shembull: *Certifikatë për përdorimin e bazës së të dhënave - niveli 2 - Standardet [3]ICDL, Diplomë në Kontabilitet - niveli 5 - Standardet ACCA,[4] Certifikata e arritshmërisë në gjuhën gjermane për fillestarë - A1 standardi CFER[5]etj.*
Në dokumentacionin e certifikimit do të kërkohet përshkrimi për origjinën e standardeve të përdorura në kualifikim.

---

[2] *Të tilla si menaxhimi, TI ose gjuhët.*
[3] *Licenca Ndërkombëtare për Përdorim të Kompjuterit*
[4] *Shoqata e Kontabilistëve të Diplomuar e të Certifikuar*
[5] *Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët*

Kualifikimet e përshtatura

Karakteristikat e kualifikimeve të përshtatura janë si në vijim:

• Këto kualifikime zhvillohen në përputhje me nevojat operative të një organizate, agjencie apo ndërmarrje;
• Qëllimi i kualifikimeve është që kandidatët të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të përgjithshme apo profesionale;
• Përmbajtja e këtyre kualifikimeve: njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat në bazë të standardeve të përcaktuara nga ana e organizatës, agjencisë apo ndërmarrjes e cila zhvillon kualifikimin;
• Në parim, këto kualifikime vendosen në nivelet 1-5 të KKK. Ato kanë vlerë të kredive ECVET;
• Përveç Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, ato rregullohen edhe me udhëzimet administrative përkatëse;
• Ato ofrohen në institucionet e akredituara nga AKK.

Titujt e kualifikimeve të përshtatura janë:

- Certifikata e arritshmërisë;
- Certifikata e përshtatur

Përshkrimi i titujve

Certifikata e arritshmërisë
Niveli - Në parim këto certifikata mund të jenë në çfarëdo niveli në KKK
Përmbajtja - Dizajnohet në përputhje me standardet e përcaktuara nga zhvilluesi i kualifikimit dhe të pranuara nga AKK.
Vlera e kredive - Nuk ka kufizime në vlerën e kredive të certifikatave të arritshmërisë, por përcaktohet në procesin e zhvillimit dhe validimit të kualifikimeve.

Certifikata e përshtatur
Niveli - Në parim këto certifikata mund të jenë në çfarëdo niveli në KKK
Përmbajtja - Dizajnohen në përputhje me standardet e përcaktuara nga zhvilluesi i kualifikimit dhe të pranuara nga AKK.
Vlera e kredive - Nuk ka kufizime në vlerën e kredive të certifikatave të përshtatura, por përcaktohet në procesin e zhvillimit dhe validimit të kualifikimeve.

Titujt e kualifikimeve të përshtatura përbëhen nga kategoria e certifikimit, roli i punës apo fusha e kompetencës, niveli i KKK dhe emri i zhvilluesit të standardeve. Shembull: Kompania Kosovare Ndërtimore Ltd Certifikatë në Operacionet e Mihjes Mekanike - niveli 3.

Me rastin e lëshimit të dokumentacionit të certifikimit për këto kualifikime kërkohet edhe një shënim që shpjegon natyrën e kualifikimeve të përshtatura.

Tabela me përmbledhje e llojeve dhe titujve të kualifikimeve në KKK

Veçoritë	*Kualifikimet e AL*	*Kualifikime të arsimit të përgjithshëm*	*Kualifikime Kombëtare të Kombinuara*	*Kualifikime Kombëtare Profesionale*	*Kualifikime të Standardeve Ndërkombëtare*	*Kualifikime të Përshtatura*
Zhvillimi	Korniza e Bolonjës	Korniza Kurrikulare e Kosovës	Standardet Kombëtare të Profesionit Korniza Kurrikulare e Kosovës	Standardet Kombëtare të Profesionit	Standarde të Njohura Ndërkombëtarisht	Nevojat operacionale të një agjencie, ndërmarrje apo organizate
Qëllimi	Studime akademike, njohuri dhe shkathtësi të nivelit të lartë, aftësi personale dhe kompetenca, nivel më të lartë të njohurive profesionale, shkathtësi dhe kompetenca, apo kombinim i këtyre	Studime akademike, njohuri dhe shkathtësi të ndërlidhura, shkathtësi personale dhe shoqërore dhe kompetenca	Njohuri profesionale, shkathtësi dhe kompetenca bazuar në Standardet Kombëtare të Profesionit dhe zhvillim personal	Njohuri profesionale, shkathtësi dhe kompetenca të shoqëruara me një profesion specifik apo detyra të punës	Njohuri profesionale apo të përgjithshme, shkathtësi dhe kompetenca	Njohuri profesionale apo të përgjithshme, shkathtësi dhe kompetenca
Përmbajtja	Bazuar në disiplinat akademike dhe/ose profile profesionale të nivelit të lartë	Lëndë shkollore dhe kompetenca ndërkurrikulare	Njohuri, shkathtësi dhe kompetenca bazuar në standardet kombëtare të profesionit, kompetenca ndërkurrikulare, studime teorike dhe lëndë shkollore deri në nivelin e 4	Njohuri, shkathtësi dhe kompetenca bazuar në Standardet Kombëtare të Profesionit	Njohuri, shkathtësi dhe kompetenca bazuar në standardet ndërkombëtare	Njohuri, shkathtësi dhe kompetencat bazuar në standardet e identifikuara nga organizata, agjencia apo ndërmarrja që kërkon kualifikimin
Nivelet	Nivelet 5 në 8	Nivelet 2, 3 dhe 4	Nivelet 2 dhe më lart	Nivelet 2 dhe më lart	Çdo nivel	Çdo nivel

Veçoritë	*Kualifikimet e AL*	*Kualifikime të arsimit të përgjithshëm*	*Kualifikime Kombëtare të Kombinuara*	*Kualifikime Kombëtare Profesionale*	*Kualifikime të Standardeve Ndërkombëtare*	*Kualifikime të Përshtatura*
Vlera e kredive	Një sërë vlerash të kreditit në përputhje me Kornizën e Bolonjës	Aktualisht nuk ka vlera të kreditit	Një sërë vlerash të kredive sipas komponentëve të kualifikimit	Një sërë vlerash të kredive sipas moduleve në kualifikim	Një sërë vlerash të kredive sipas komponentëve të kualifikimit	Një sërë vlerash të kredive sipas komponentëve të kualifikimit
Baza ligjore	Ligji për arsimin e lartë	Ligji për Arsimin Para-universitar dhe Ligji për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore	Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe Ligji për AAP	Ligji për AAP	Udhëzimet administrative të nxjerra nga AKK	Udhëzimet administrative të nxjerra nga AKK
Sigurimi i cilësisë	Agjencia Kosovës për Akreditim (AKA)	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT)	MAShT Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)	(AKK)	AKK	AKK
Titujt	Certifikata e Kursit të Shkurtër të Arsimit të Lartë, Diploma e Kursit të Shkurtër të Arsimit të Lartë, niveli Bachelor, niveli Master, niveli i Doktoratës	Certifikata e kryerjes së arsimit të mesëm të ulët, Certifikata e kryerjes së arsimit të mesëm të lartë dhe Diploma e Maturës	Certifikata Kombëtare e Kombinuar dhe Diploma Kombëtare e kombinuar	Certifikata Kombëtare Profesionale dhe Diploma Kombëtare Profesionale	Certifikata dhe Diploma	Certifikata të përshtatura

2.4.5. Struktura modulare e kualifikimeve

Kualifikimet e AAP kanë strukturë modulare. Sistemi modular ndihmon dhe mbështet ofrimin më fleksibil të kualifikimeve dhe zhvillimin e më shumë rrugëve ndërmjet kualifikimeve në kontekstin e të mësuarit të ndryshëm.

Moduli është pjesa më e vogël e kualifikimit i cili mund të certifikohet. Moduli përbëhet nga ndërlidhja e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të shprehura në formën e rezultateve të mësimit dhe të lidhura me kritere të vlerësimit.

Modulet mund të jenë të veçanta për një kualifikim të vetëm apo të përbashkëta për një grup të kualifikimeve.

Secili modul ka vlerën e kredisë, gjë që përbën bazën e dëshmive për akumulimin e kredive për dhënien e një kualifikimi të plotë apo transferimin e kredive ndërmjet kualifikimeve.
Strukturat e kualifikimeve modulare mundësojnë ofrimin e një pjese të kualifikimeve. Modulet janë pjesë përbërëse e kualifikimeve, ndërsa certifikimi i veçantë i moduleve mundëson njohjen e pjesëve të caktuara të kualifikimeve të cilat, varësisht nga kërkesa, mund të shpijnë drejt një kualifikimi të plotë.

Kualifikimet profesionale mund të bazohen në një strukturë të moduleve "obliguese" dhe "zgjedhore", duke lejuar shkallë të përzgjedhjes lidhur me modulet e marra. Nëse një modul është i përbashkët për më shumë kualifikime, duhet të ekzistojë mundësia e transferimit të kredive ndërmjet kualifikimeve në fjalë. Kjo kërkon që ofruesit e ndryshëm duhet ta njohin dhe pranojnë transferimin e kredive nga ofruesit e tjerë.

Fleksibiliteti i ofruar nga kualifikimet modulare është i rëndësishëm edhe për kandidatët me aftësi të kufizuara. Kandidatët me aftësi të kufizuara mund ti zgjedhin modulet që rrisin cilësitë dhe minimizojnë apo eliminojnë vështirësitë e tyre. Në rastet kur kandidatët nuk janë në gjendje ta arrijnë kualifikimin e plotë do të certifikohen për modulet e arritura.

Përparësia e kualifikimeve modulare është se siguron një mekanizëm për vlerësimin e mësimit paraprak, inkurajon të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mënyrat e ndryshme të të mësuarit.
Për ti fituar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për dhënien e një kualifikimi, nuk është gjithmonë e nevojshme për të ndjekur një program formal të të mësuarit. Kualifikimet modulare për t'u përfshirë në KKK duhet të zhvillohen në atë mënyrë që:

- të mund të vlerësohen dhe certifikohen;
- ti shprehin rezultatet e të mësuarit së bashku me kërkesat për vlerësim për të arriturat e rezultateve të mësimit;
- të kenë vlerë të kredisë;
- të kenë rregulla të kombinimit të cilat shpien në kualifikim;
- të mundësojë transferim të kredive për module.

Moduli 1
Rezultati i mësimit 1
- Kriteri i performancës 1
- Kriteri i performancës 2

Rezultati i mësimit 2
- Kriteri i performancës 1
- Kriteri i performancës 2

2.4.6. Rregullat e kombinimit të moduleve brenda kualifikimeve

Rregullat për kombinimin e moduleve brenda një kualifikimi kanë dy qëllime kryesore:

- Për ta mbështetur akumulimin dhe transferimin e kredive;
- Për tu siguruar se kualifikimi arrihet edhe brenda kombinimeve të ndryshme të moduleve.

Rregullat për arritjen e një kualifikimi nëpërmjet akumulimit të kredive përcaktohen gjatë zhvillimit të kualifikimit. Gjatë përcaktimit të rregullave duhet të merret parasysh fleksibiliteti për akumulimin dhe transferimin e kredive.

Rregullat e kombinimit përcaktojnë:

- Çfarë kërkohet nga kandidati të bëjë për ta arritur kualifikimin;
- Kreditë që duhet të fitohen në mënyrë që të arrihet kualifikimi;
- Mundësitë për kandidatët për transferimin e kredive (përfshirë rrugët hyrëse dhe të transferimit);
- Mospranimin e moduleve dhe kredive të caktuara, kur vlerësohen si të papërshtatshme për kualifikim.

Rregullat e kombinimit përfshijnë informatat në vijim:

- Numrin e kredive që kërkohet për ta arritur kualifikimin sipas nivelit të KKK;
- Numrin ose përqindjen e kredive që duhet të jetë në përputhje me nivelin e kualifikimit;
- Kreditë nga modulet obliguese psh. modulet të cilat patjetër duhet të merren që të arrihet kualifikimi;
- Kreditë nga modulet zgjedhore përcaktojnë maksimumin ose minimumin e kredive që duhet të arrihen përmes moduleve zgjedhore. Pra, kualifikimi liston të gjitha modulet nga të cilat kandidati mund të zgjedhë module zgjedhore në bazë të rregullave për kombinime;
- Kreditë nga "zgjedhja e lirë" nënkuptojnë mundësinë për ti marrë kreditë që nuk janë pjesë e kualifikimit. Rregullat përfshijnë kufizimin që mund të bëhet në këtë "zgjedhje të lirë", të tilla si: niveli, numri i kredive apo fushat profesionale;
- Mundësi për transferim të kredive;
- Kredi nga module të njëjta, psh. module të ndryshme nga kualifikimet e tjera ose institucioneve të tjera të akredituara të cilat janë të barabarta/ekuivalente me këtë kualifikim;
- Koha e kufizuar e akumulimit të kredive ose përjashtimet e caktuara kur kjo është e nevojshme;
- Kufizimet për kredi që mund të arrihen nëpërmjet NjMP, kur kjo është e nevojshme;
- Kërkesat e hyrjes për kualifikim psh. në qoftë se ka kërkesa specifike apo parakushte për kualifikimin përkatës;
- Informacion specifik se si ky kualifikim ndërlidhet me kualifikimet tjera;
- Identifikim i moduleve të cilat janë të përbashkëta me kualifikimet tjera.

2.4.7. Vlera e kredive në module dhe kualifikime

Vlera e kredive për module dhe kualifikime bazohet në përmbajtjen e kualifikimit ose modulit. Ligji për kualifikime kombëtare e definon kredinë si "një vlerë numerike që i jepet kualifikimit ose pjesëve të kualifikimit dhe që paraqet vëllimin e të mësuarit të nevojshëm për ta arritur kualifikimin ose një pjesë të kualifikimit. Kreditë mund të akumulohen gjatë një kualifikimi ose mund të transferohen në mes të kualifikimeve ose sistemeve të kualifikimit". Pra, vlera e kredisë caktohet në bazë të kohës e cila është e nevojshme për ti arritur rezultatet e të mësuarit për arritjen e kualifikimit ose modulit dhe vlerësimin, ku përfshihen:

- Pjesa teorike (përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional)
- Pjesa praktike
- Vetëstudimi
- Aftësimi/praktika në punë
- Vlerësimet

Nivelet e KKK

3. NIVELET E KKK

KKK është kornizë e strukturuar në shtrirje vertikale dhe horizontale. Shtrirja vertikale e KKK ofron bazë për klasifikimin e kualifikimeve sipas hierarkisë së niveleve kualifikuese, ndërsa shtrirja horizontale ofron bazë për klasifikimin sipas llojeve të kualifikimeve.

3.1. Nivelet e kualifikimit

Struktura vertikale e KKK bazohet në tetë nivele kualifikimi sikurse KEK. Nivelet e KKK definohen me përshkruesit e niveleve sipas KEK, të përshtatura në kontekstin e Kosovës. Ligji për Kualifikimet Kombëtare përcakton se "përparimi prej një niveli në nivelin tjetër caktohet nëpërmjet rritjes së kompleksitetit dhe kërkesave të rezultateve të mësimit, të përkufizuara sipas njohurive, shkathtësive dhe kompetencave më të gjera".
Secili nivel është përcaktuar me një formulim të rezultateve të të nxënit sipas tre komponentëve:

- Njohurive - teorike apo praktike;
- Shkathtësive - njohëse, kreative apo praktike;
- Kompetencave - autonomia dhe përgjegjësia.

Derisa përshkruesit e niveleve përcaktojnë nivelin e kualifikimit, treguesit e niveleve përcaktojnë përmbajtjen dhe llojin e kualifikimit në nivelin përkatës.
Tabela në vijim paraqet lidhjet mes strukturës së sistemit të arsimit dhe aftësimit dhe kërkesat profesionale.

Nivelet e KKK në lidhje me fazat e të mësuarit gjatë gjithë jetës në kontekstin e strukturës arsimore dhe legjislative

Korniza e Kualifikimeve Kombëtare			
Niveli i KKK	**Përmban kualifikime të shoqëruara me**		**Niveli referues i KEK**
	Programet e arsimit	**Kualifikimet aktualisht në dispozicion (Lloji)**	
8	Arsimi i lartë - cikli i 3 -të i Bolonjës (Doktorata)	A	8
7	Arsimi i lartë - cikli i 2 -të i Bolonjës (Master)	A	7
6	Arsimi i lartë - Cikli i 1 -rë i Bolonjës (Bachelor)	A	6
5	Cikli i shkurtër i Bolonjës dhe/ose AAP postsekondar	A, C, D, E	5
4	Përgatitja për përparim në arsim të lartë dhe/ose hyrja në treg të punës	B, C, D, E, F	4
3	Përgatitja për tregun e punës (të rinjtë dhe të rriturit)	B, C, D, E, F	3
2	Përparimi nga arsimi i mesëm i ulët tek ai i lartë (të rinjtë), përgatitja për tregun e punës (të rriturit)	B, C, D, E, F	2
1	Arsimi fillor	B, C, D, E, F	1

Niveli 1 përfshinë kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve kompensuese të arsimit bazik, ose kurseve të shkurtra të aftësimit, të ofruara nga ofruesit e aftësimit. Këto kualifikime janë ekuivalente me përfundimin e arsimit fillor.

Niveli 2 përfshinë kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit që mbulojnë shkathtësitë bazike profesionale të punës të nivelit të ulët (shkrim-leximit, numërimit apo aftësi për TIK) të ofruara nga ofruesit joformalë të aftësimit. Këto kualifikime janë ekuivalente me përfundimin e arsimit të mesëm të ulët.

Niveli 3 përfshinë kualifikime që fitohen pas përfundimit të dy vjetëve të arsimit formal të mesëm të lartë profesional dhe certifikatave të fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit, të ofruara nga ofruesit e AAP.

Niveli 4 përfshinë kualifikimin e Maturës të fituar pas përfundimit të arsimit të përgjithshëm dhe të mesëm të lartë profesional, certifikatave të fituara pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë profesional formal, si dhe certifikatat e fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit të ofruara nga ofruesit joformalë të AAP.

Niveli 5 parashikon kualifikimet akademike dhe profesionale (formale dhe joformale) që janë në mes të arsimit të mesëm dhe të lartë.

Niveli 6 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Bachelor. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të trajnimeve të cilat deri tani nuk janë në KKK.

Niveli 7 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Master. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të trajnimeve të cilat deri tani nuk janë në KKK.

Niveli 8 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm të Doktoratës.

3.2. Vendosja e kualifikimeve në nivelet e KKK

Secili kualifikim që vendoset në kornizë validohet dhe akreditohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit sipas përshkruesve dhe treguesve të niveleve të KKK.

NIVELI 1

Përshkruesi:

Nxënësi/kandidati që i arrin kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstron njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata duhet të jenë në gjendje ti marrin dhe përdorin njohuritë e domosdoshme, për të mësuar, kryer punët e thjeshta, apo të jenë pjesëmarrës në jetën e përditshme. Këto njohuri janë njohuri të përgjithshme nuk janë specifike për një lëmë mësimore, për një profesion apo për një fushë profesionale.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje të kryejnë detyra të thjeshta duke përdorur shkathtësi bazike psh. detyra të përditshme të cilat kërkojnë shkathtësi leximi, shkrimi, përdorim të numrave, kryerje të proceseve themelore me kompjuter, punë brenda një strukture të mbikëqyrur apo punë me njerëz të tjerë.

Kompetencat

Ata do të jenë në gjendje të ndërmarrin punë apo mësim të strukturuar, i cili organizohet dhe kontrollohet nga njerëzit e tjerë. Ata do të kryejnë detyra nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë dhe nuk do të mbajnë përgjegjësi të plotë për të vendosur se çfarë duhet të bëhet si, kur, apo ku duhet të bëhet apo rreth cilësisë së rezultateve të asaj detyre.

Treguesit e nivelit:

Kualifikimet formale në nivelin e 1-rë ofrojnë njohuritë e përgjithshme bazike dhe i takojnë arsimit fillor. Ato mund të ofrohen edhe si arsim bazik kompensues për të rritur.
Kualifikimet formale zgjasin sipas vitit shkollor, kurse ato joformale kryesisht zgjasin disa javë apo disa muaj. Nxënësit në arsimin formal përfundojnë këtë nivel me marrjen e dëftesës dhe kjo u mundëson vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm. Ndërsa, nxënësit/kandidatët në arsimin joformal certifikohen për këto kualifikime dhe janë kryesisht të papunësuar apo të pakualifikuar dhe të gjithë ata të cilët dëshirojnë të zhvillojnë shkathtësi specifike. Në këtë nivel mund të hyjnë edhe kualifikimet për personat me aftësi të kufizuara.
Kurset e shkurtra mund të ofrohen nga organizatat/institucionet e akredituara të arsimit dhe aftësimit për të rritur, por mund të ofrohen gjithashtu në qendrat e akredituara për trajnime në vendin e punës. Mësimdhënësit dhe instruktorët duhet të kenë kompetenca të specializuara për mësimin e shkathtësive themelore për të rriturit për këtë nivel. Këto kualifikime u mundësojnë individëve hyrje apo ri-hyrje në tregun e punës.

NIVELI 2

Përshkruesi:

Nxënësi/kandidati që i arrin kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstron njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata do të jenë në gjendje ta mësojnë dhe përdorin njohurinë bazike për një lëndë arsimore, profesion apo fushë profesionale. Njohuria kryesisht do të jetë faktike psh. informacione rreth përmbajtjes së zakonshme, terminologjisë, proceseve, mjeteve apo materialeve të një lënde arsimore, profesioni apo fushe profesionale.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje ti kombinojnë shkathtësitë themelore praktike dhe shkathtësitë themelore të të menduarit, përmes përdorimit të informacioneve të renditura në kuadër të njohurive në këtë nivel. Shkathtësitë do ta përfshijnë arsyetimin, llogaritjen dhe planifikimin për kryerjen e detyrave si dhe zgjidhjen e problemeve të cilat janë të zakonshme për lëndën, profesionin apo fushën profesionale. Kjo do të arrihet duke ndjekur praktika rutinë të bazuara në rregulla të qarta, duke përdorur mjete dhe materiale të thjeshta.

Kompetencat

Ata do të jenë në gjendje të kryejnë detyra nën mbikëqyrje të pjesshme apo të plotë. Këto detyra do të organizohen kryesisht dhe kontrollohen nga të tjerët, por që individët do ta bartin përgjegjësinë për disa aspekte të detyrave, si: marrja e vendimeve se çfarë duhet të bëhet, si dhe kur apo ku duhet të bëhet si dhe kualitetin e disa rezultateve.

Treguesit e nivelit:

Kualifikimet e nivelit 2 janë të llojeve dhe përmbajtjeve të ndryshme, si në vijim:

• Kualifikimet në arsimin formal merren me përfundimin e shkollës së mesme të ulët. Këto kualifikime zgjasin sipas viteve shkollore të mësimit. Mësimdhënësit duhet të jenë të kualifikuar/specializuar në mësimdhënie. Këto kualifikime i përgatisin nxënësit që të përparojnë në arsimin e mesëm të lartë apo në tregun e punës;
• Kualifikimet e arsimit bazik kompensues për të rritur, ofrohen nga shkollat e mesme të ulëta;
• Kualifikimet në arsimin joformal ofrohen nga shkollat, qendrat e aftësimeve apo kompanitë, etj.;
• Këto kualifikime në këtë nivel përfshijnë njohuritë e përgjithshme, shkathtësitë dhe kompetencat e domosdoshme për ta arritur punësimin, avancimin në vendin e punës apo pjesëmarrjen në jetën e përditshme.

Nxënësit dhe kandidatët e synuar janë të rriturit të cilët janë të papunë, të pakualifikuar apo ata të cilët dëshirojnë ti rrisin shkathtësitë e tyre. Këto kualifikime ofrohen nga institucionet e akredituara për arsim dhe aftësim profesional, institucionet e AAP apo qendrat e trajnimeve.
Mësimdhënësit dhe trajnerët duhet të kenë kompetenca të specializuara për t'ua mësuar shkathtësitë bazike të të rriturve. Këto kualifikime duhet t'u mundësojnë individëve hyrje apo ri-hyrje në tregun e punës.

NIVELI 3

Përshkruesi:

Nxënësi/kandidati që i arrin kualifikimet në këtë nivel në KKK demonstron njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata duhet të kenë njohuri të punës të aspekteve kryesore të lëndës arsimore, profesionit, apo fushës profesionale dhe do të jenë në gjendje ta përdorin këtë njohuri për ti arritur rezultatet e të nxënit të strukturuar apo atë në vendin e punës. Kjo do ti përfshijë faktet, parimet, proceset dhe idetë që u nevojiten atyre për të realizuar mësim të strukturuar apo për të punuar me sukses në këtë lëndë, profesion apo fushë profesionale.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje të aplikojnë një numër të shkathtësive praktike dhe të të menduarit, për kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve në një lëndë arsimore, profesion, apo fushë profesionale. Kjo do të arrihet duke përdorur informacione (si ato të renditura te njohuritë në këtë nivel) për zgjedhjen e metodave të përshtatshme dhe zbatimin e tyre me materiale dhe mjete të përshtatshme. Puna nuk do të jetë ende në nivelin e kërkuar për një punëtor të kualifikuar apo për hyrje në studime në arsimin e lartë.

Kompetencat

Ata do të jenë në gjendje të bartin përgjegjësi për realizimin e detyrave, zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e rezultateve për këtë nivel. Ata do të kryejnë detyra pa mbikëqyrje, do të jenë në gjendje ti zgjidhin problemet të cilat janë rutinë në lëndën arsimore, profesion, apo fushë profesionale dhe të bëjnë ndryshime në qasjen ndaj detyrës atëherë kur kjo kërkohet.

Treguesit e nivelit:

Kualifikimet në nivelin 3 janë të llojeve dhe përmbajtjeve të ndryshme, si në vijim:

• Certifikata pas dy vjetëve të arsimit dhe aftësimit në shkollat e AAP
Këto kualifikime profesionale në arsimin formal do ti përgatisin nxënësit për avancim në fazën tjetër apo në tregun e punës. Ata do ta bëjnë kombinimin e mësimit të përgjithshëm dhe profesional dhe që zgjatë dy vjet të plota shkollore. Mësimdhënësit duhet të kenë kualifikime të avancuara në atë lëmë, profesion apo fushë profesionale dhe në mësimdhënie;

• Certifikata të kualifikimeve profesionale.
Këto do të jenë kurse të shkurtra që çojnë në kualifikime dhe me përfundimin e këtyre kualifikimeve kandidatët marrin certifikatë. Trajnerët duhet të kenë njohuri të specializuara profesionale. Nuk ka rregulla të veçanta rreth përmbajtjes dhe kohëzgjatjes së këtyre kualifikimeve.

NIVELI 4

Përshkruesi:

Nxënësi/kandidati që i arrin kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstron njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata do të kenë njohuri të mira në dhe rreth një lënde arsimore, profesioni apo fushe profesionale. Ata do të jenë në gjendje ta përdorin këtë njohuri për kryerjen e mësimit të strukturuar apo punën në atë fushë, profesion apo fushë profesionale.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje ti aplikojnë një numër të shkathtësive praktike dhe të të menduarit për ti kryer detyrat dhe zgjidhur problemet. Shkathtësitë, detyrat dhe problemet do të jenë të veçanta për lëndën arsimore, profesionin apo fushën profesionale. Ata marrin detyra në nivel të punëtorit të kualifikuar apo të mësimit të strukturuar në nivelin e kërkuar për hyrje në studime në arsimin e lartë.

Kompetencat

Ata do të ndërmarrin punë apo mësim të strukturuar brenda kufijve dhe praktikave normale të lëndëve arsimore, profesionit apo fushës profesionale. Ata do të jenë në gjendje të bëjnë ndryshime në qasjen e tyre të planifikuar gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të tyre. Do të punojnë në mënyrë të pavarur dhe do ta marrin përgjegjësinë e plotë për planifikimin dhe përfundimin e punëve apo të mësimit të strukturuar dhe për cilësinë e rezultateve. Ata do ta vlerësojnë performancën e tyre dhe përpiqen që ta përmirësojnë atë dhe mund ti mbikëqyrin të tjerët, të cilët janë të ngarkuar me aktivitete rutine, vlerësojnë performancën e tyre dhe ndërmarrin hapa duke bërë përmirësime mbi bazën e këtij vlerësimi.

Treguesi i nivelit

Kualifikimet që çojnë në nivelin 4 mund të arrihen përmes këtyre rrugëve, si:

•• Arsim dhe aftësim profesional formal (Diploma)
Këto programe formale profesionale përgatisin nxënësit/kandidatet për përparim në fazën pasuese të AAP formal, niveli 5 ose për punësim si punëtorë të kualifikuar.
Mësimdhënësit/trajnerët duhet të kenë kualifikime të avancuara për lëndët, profesionin apo fushën profesionale dhe në mësimdhënie. Ky mësim është i kombinuar me mësim të përgjithshëm dhe profesional me kohëzgjatje tri vite shkollim.

• Arsim dhe aftësim profesional (Certifikatë)
Këto janë kurse/trajnime të shkurtra që çojnë deri në një kualifikim apo pjesë të kualifikimeve. Ato hartohen për t'iu ndihmuar të punësuarve të kualifikuar, punëkërkuesve të cilëve u duhen aftësi të reja. Kandidatët të cilët përfshihen në këto kualifikime, zakonisht duhet ti kenë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e gjera në profesion apo fushë profesionale të nivelit 3 ose 4 dhe mund të vijnë nga kualifikimet ose nga përvoja.

Këto kualifikime ofrohen nga institucionet e akredituara të AAP, qendrat për aftësim ose kompanitë. Trajnerët duhet të kenë njohuri të specializuara profesionale si dhe trajnime në mësimdhënie për ti ofruar këto kualifikime. Nuk ekziston rregull i veçantë rreth përmbajtjes së këtyre kualifikimeve.

NIVELI 5

Përshkruesi:

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata duhet të kenë njohuri të gjëra dhe të specializuara faktike dhe teorike në dhe rreth një lënde arsimore, profesioni, apo fushe profesionale. Ata do të jenë në gjendje ti përdorin njohuritë e tyre për të arritur rezultate të cilat rrjedhin nga mësimi i strukturuar ose puna. Kjo mund të përfshijë:

• përdorimin e njohurive të gjëra dhe të specializuara faktike dhe teorike brenda një fushe të punës apo studimit duke treguar vetëdijesim dhe kufizim të këtyre njohurive;
• zbatimin e njohurive të gjëra për fushëveprimin, përcaktimin e veçorive dhe fushave kryesore të lëndës, fushës profesionale dhe njohurive të hollësishme në disa fusha;
të kuptuarit dhe përdorimin e një vargu të limituar të teorive bazike, parimeve dhe koncepteve;
• përdorimin e njohurive dhe të të kuptuarit të disa prej çështjeve aktuale më kryesore, specializimeve dhe në bazë të njohurive të theksuara ti kuptojnë hulumtimet apo proceset ekuivalente brenda kontekstit të punës apo studimit.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje të përdorin një grumbull shkathtësish të specializuara të cilat nevojiten për ti planifikuar, zbatuar, rishikuar dhe vlerësuar rezultatet në një lëndë arsimore, profesion apo fushë profesionale. Ata do të jenë në gjendje ti zbatojnë shkathtësitë gjithëpërfshirëse njohëse dhe praktike, praktikat dhe teknikat për të zhvilluar zgjidhje kreative për problemet praktike dhe për përmbushjen e detyrave. Kjo mund të përfshijë:

• zbatimin e shkathtësive hulumtuese dhe analitike për zgjidhjen e problemeve konkrete dhe abstrakte si dhe çështjeve që kërkojnë ushtrimin e maturisë dhe gjykimit;
• hulumtimin, analizën dhe interpretimin që kërkon aplikimin e teorive, parimeve dhe metodave relevante për fushën e punës ose studimit;
• përdorimin e shkathtësive të komunikimit, atyre matematikore dhe digjitale, të ndërlidhura me një fushë të punës ose studimit, një pjesë e të cilave është e avancuar ose e specializuar.

Kompetencat

Ata do të jenë në gjendje të realizojnë punë të pavarur apo mësim të strukturuar të të gjitha llojeve të radhitura për këtë nivel, përfshirë adoptimet për ti përmbushur kërkesat e ndryshimeve dhe rrethanave ose për t'u marrë me faktorët apo zhvillimet e paparashikuara. Kjo mund të përfshijë:

• ushtrimin e autonomisë së konsiderueshme personale dhe marrjen e iniciativës në disa veprimtari që kërkojnë ushtrimin e maturisë dhe gjykimit;
• ushtrimin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes në kontekstet e punës apo studimit, e cila mund ta përfshijë organizimin dhe marrjen e përgjegjësisë për punën e të tjerëve dhe për burimet dhe menaxhimin e aktiviteteve të njerëzve të tjerë;
• rishikimin dhe vlerësimin e performancës personale dhe të tjerëve për të cilët është marrë përgjegjësi si dhe planifikimi dhe përmirësimi i performancës në bazë të një vlerësimi të tillë.

Treguesit e nivelit:

Kualifikimet e nivelit 5 do të jenë të llojeve dhe përmbajtjeve të ndryshme psh.:

• Kualifikimet në arsimin formal dhe joformal postsekondar
Këto programe profesionale përgatisin individët për punësim si: teknik i lartë, specialist apo menaxher i ri. Këto programe, poashtu, mund të çojnë në programet universitare. Për këto kualifikime zakonisht shfrytëzohen materialet mësimore, librat dhe burimet referuese të avancuara.
Mësimdhënësit/trajnerët duhet të kenë kualifikime të avancuara në këtë lëmë, profesion apo fushë profesionale dhe në mësimdhënie si dhe duhet të përmbajnë nivel të lartë të teorisë krahas aftësimit praktik. Këto kualifikime mund të ofrohen në dy rrugë:
• Kualifikimet me kohëzgjatje një apo dy vjet të plota të studimit apo ekuivalente në studime të pjesshme (part time).
Në përputhje me procesin e Bolonjës dhe përshkruesit e Dublinit për arsimin e lartë, këto kualifikime qëndrojnë ndërmjet arsimit të mesëm të lartë dhe kurseve përfundimtare të nivelit Bachelor. Ato mund të jenë profesionale ose të nivelit akademik për nga përmbajtja dhe zakonisht me kohëzgjatje një apo dy vjet me kohë të plotë studimi.
• Kualifikimet e shkurtra
Këto janë trajnime të shkurtra të cilat çojnë në kualifikime për ata që janë të punësuar dhe kanë nevojë për njohuri të reja, shkathtësi ose kompetenca më të gjera psh. përdorimi i teknologjive të reja apo metodave të punës, marrja e përgjegjësive të reja të nivelit të njëjtë sikurse profesionet e tyre aktuale apo për përparim në detyra të nivelit më të lartë. Individët që marrin këtë kualifikim zakonisht duhet të kenë kualifikime ose përvojë në profesion ose fushë profesionale të nivelit 4 ose 5. Kualifikimet mund të përdorin standarde kombëtare apo ndërkombëtare. Ato ofrohen nga institucionet e akredituara. Trajnerët duhet të kenë njohuri të specializuara profesionale. Nuk ekziston rregull i veçantë në lidhje me përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e këtyre kualifikimeve.
Individët e interesuar për kualifikimin e nivelit 5 kanë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca më të gjëra për ti vazhduar studimet e mëtejme me një autonomi të caktuar.
Individi në nivelin e 5 është një teknik apo specialist ose menaxher i ri. Puna në këtë nivel zakonisht kërkon aplikimin e teorisë, principeve dhe metodave të bazuara në njohuritë teorike dhe praktike dhe të kuptuarit e një fushe të punës ose studimit, përdorim konsistent të gjykimit në hulumtime, analiza, interpretime dhe aplikime të teorive, principeve dhe metodave. Poashtu, kërkon shkathtësi për marrje të përgjegjësive dhe përmirësim të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave më të gjëra drejt specializimit të mëtejmë.
Pjesëmarrja në aftësime të nivelit të 5 kërkon së paku arritjen e rezultateve të arsimit të përgjithshëm ose atij profesional të nivelit 4 të KKK apo përvojën e punës, me të cilën mund të demonstrohen rezultatet e nivelit të 4-të.

Kualifikimet profesionale të nivelit të 5 janë zakonisht specifike për një profesion dhe kanë përmbajtje të specializuar. Këto kualifikime kërkojnë përvojë pune për fushën e specializuar, të cilat demonstrohen gjatë punës dhe kërkojnë të kuptuarit teknik dhe profesional, bazuar në njohuritë praktike dhe teorike.

Përparimi tipik për nivelin 5

Mësimi në këtë nivel ofron një bazë për përparim në studime të mëtejme për ta përfunduar ciklin e parë të arsimit të lartë ose për të arritur nivele më të larta të aftësimit profesional.
Kualifikimet profesionale do ti përgatisin kandidatët për hyrje në profesione të ndryshme, përfshirë ato që janë të rregulluara me ligj ose për ta vazhduar shkallën Bachelor apo për të arritur kualifikime profesionale të niveleve të larta.

NIVELI 6

Përshkruesi

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK i demonstrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata duhet të kenë njohuri të avancuara në dhe rreth fushës së punës apo studimit, përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve. Kjo mund të përfshijë:
• përdorimin e njohurive të integruara të parimeve, karakteristikave, kufijve dhe terminologjisë në kuadër të një lënde, disipline apo fushe të punës për të arritur gjykim të informuar rreth teorive dhe praktikave apo për ta udhëhequr atë;
• shfrytëzimin e njohurive të hollësishme dhe të kuptuarit në një ose më shumë specializime, që janë pjesa më e avancuar e një lënde, disipline ose fushe të punës;
• demonstrimin e njohurive dhe të kuptuarit e mënyrave të zhvillimit të një lënde, disipline ose fushe të punës, duke përfshirë një radhë të teknikave të përcaktuara të mbledhjes së të dhënave ose metodologjisë së hulumtimit.

Shkathtësitë

Shkathtësitë praktike të avancuara, njohëse dhe kreative.

Ata do të jenë në gjendje ta demonstrojnë mjeshtërinë dhe inovacionin për ti zgjidhur problemet komplekse dhe të paparashikuara në fushën e specializuar të punës ose studimit. Kjo mund të përfshijë:

• përdorimin e disa shkathtësive, praktikave dhe materialeve të specializuara dhe të avancuara ose që janë parësore në një lëndë, disiplinë apo fushë të punës;
• ekzekutimin e projekteve të definuara të hulumtimit, zhvillimit për identifikimin dhe zbatimin e rezultateve relevante;
• përcaktimin në një radhë të konteksteve të nivelit profesional, që përfshinë një shkallë të paparashikueshmërisë dhe specializimit, demonstrimin e origjinalitetit dhe kreativitetit si dhe të gjykuarit në situata kur të dhënat/informacionet janë të limituara ose rrjedhin nga burime të ndryshme.

Kompetencat

Ata do të realizojnë detyra apo studime, të cilat përfshijnë menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike dhe profesionale, të cilat mund ta përfshijnë përgjegjësinë për vendimmarrje në kontekste të paparashikuara të punës ose studimit, apo ta menaxhojnë zhvillimin profesional të individëve dhe grupeve. Kjo mund të përfshijë:
punën efektive nën udhëheqje, në bashkëpunim me kolegët e tjerë të kualifikuar;
ushtrimin e autonomisë dhe iniciativës dhe marrjen e përgjegjësisë kryesore për punën e të tjerëve dhe për një radhë të burimeve;
bashkëpunimin me të tjerët për të siguruar ndryshime, zhvillim dhe ide të reja;
marrjen me çështje etike dhe profesionale në pajtim me kodet dhe praktikat ekzistuese profesionale.

Treguesit e nivelit

Kualifikimet e nivelit të 6 janë të llojeve dhe përmbajtjeve të ndryshme, si vijon:

• Programet në arsimin e lartë formal
Programet që i takojnë nivelit të 6 ofrojnë njohuri dhe shkathtësi të thella, që përputhen me programet e studimeve në ciklin e parë. Ato mund të jenë profesionale ose akademike në përmbajtje dhe kanë një vlerë të kredisë, të shoqëruar me tri apo katër vjet të studimit me orar të plotë.
Këto kualifikime janë në përputhje me ciklin e parë të procesit të Bolonjës dhe përshkruesit relevantë të Dublinit dhe çojnë në gradën Bachelor. Bazohen në njohuri dhe shkathtësi që janë të nevojshme për praktikë profesionale dhe mund të jenë bazë e licencës për ushtrim të profesionit;

• Programet e shkurtra të arsimit të lartë
Janë programe të shkurtra të cilat çojnë në kualifikime për ata të cilët janë të punësuar dhe kanë nevojë të mësojnë njohuri të reja, shkathtësi dhe kompetenca më të gjera si: përdorim të teknologjive të reja, të metodave të punës dhe të marrjes së përgjegjësive të reja të nivelit të njëjtë sikurse vendi aktual i punës. Kryen detyra që kanë të bëjnë me të kuptuarit teknik dhe profesional të bazuar në njohuri praktike dhe teorike. Disa prej këtyre njohurive do ti takojnë nivelit të avancuar.
Individët që marrin këto kualifikime zakonisht duhet të kenë kualifikime apo përvojë në profesion apo fushë profesionale e cila së paku i takon nivelit 4 ose 5. Kualifikimet bazohen në standarde kombëtare, ndërkombëtare apo standarde të kërkuara nga punëdhënësit e veçantë.

Treguesit e nivelit në kontekst të studimit dhe punës

Rezultatet e nivelit të 6 demonstrohen në një fushë studimi, që vazhdohet pas arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe është në atë nivel që përfshinë aspekte të avancuara të njohurive të fushës së tyre të studimit. Individët kanë kontroll të kufizuar mbi përmbajtjen formale dhe metodat që përdoren, mirëpo pritet që të shfaqin pavarësi në hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ata duhet të kenë aftësi të mbledhin dhe të interpretojnë të dhëna relevante (zakonisht brenda fushës së tyre të studimit) për të ardhur deri te gjykimet, që përfshijnë reflektim mbi çështjet relevante sociale, shkencore ose etike.

Individi me kualifikim në nivelin e 6 është një specialist, profesionist ose menaxher. Puna në nivelin e 6 zakonisht kërkon shkathtësi për marrjen e përgjegjësive dhe përmirësimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave më të gjera drejt ngritjes së specializimit. Pjesëmarrja në trajnime aftësuese të nivelit të 6 kërkon arsimim të përgjithshëm dhe profesional të nivelit 4 ose 5.
Rezultatet në nivelin e 6 demonstrohen në punën që bazohet në njohuritë teorike dhe praktike të hollësishme, shkathtësi dhe kompetenca të lidhura me një fushë të mësimit ose të punës, një pjesë e së cilës është në rrjedhat aktuale të zhvillimit të këtij lëmi.

Përparimi për nivelin e 6 të kualifikimeve

Ky nivel ofron bazë për përparim në studimet e mëtejme në ciklin e dytë të arsimit të lartë. Kualifikimet e nivelit të 6 sigurojnë hyrje në punësim profesional dhe shpesh janë si hyrje në karrierë me punë profesionale dhe menaxheriale.

NIVELI 7

Përshkruesit

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë

Ata do të kenë njohuri shumë të specializuara, të gjera dhe të hollësishme, disa prej të cilave janë themelore në një fushë të punës ose studimit dhe të cilat ndërlidhen me fusha të ndryshme, si bazë për të menduarit origjinal dhe hulumtim.

Kjo përfshinë:

• Kuptimin kritik të teorive kryesore, parimeve dhe koncepteve që ndërlidhen me njohuri praktike dhe konceptuale të lëndës, disiplinës ose fushës së punës - duke përfshirë specializimet relevante;
• Njohuritë të cilat mbulojnë dhe integrojnë shumicën e fushave kryesore të lëndës, disiplinës ose fushës së punës, përfshirë specifikat dhe terminologjinë;
• Mbështetja në vetëdijen kritike mbi çështjet aktuale të një lënde, disipline ose fushe të punës duke përfshirë specializimet përkatëse.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje ti përdorin shkathtësitë dhe teknikat e specializuara të ndërlidhura me një lëndë apo disiplinë, fushë profesionale, përfshirë edhe aktivitetet të cilat kërkojnë të mendim inovativ dhe kërkime origjinale. Ata do të kenë qëndrim dhe di ti vlerësojnë informatat e reja, konceptet dhe dëshmitë nga një gamë e gjerë e burimeve dhe duhet të jenë në gjendje ti përdorin shkathtësitë e specializuara për zgjidhjen e problemeve, për zhvillimin e njohurive dhe procedurave të reja dhe integrimin e njohurive nga fushat e ndryshme si:

• planifikimin dhe kryerjen e një projekti të rëndësishëm të hulumtimit dhe zhvillimit;
• zhvillimin e përgjigjeve origjinale dhe kreative për problemet dhe çështjet e praktikuara në një shumëllojshmëri të gjerë dhe shpesh të paparashikueshme, në kontekste të ndryshme profesionale;
• hartimin e temës për master.

Kompetencat

Ata do të jenë autonomë dhe do të kenë iniciativë për veprimtaritë profesionale dhe të ngjashme, duke marrë përgjegjësinë për punën e vet si dhe për punën e të tjerëve. Ata ndërmarrin iniciativa për punë ose studime që përfshijnë menaxhimin dhe transformimin e konteksteve të punës apo studimit, të cilat janë komplekse, të paparashikuara dhe kërkojnë qasje të reja strategjike. Kjo mund të përfshijë:

menaxhimin e ekipeve profesionale, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive dhe praktikës si dhe shqyrtimin e performancës së tyre;
trajtimin e çështjeve komplekse etike dhe profesionale dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet të cilat nuk janë të adresuara nga kodet ose praktikat aktuale profesionale.

Treguesit e nivelit:

Kualifikimet për këtë nivel janë:

• Programet në arsimin e lartë formal
Studimet për kualifikimet në nivelin 7 zhvillohen në institucionet e specializuara të arsimit të lartë dhe përfshijnë njohuritë dhe të kuptuarit që ndërtohet dhe ndërlidhet me nivelin e 6. Programet hartohen dhe ofrohen në përputhje me ciklin e parë të procesit të Bolonjës dhe të përshkruesve relevantë të Dublinit të cilat shpijnë në gradën Master. Kualifikimet në këtë nivel kanë vlerë të kredisë me kohëzgjatje për një apo dy vjet të plota të studimit. Këto kualifikime janë akademike dhe profesionale;

• Programet e shkurtra të arsimit të lartë
Programet e shkurtra të specializuara shpijnë në kualifikime të caktuara dhe mund te ofrohen nga ofrues të arsimit të lartë. Trajnerët duhet të kenë njohuri të specializuara profesionale të këtij niveli. Nuk ka rregulla specifike në lidhje me përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e këtyre kualifikimeve.

Përparimi për kualifikimet e nivelit të 7

Niveli 7 i kualifikimeve ofron qasje në punësim dhe avancim në karrierë brenda fushës së specializuar. Individët, gjithashtu, kanë qasje për specializime të mëtejme në arsimin e lartë. Të mësuarit akademik do të sigurojë një bazë për përparim në studimet e doktoratës.

NIVELI 8

Përshkruesi:

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë
Ata do të kenë dhe përdorin njohuri shumë të avancuara në një fushë të punës, studimit apo fushë hulumtuese për ndërlidhjen e fushave të ndryshme, nxjerrjen e përfundimeve përmes rishikimit kritik të një lënde apo disipline, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive, parimeve dhe koncepteve.
Njohuritë dhe të kuptuarit gjenerohet përmes hulumtimit personal apo punës së ngjashme që kontribuon në zhvillimin e lëndës apo disiplinës dhe ofron njohuri origjinale dhe kreative si dhe ide dhe informacione për risitë, çështjet komplekse dhe abstrakte, duke zhvilluar qëndrime kreative dhe origjinale ndaj problemeve.

Kjo përfshinë:

• punën për risitë dhe çështje shumë komplekse si dhe të gjykuarit në mungesë të të dhënave apo informacioneve të plota ose të qëndrueshme;
• shtrimin, avancimin apo kundërshtimin e njohurive dhe praktikave profesionale brenda një fushe të caktuar ose ndërlidhjen mes fushave.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje të përdorin një varg të shkathtësive, teknikave, praktikave dhe materialeve të lëndës, disiplinës ose fushës së punës me qëllim të arritjes së njohurive, ideve, informacioneve dhe risive për çështje komplekse dhe abstrakte si dhe zhvillimin e qëndrimeve kreative dhe origjinale ndaj problemeve.
Kjo përfshinë aplikimin e një sërë metodash standarde dhe të specializuara të hulumtimit dhe kërkimit (psh. sintezës dhe vlerësimit) për ti dizajnuar dhe kryer projektet hulumtuese apo zhvillimore, me qëllim të zgjidhjes së problemeve kritike dhe shtrimin, avancimin apo kundërshtimin e njohurive apo praktikës profesionale, duke kontribuar për njohuri të reja brenda një disipline apo fushe arsimore. Kjo mund të përfshijë:
• rishikimin e literaturës, eksperimentimin dhe krijimin e qasjeve të tjera për një varg çështjesh;
• punime shkencore, shkrime dhe vështrime kritike, zhvillime inovative në një apo më shumë fusha të specializimit ose fushave kërkimore;
• përgatitja e tezës së doktoratës.

Kompetencat

Ata do të jenë autonomë dhe të ndërmarrin iniciativa për aktivitete profesionale dhe të ngjashme, duke demonstruar autoritet, qasje inovative dhe integritet arsimor dhe profesional që përfshinë nivelet më të larta në kontekst të punës, studimit apo hulumtimit në fushën ose disiplinën relevante.
Ata janë përgjegjës për punën e tyre dhe për punën e të tjerëve, duke demonstruar lidership dhe origjinalitet në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ata janë në gjendje të merren me çështje komplekse etike dhe profesionale, gjykimin e çështjeve të reja të paadresuara nga kodet apo praktikat aktuale profesionale dhe etike.

Treguesit e nivelit

Në kualifikimet e nivelit 8 bëjnë pjesë studimet e doktoratës të zhvilluara dhe ofruara në përputhje me procesin e Bolonjës dhe përshkruesit relevantë të Dublinit. Kualifikimet në nivelin e 8 përmbajnë ekspertizë sistematike në fushën e specializimit të lartë të njohurive dhe një kapacitet për analizë, vlerësim dhe sintezë kritike të ideve të reja dhe komplekse.

Këto kualifikime krijojnë aftësi për të konceptuar, dizajnuar, zbatuar dhe përshtatur proceset substanciale të hulumtimit. Këto kualifikime njohin edhe përvojën e udhëheqjes në zhvillimin e qasjeve të reja kreative, që zgjerojnë ose ridefinojnë njohuritë ose praktikën profesionale ekzistuese. Studimi për këto kualifikime realizohet në institucionet e arsimit të lartë.

Treguesit e nivelit në kontekst të studimit dhe punës

Kualifikimet në nivelin 8 shoqërohen nëpërmjet hulumtimit autentik, që zgjeron kufijtë e njohurive duke zhvilluar një produkt substancial, një pjesë e të cilit mund të referohet në publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kandidatët janë të aftë për analizë, vlerësim dhe sintezë kritike të ideve të reja dhe komplekse dhe pritet të jenë të aftë ti promovojnë zhvillimet teknologjike, shoqërore dhe kulturore të shoqërisë brenda kontekseve akademike dhe profesionale.
Mësimi për nivelin 8 të kualifikimeve zhvillohet në fusha të larta të specializuara profesionale, është i pavarur nga programet formale të mësimit dhe realizohet përmes vetiniciativës, që udhëhiqen nga ekspertë të nivelit të lartë. Individët që punojnë në këtë nivel mund ti aftësojnë të tjerët.

Përparimi në nivelin 8 të kualifikimeve

Kualifikimet e nivelit të 8 ofrojnë qasje dhe mundësi punësimi në fusha të specializuara dhe përparim në karrierë në vendet e punës ku kërkohen shkathtësi për hulumtime, punë shkencore dhe udhëheqje.

3.3. Përparimi dhe transferimi në KKK

3.3.1 Fushëveprimi i KKK

KKK është mekanizëm reformues i politikave të sistemit të arsimit dhe aftësimit. BE-ja vlerëson KEK si një "katalizator për reforma" dhe në kontekstin e objektivave për stimulimin e mësimit gjatë gjithë jetës. KKK krijon mundësi më të mëdha për kualifikime si dhe përfshirje të të gjitha formave të mësimit (formal, joformal dhe informal) brenda kornizës.

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE (KKK)
Neni 4: Shtrirja dhe struktura e KKK
1. KKK, e themeluar sipas dispozitave të këtij ligji, duhet ti përfshijë të gjitha llojet dhe nivelet e kualifikimeve dhe certifikimeve brenda një strukture të niveleve;
2. Avancimi nga niveli në nivel duhet të përcaktohet në bazë të rezultateve të kërkuara dhe gjithnjë e më komplekse të mësimit, të përcaktuara në kuadër të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të gjëra;
3. Kualifikimet e aprovuara për përfshirje në kornizë duhet të kenë vlera të kredive dhe të hartohen në atë mënyrë që ta lejojnë transferimin e kredive;
4. KKK duhet ti përfshijë:
4.1 Kualifikimet e dhëna në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit dhe aftësimit, duke përshirë programet parauniversitare, universitare dhe të aftësimit, arsimin dhe aftësimin për të rritur dhe mësimin gjatë gjithë jetës;
4.2 Certifikimin e rezultateve të mësimit jo formal dhe informal, duke përfshirë njohjen e mësimit paraprak dhe të arriturat e kandidatëve.
Nga Ligji mbi Kualifikimet Kombëtare (Nr. 03/L-060, 7 nëntor 2008)

KKK përfshinë të gjitha llojet e kualifikimeve dhe certifikimeve që ofrohen në Kosovë. Korniza përfshinë dhe klasifikon kualifikimet si dhe rregullon format e ofrimit dhe certifikimit të kualifikimit.
Objektivat e kornizës nuk janë vetëm për ta siguruar gjithëpërfshirjen dhe kuptueshmërinë, por edhe për të siguruar një sistem përparimtar dhe fleksibil, i cili mbështet dhe inkurajon zhvillimin e mësimit gjatë gjithë jetës për të gjithë.
Bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare me objektivat si: nxitjen e zhvillimit të mësimit gjatë gjithë jetës, rritjen e qasjes së vlerësimit dhe certifikimit dhe vendosjen e sistemit për akumulimin dhe transferimin e kredive, realizimi i këtyre objektivave nënkupton qasje të vazhdueshme në arsim dhe aftësim të kandidatëve, përparim nga niveli në nivelin tjetër si dhe mundëson transferim nëpërmjet formave të ndryshme të arsimit.
Qasja në kualifikime dhe përparimi ndërmjet niveleve të kualifikimeve apo formave të mësimit duhet të jenë jodiskriminuese.

3.3.2 Konceptet për qasje, përparim dhe transferim në KKK

Brenda kontekstit të mësimit gjatë gjithë jetës, KKK siguron mundësinë në të cilën kandidatët vazhdojnë ti zhvillojnë dhe përmirësojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e tyre gjatë gjithë jetës.
KKK u mundëson kandidatëve që të hyjnë dhe ri-hyjnë në sistemin e arsimit dhe aftësimit në kohë të ndryshme përgjatë jetës. Me këtë, rriten mundësitë e kandidatëve që ti përditësojnë njohuritë e tyre përmes kualifikimeve të vazhdueshme. Punësimi do të jetë në varësi të kualifikimeve të tyre.
Eliminimi i pengesave për qasje, përparim dhe transferim është prioritet në sistemin kombëtar të kualifikimeve në Kosovë.

3.3.3 Rrugët e përparimit

Kualifikimi në sistemin e arsimit dhe aftësimit duhet ti përmbajë kriteret hyrëse dhe ri-hyrëse. Rezultatet e kualifikimit të një niveli shërbejnë si kërkesë hyrëse për kualifikim në nivelin e ardhshëm. Poashtu, kriteret hyrëse të kualifikimit mund të caktohen varësisht nga lloji dhe përmbajtja e kualifikimit.

3.3.4 Qasja në arsim dhe aftësim për kandidatë me aftësi të kufizuar

KKK mbështet zbatimin e politikave dhe strategjive për përfshirjen e kandidatëve me aftësi të kufizuara me anë të:

• Kritereve dhe procedurave për përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatjen e kualifikimeve të arsimit dhe aftësimit për personat me aftësi të kufizuar;
• Implementimin e strategjisë për gjithëpërfshirje në institucione nëpërmjet proceseve të vetëvlerësimit dhe procesit të akreditimit;
• Zhvillimin e kualifikimeve në të gjitha nivelet e kornizës si dhe duke u mundësuar kandidatëve qasje në kualifikimet e veçanta për nivelet bazike;
• Implementimin e sistemit modular të kualifikimeve duke u mundësuar transferimin e kredive si dhe mundësinë e përzgjedhjes të moduleve të caktuara.

Zhvillimi i kualifikimeve sipas KKK

4. ZHVILLIMI I KUALIFIKIMEVE SIPAS KKK

Objektivat e KKK përmbushen nëpërmjet procesit të zhvillimit të kualifikimeve. Zhvillimi i kualifikimeve në KKK varet nga llojet e kualifikimeve.

4.1. Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm

Kualifikimet e arsimit të përgjithshëm zhvillohen nga MAShT. Kualifikimet e arsimit të përgjithshëm janë të bazuara në Kornizën Kurrikulare të Kosovës.
Kurrikulat e arsimit të përgjithshëm bazohen në rezultatet e të nxënit të përcaktuara për çdo nivel të arsimit. Kompetencat kyçe të parapara në kurrikulën e re, dalin nga synimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar në Kosovë dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, që nxënësit duhet ti arrijnë në mënyrë përparimtare dhe konsistente përgjatë sistemit arsimor parauniversitar.
Kualifikimet në arsimin e përgjithshëm jepen në fund të nivelit formal të arsimit nga ana e shkollave në përputhje me legjislacionin e përcaktuar nga MAShT. Cilësia e kualifikimeve në arsimin e përgjithshëm sigurohet nga Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në MAShT, në bazë të rezultateve të të nxënit për kompetencat dhe fushat kurrikulare. Si të tilla, ato janë automatikisht pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

4.2. Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit dhe aftësimit profesional

Kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional zhvillohen nga zhvilluesit të cilët në këtë rast janë MAShT, MPMS, ofruesit e AAP, shoqatat e biznesit, etj. gjithmonë në bashkëpunim me partnerët socialë.
Kualifikimet e zhvilluara për tu përfshirë në KKK i dorëzohen AKK për t'iu nënshtruar procesit të validimit dhe aprovimit.
Zhvillimi i këtyre kualifikimeve, sipas KKK, mbështetet në: lidhjet ndërmjet programeve dhe kualifikimeve, në lidhjen në mes kualifikimeve të ndryshme brenda kornizës, qasjes në kualifikim, vlerësimit dhe certifikimit, krijimit të rrugëve që shpijnë në kualifikim, përparim në nivele dhe lloje të ndryshme të kualifikimit, qasje modulare, sistem të kredive për njohjen, akumulimin dhe transferimin e kredive në mes të kualifikimeve, etj.

Për zhvillimin e këtyre kualifikimeve vlejnë këto kritere:

- Eliminimi i pengesave dhe diskriminimit për qasje, përparim dhe transferim në kualifikime dhe fleksibilitet për hyrje në kualifikime;
- Kualifikimet duhet të zhvillohen në mënyrë që ti plotësojnë qëllimet dhe objektivat e qarta;
- Metodat e vlerësimit duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin dhe nuk duhet të shkaktojnë pengesa për personat me nevoja të veçanta;
- Kualifikimet duhet të specifikohen në atë mënyrë që të:

a) mundësojnë vlerësim të hapur për të gjithë kandidatët të cilët konsiderohen të aftë dhe i plotësojnë kërkesat për kualifikim;
b) inkurajojnë ofrimin e kualifikimeve në mënyra të ndryshme në përputhje me nevojat e individëve;

• Struktura e kualifikimeve duhet të jetë modulare në mënyrë që ta sigurojë bazën për zhvillimin e sistemit të kredive dhe lehtësimin e akumulimit dhe transferimit të kredive;
• Modulet duhet të jenë të tilla që u mundësojnë kandidatëve të certifikohen edhe për kualifikime të pjesshme e jo vetëm për kualifikime të plota;
• Zhvilluesit e kualifikimeve duhet ti njohin dhe pranojnë kreditë nga kualifikimet e tjera.

Udhëzime më të hollësishme praktike gjenden në Pakon e Udhëzimeve të AKK "Zhvillimi i Standardeve Profesionale për AAP dhe Kualifikimeve".
Kur paraqitet një kualifikim për validim dhe aprovim për përfshirje në KKK duhet të përshkruhen specifikat në vazhdim:

• Titulli i kualifikimit/modulit;
• Arsyeshmëria e kualifikimit/modulit dhe dëshmitë se ka nevojë për këtë kualifikim/modul;
• Qëllimi i kualifikimit/modulit, grupi i synuar;
• Niveli i kualifikimit/modulit në KKK dhe vlera e kredisë;
• Kërkesat për qasje në kualifikim/modul dhe kërkesat e tjera për hyrje;
• Mundësia për përparim pas përfundimit të kualifikimit/modulit;
• Struktura e kualifikimit;
• Format e vlerësimit për arritjen e kualifikimit/modulit;
• Kërkesat specifike për sigurimin e cilësisë së kualifikimit/modulit;
• Specifikat tjera të hollësishme (psh. modulet, programet, etj.).
Specifikimi i kualifikimeve të AAP gjithashtu përfshinë përshkrimin dhe mënyrën e ndërlidhjes të kualifikimit me tregun e punës.

4.2.1 Kriteret e AKK për validimin e kualifikimeve profesionale për përfshirje në KKK

Kriteret për validimin e kualifikimeve janë përshkruar në Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Arsyeshmëria

Kualifikimet ose modulet e propozuara për validim duhet që:
• Të kenë një arsyetim të qartë, qëllime transparente, objektiva të qarta, të ofrojnë mundësi për përparim dhe të kenë mbështetje nga grupet e interesit;
• Kualifikimet profesionale duhet të kenë mbështetje brenda sektorit përkatës;
• Të ndërlidhen me një kualifikim të plotë ose nevoja të tjera të arsimit dhe aftësimit.

Vlera e kredisë dhe kohëzgjatja

Ky specifikim i kualifikimit përfshinë numrin e kredive dhe numrin e orëve të programit të nevojshëm për ta arritur kualifikimin.

Kërkesat hyrëse dhe qasja

• Njohuritë paraprake, arritjet ose përvoja për arritjen e një kualifikimi/moduli duhet të jenë të qarta;
• Kualifikimi/moduli nuk duhet të jetë objekt i diskriminimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta apo të ketë pengesa në qasje.

Përmbajtja, rezultatet dhe standardet

• Përmbajtja profesionale e kualifikimit/modulit duhet të bazohet në standardin e profesionit;
• Struktura e kualifikimit duhet të jetë modulare. Duhet të identifikohen qartë se cilat module janë të obligueshme ose cilat janë zgjedhore;
• Modulet duhet të shprehen qartë në rezultate të të mësuarit dhe të jenë të vlerësueshme;
• Rezultatet e mësimit duhet ti reflektojnë standardet profesionale dhe duhet të përfshijnë objektivat e vlerësimit.

Vlerësimi

• Specifikimi i kualifikimeve ose moduleve duhet të përfshijë një strategji të vlerësimit e cila është: e drejtë dhe objektive, e besueshme, e qëndrueshme, me kosto efektive dhe transparente;
• Kualifikimi përfshinë specifikimet për llojet e dëshmive të kërkuara për demonstrimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave.

Sigurimi i cilësisë

• Ofrimi, vlerësimi dhe certifikimi i kualifikimeve mbështetet nga mekanizmat e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë sigurimin e jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë.

Përparimi

• Kualifikimet duhen hartuar ashtu që t'u mundësojnë nxënësve/kandidatëve përparim të drejtpërdrejtë në punësim ose të mësuar të mëtutjeshëm me qëllim punësimi;
• Kualifikimet hartohen, poashtu, për të mundësuar përparim në kualifikimet tjera në fushën përkatëse ose fusha të përafërta.

4.3. Zhvillimi i kualifikimeve të arsimit të lartë

Kualifikimet e arsimit të lartë zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë. Kualifikimet e zhvilluara për t'u përfshirë në KKK i dorëzohen AKA për t'iu nënshtruar procesit të akreditimit. Kur paraqitet një kualifikim i arsimit të lartë për akreditim, për përfshirje në KKK duhet të përshkruhen specifikat në vazhdim:

• Arsyetimin e programit për tregun e punës (që do të ofrojë fakte për hulumtim të tregut të punës);
• Krahasimin ndërkombëtar të programit;
• Grupin (cakun) të cilit i dedikohet programi;
• Orientimin e programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit (deklarata e misionit);
• Qëllimin dhe profilin e programit të studimit (përshkrim i shkurtër i programit 7-10 fjali);
• Rezultatet e pritura të mësimit (të numërohen të paktën 7-10 kompetenca dhe kualifikime, njohuri dhe aftësi) për nivelin e propozuar të KKK;
• Raportin ndërmjet teorisë dhe praktikës si dhe pjesën eksperimentale të studimit;
• Vlerën e ECTS-së;

• Punën praktike - stazhin (të demonstrohet nëpërmjet marrëveshjeve të vlefshme me partnerët biznesorë);
• Planin e kërkimeve për programin e studimit i cili vlerësohet;
• Kriteret e regjistrimit dhe pranimit të studentëve.

Për më tepër, të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL) duhet të ofrojnë përshkrim të plotë të programit për secilin lëndë/modul:

• Përshkrimin (emrin);
• Përshkrimin e përmbajtjes;
• Synimet dhe rezultatet e pritshme të të mësuarit (5-7), (njohuritë, aftësitë dhe kompetencat);

Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

• Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë si dhe mjetet e konkretizimit/TIK;
• Raporti ndërmjet pjesës praktike dhe teorike të mësimdhënies;
• Literatura themelore që duhet shfrytëzuar për secilin lëndë/modul (një titull themelor dhe dy tituj suplementarë, jo më të vjetër se 10 vjet).

Kriteret për procesin e akreditimit janë dhënë në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

SISTEMI I KREDIVE

5. SISTEMI I KREDIVE

Një ndër qëllimet kryesore të KKK është "themelimi i sistemit të akumulimit dhe transferimit të kredive" (Ligji 03/L060 Neni 5, 1.6).
Të gjitha kualifikimet në KKK e kanë të bashkangjitur sistemin e kredive, përpos kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm.
Kualifikimet e arsimit të lartë kanë sistem të kredive që është në linjë me Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS). 1 kredi ECTS është e barabartë me 25-30 orë. Koha e kalkuluar për një vit të plotë akademik është 60 kredi. Të gjitha kualifikimet e AAP kanë sistem të kredive që është në linjë me Sistemin Evropian të Kredive për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (ECVET).

5.1 Zhvillimi i sistemit të kredive për AAP në Kosovë

Sistemi i kredive për AAP në Kosovë është në përputhje me ECVET. Siç është theksuar edhe më herët, ECVET është mekanizëm vullnetar dhe i decentralizuar i cili synon t'ua lehtësojë individëve transferimin ndërmjet ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional në Evropë, ta njohë të mësuarit e tyre në Evropë dhe ta fuqizojë partneritetin institucional në AAP. Zhvillimi i sistemit të kredive në Kosovë është në përputhje me zhvillimet e ECVET.

5.2 Qëllimi i sistemit të kredive

Qëllimi i sistemit të kredive është që t'u mundësojë individëve ti akumulojnë dhe transferojnë rezultatet e mësimit ndërmjet konteksteve të ndryshme të mësimit apo sistemeve, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin formal, joformal dhe informal. Gjithashtu, ofron një mekanizëm nëpërmjet të cilit të mësuarit e fituar në mënyrë joformale dhe informale do të njihet formalisht.
Akumulimi i kredive i referohet procesit nëpërmjet të cilit të nxënit e fituar në kontekste të ndryshme mund të rritet drejt një kualifikimi të veçantë.
Transferimi i kredive mundëson që të nxënit e fituar në një institucion, sektor apo fushë të caktuar të transferohet te një kualifikim, institucion, sektor apo fushë tjetër.
Sidoqoftë, qëllimi i sistemit të kredive në Kosovë është të:

- Mundësojë që rezultatet e të nxënit të fituara në kontekstin formal, joformal dhe informal të mund të akumulohen dhe numërohen drejt kualifikimeve;
- Lehtësojë transferimin e të nxënit nga një kontekst në kontekstin tjetër për validim dhe njohje;
- Rrisë mundësitë për nxënësit që të kenë qasje në programet e arsimit dhe aftësimit;
- Rrisë mundësitë për lëvizshmërinë e nxënësve ndërmjet konteksteve të ndryshme;
- Bëjë përparime brenda programeve të mësimit dhe ti lehtësojë rrugët drejt tyre;
- Shmangë përsëritjet e panevojshme të të nxënit, të cilat tashmë janë fituar dhe të sigurojë mekanizma për njohje të mësimit paraprak.

5.2.1 Integrimi i sistemit të kredive në KKK

Sistemi i kredive për AAP në Kosovë është bazuar në karakteristikat e mëposhtme të KKK:

- Kualifikimet e bazuara në rezultate të të nxënit dhe të vendosura te një nivel i KKK;
- Modulet si pjesë e kualifikimeve të vendosura te një nivel i KKK;
- Pikët e kredisë;


• Hartimi i kualifikimit;
• Institucionet e caktuara përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së vlerësimit.

Lidhja me ECVET

ECVET bazohet në:

- Kualifikimet e shprehura si rezultate të të nxënit;
- Rezultatet e të nxënit të caktuara te nivelet në KEK;
- Modulet e kualifikimeve;
- Pikët e kredive ECVET;
- Institucionet kompetente për sigurimin e cilësisë dhe të vlerësimit.

Integrimi i sistemit të kredive në KKK është prezantuar në diagramin në vijim:



5.2.2 Çka është "kredia"?

Kredia jepet me rastin e njohjes së rezultateve të arritura të mësimit.
Në Kosovë kredia mund të jepet për arritjen e rezultateve të mësimit në kualifikime apo të një pjese të kualifikimit (Ligji 03/L-060, Neni 2).

ECVET e definon kredinë si:

Një sërë rezultatesh të të nxënit të cilat janë vlerësuar dhe të cilat mund të akumulohen apo transferohen drejt një kualifikimi.

Në Kosovë kualifikimet do të përbëhen nga modulet. Një modul është pjesë përbërëse e një kualifikimi, i cili paraqet pjesën më të vogël të kualifikimit të cilës i lejohet certifikimi.
Një modul përbëhet nga një grup koherent i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të shprehura në formë të rezultateve të mësimit dhe kritereve të vlerësimit. Secili modul ka vlerë të kredive.

Në Kosovë Ligji për Kualifikimet Kombëtare e definon kredinë si: një vlerë numerike e cila iu jepet kualifikimeve, apo pjesës të kualifikimeve, e cila paraqet vëllimin e mësimit që kërkohet të arrihet kualifikimi apo pjesa e kualifikimit. Kredia mund të akumulohet drejt një kualifikimi apo transferohet ndërmjet kualifikimeve apo sistemeve të kualifikimeve (Ligji 03/L-060, Neni 2).
Madhësia e kredisë varet nga "vëllimi i mësimit", i cili kërkohet për ti arritur rezultatet. Duke përdorur kredinë si masë të vëllimit të mësimit, KKK mund të njohë çfarëdo madhësie të kualifikimit apo modulit të ofruar, i cili plotëson kërkesat për vlerën minimale të kredisë.
Kreditë u caktohen kualifikimeve dhe moduleve nga zhvillues të ndryshëm të AAP, derisa ata i plotësojnë kërkesat për kredi të cilat janë:
• Kualifikimi ose moduli duhet të validohet nga AKK;
• Çdo modul të cilit i është caktuar një kredi është e nevojshme që volumi i të mësuarit së paku ta ketë vlerën e një kredie;
• Rezultatet e mësimit duhen të jenë subjekt i metodave të vlefshme dhe të besueshme të vlerësimit;
• Rezultati i vlerësimit të rezultateve duhet të dokumentohet;
• Vlerësimi duhet të jetë subjekt i sigurimit të jashtëm të cilësisë nga AKK.

5.2.3. Shfrytëzimi i marrëveshjes së pikëve të kredive për ndarjen e vlerës së kredisë në kualifikime dhe module

Metodat për ndarjen e vlerës së kredisë për kualifikime dhe modulet janë në përputhshmëri me ECVET. Kjo i mundëson Kosovës që të marrë pjesë në bashkëpunime rajonale dhe evropiane të programeve të AAP dhe ta mbështesë lëvizjen e individëve në mes të ofruesve të AAP.

Nga publikimi i dokumentit të KKK marrëveshja për sistemin e kredive ka qenë 1 me 10 orë. Në funksion të ngritjes së cilësisë dhe plotësimit të kërkesave të tregut të punës dhe konkurrueshmërisë, AKK me institucionet dhe palët e tjera relevante janë marrë vesh për kohën e nevojshme për arritjen e rezultateve të mësimit në një modul, prandaj, është përcaktuar që vlera e një kredie të jetë e barabartë me 20 orë, gjë që mundëson:

• përfshirjen e kurseve të shkurtra për të rriturit duke përfshirë edhe modulet e ofruara përmes mësimit joformal dhe informal;
• rritjen e cilësisë duke rritur kohën e nevojshme për arritjen e rezultateve;
• lehtësimin për të komunikuar dhe kuptuar nga përdoruesit;
• shndërrimin më të lehtë të pikëve nga ECVET në ECTS.

Çka është "një orë"

Në Kosovë "një orë" ka domethënie të ndryshme në ambiente të ndryshme të AAP. Brenda AAP formale një orë mësimdhënie është 45 minuta. Megjithatë, në qasjen joformale një orë zakonisht zgjatë 60 minuta.
Koncepti i orës për kredi përdoret për të zhvilluar një kuptim të përbashkët. Ora e përcaktuar për kredi përfshinë të gjitha aktivitetet e mësimit që janë të përfshira në arritjen e rezultateve specifike, duke përfshirë detyrat e shtëpisë dhe vlerësimin.

Akordimi për sistemin e kredive të AAP

- Pranueshmëri për të gjitha institucionet e AAP;
- Gjithëpërfshirja për të gjitha format e AAP: formal, joformal dhe informal;
- Mbështetje për lëvizshmërinë e nxënësve/kandidatëve për transferim në sistemin e AAP;
- Mbështetje për fleksibilitet në AAP;
- Mundësoj përparim dhe ti ndihmoj nxënësit gjatë matjes së përparimit të tyre në sistem;
- Mbështetje për partneritet ndërmjet institucioneve të AAP;
- Mbështetje për regjistrimin e të arriturave;
- Përshtatshmëri për certifikimin;
- Transferim dhe njohje më të lehtë në AL;
- Krahasueshmëri me ECVET.

5.2.4 Vlera e kredisë si numër i plotë

Vlera e kredisë është e barabartë me 20 orë mësim. Nëse koha e vlerësuar e mësimit nuk mund të ndahet saktësisht në një numër të plotë, atëherë, atë duhet rrumbullakuar (psh. deri në 4.4 bëhet 4 kredi, ndërsa nga 4.5 e tutje bëhet 5 kredi). Kjo llogaritje bëhet për shkak se kredia duhet të jetë numër i plotë, psh. koha e të mësuarit nënkupton kohën e shpenzuar nga një nxënës/kandidat me nivel mesatar për arritjen e rezultateve të mësimit. Vlera minimale e kredisë për një modul në KKK është 1, ndërsa vlera maksimale nuk është e kufizuar.

5.2.5 Dizajnimi i kualifikimeve për akumulim dhe transferim të kredive

Për ta lejuar akumulimin dhe transferimin e kredive, kualifikimet duhet të hartohen sipas:

- sistemit modular;
- kritereve për mënyrën se si kreditë mund të kombinohen për të arritur një kualifikim;
- kritereve për mënyrën se si moduli dhe kualifikimi i plotë mund të vlerësohet.

5.2.6 Kush mund të hartoj kualifikime dhe të caktoj kredi?

Sistemi i kredive cakton kufizime për atë se kush mund të zhvilloj kualifikime të bazuara në kredi dhe kriteret të cilat duhet të plotësohen nga ai institucion.

Kualifikimet e AAP zhvillohen nga një numër i konsiderueshëm i institucioneve, përfshirë ministritë, agjencitë, ofruesit publikë dhe privatë të aftësimit, kompanitë, punëdhënësit, etj.

Për hartimin e kualifikimeve dhe caktimin e kredive institucioni duhet ti plotësojë kriteret siç janë:

- Mbajtja e të dhënave për hartimin dhe ofrimin e kualifikimit/modulit;
- Sistemi i sigurimit të cilësisë për hartimin e programit, procesi i miratimit, vlerësimit, duke përfshirë proceset e rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm;

• Zbatimi i udhëzimeve për caktimin e kredive;
• Kapacitetet njerëzore për zhvillimin e kualifikimeve në fushën e kualifikimit.

Personat të cilët janë përfshirë në caktimin e kredive duhet të jenë ekspertë të fushës përkatëse dhe ti plotësojnë këto kushte:

• Njohuri rreth kritereve të KKK;
• Përvojë për caktimin e nivelit dhe vlerës së kredisë;
• Përvojë për sigurimin e cilësisë rreth mësimit/trajnimit dhe vlerësimit të lëndës apo fusha e sektorit përkatës.

Këto procese janë të vlefshme në mënyrë që të sigurohet se, procesi i caktimit të kredive është i përshtatshëm dhe se përdoruesit mund të besojnë te vlerësimi i kredive të dhëna. Dëshmitë rreth procedurave për dhënien e kredive, duhet të paraqiten në AKK me rastin e aplikimit për validim të kualifikimit.

ECVET

Rregullat dhe procedurat për definimin e karakteristikave të moduleve të rezultateve të nxënit dhe për kombinimin dhe akumulimin e moduleve për një kualifikim të dhënë janë definuar nga institucionet kompetente dhe partnerët e përfshirë në procesin e trajnimit,në përputhje me rregullat kombëtare dhe rajonale.

AKK është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së sistemit të kredive në AAP. Si pjesë e procesit të validimit të kualifikimit, AKK do të sigurojë se:
• Kualifikimi/moduli definohet në mënyrë të duhur për ti plotësuar nevojat e tij;
• Niveli i vlerës së kredisë së kualifikimit/modulit identifikohet në mënyrë të saktë;
• Kërkesat e vlerësimit definohen qartë duke përfshirë proceset sesi mund të vlerësohen rezultatet dhe sigurohet cilësia e tyre;
• Kërkesat e sigurimit të cilësisë përfshijnë diskutimet për caktimin e regjistrimit të të arriturave të nxënësve dhe arkivimin e të dhënave zyrtare të vlerësimit.

5.2.7 Si ndahet kredia?

Kredia i jepet një individi. Ajo ndahet atëherë kur rezultatet e të nxënit janë vlerësuar dhe dokumentuar. Kreditë fitohen pasi që vlerësimi i rezultateve të të nxënit duhet:

• Kryer nga një institucion i akredituar;
• Ti plotësojë kriteret e cilësisë së atij institucioni;
• Ti plotësojë kriteret e vlerësimit të përcaktuara në kualifikim/modul;
• Të jetë i dokumentuar zyrtarisht në përputhje me procedurat e certifikimit të kërkuara nga institucioni i dhënies së kualifikimit.

ECVET: Caktimi i pikëve për module sipas ECVET

Vlera e kredisë për modul kalkulohet sipas peshës relative që moduli ka brenda kualifikimit. Kjo, mund ta përfshijë kohën që nevojitet për ta përfunduar modulin, por, mund të merren parasysh edhe faktorë të tjerë, si: rëndësia e modulit në tregun e punës, kompleksiteti i të nxënit, përfshirë edhe përpjekjet që nxënësi duhet ti bëjë.


5.2.8 Regjistrimi i kredive

Institucionet do të duhej të mbanin shënime mbi dhënien e kredive për kandidatët. Institucionet/ofruesit duhet ti regjistrojnë:

- Të dhënat e individit;
- Kreditë e dhëna në kuadër të moduleve dhe kualifikimeve;
- Datën e dhënies së secilës kredi.

5.2.9 Si transferohen kreditë?

Institucionet e akredituara janë përgjegjëse për transferimin dhe njohjen e kredive të arritura nga kandidatët (Ligji 03/L-060, Neni 17 (1.3).



Transparenca për transferimin dhe njohjen e kredive është kriter për mbështetje të nxënësve/kandidatëve, si dhe siguron besueshmëri në sistemin e kredive. Institucioni vlerësues merr vendim për pranimin e kredive për transferim duke u bazuar në:

- Aranzhimet e transferimit të kredive në specifikat e kualifikimit;
- Krahasimin e rezultateve të mësimit të kualifikimit, të realizuar me kërkesat e kualifikimit të ri.

Në mënyrë që të mbështetet transferimi i kredive, institucionet duhet ti kenë:

- Parimet dhe procedurat për transferimin e kredive;
- Mekanizmat e sigurimit të cilësisë, përfshirë mekanizmat për monitorimin dhe transferimin e kredive;

• Informatat e qarta dhe të qasshme për stafin;
• Personel/staf me përgjegjësi për marrjen e vendimeve rreth transferimit të kredive me njohuri rreth KKK, si dhe fushës dhe nivelit përkatës;
• Sistem mbështetës i cili u siguron kandidatëve informata dhe këshilla;
• Mundësi të transferimit të kredive me kohë që përkon me qasjen e kualifikimit.

Të gjitha kualifikimet e vendosura në Kornizë me marrëveshje të kredive të KKK të botuar në vitin 2011, pas aprovimit të këtij dokumenti të KKK, do të validohen sipas udhëzimeve të reja në fuqi.

NJOHJA E MËSIMIT PARAPRAK

6. NJOHJA E MËSIMIT PARAPRAK

Njohja e mësimit paraprak rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare në Republikën e Kosovës. Një nga objektivat kryesore të ligjit është përmirësimi i vlerësimit të kualifikimeve, duke përfshirë përgatitjet për njohjen e mësimit paraprak.

Njohja e Mësimit Paraprak (NjMP) i referohet njohjes së mësimit formal, joformal dhe informal në punë apo nëpërmjet aktiviteteve të tjera, të cilat janë të pranueshme nëpërmjet procesit të identifikimit, vlerësimit dhe njohjes formale të shkathtësive të fituara.
Mësimi formal përfshihet në këtë përkufizim, në mënyrë që ti mbulojë personat të cilët nuk janë në gjendje që nëpërmjet certifikatave apo dokumenteve tjera, ta dëshmojnë mësimin e tyre formal, apo ata të cilët kanë certifikata nga programet e mësimit formal që nuk janë të akredituara.

Duke u bazuar në këtë ligj është zhvilluar legjislacioni sekondar, lidhur me kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Legjislacioni për Njohjen e Mësimit Paraprak përfshinë parimet, përgjegjësitë dhe procedurat e përgjithshme për zbatimin e njohjes së mësimit joformal dhe informal, në të gjitha nivelet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), duke përfshirë jo vetëm AAP, por, edhe arsimin e lartë, me përjashtim të arsimit të përgjithshëm. Kjo, përbën kornizën kyçe rregulluese për NjMP në vend.

Sektori i arsimit të lartë nuk ka vazhduar zhvillimin e politikave dhe mekanizmave për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë. Nga ana tjetër, AKK ka zhvilluar, me mbështetjen e Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF), politikën kombëtare për njohjen e mësimit paraprak në AAP.

Dokumenti i politikës u zhvillua si rezultat i konsultimeve të gjera me palët e interesuara, përfshirë Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Agjencinë e Punësimit dhe ofruesit e akredituar publikë dhe privatë.

Dokumenti siguron udhëzime që duhen ndjekur dhe kërkesat që duhen përmbushur, në mënyrë që të ndërtohet dhe mbahet një sistem i sigurimit të cilësisë së NjMP. Dokumenti do ti mbështesë ofruesit dhe organizatat e tjera të përfshira në zbatimin e NjMP, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë ose azhurnojnë politikat dhe udhëzimet e tyre të vlefshme, për ti përmbushur kërkesat e AKK, të specifikuara në dokument. Kjo vlen për ofruesit që janë akredituar për implementimin e NjMP dhe për ata që dëshirojnë të aplikojnë për ta implemetuar atë.

6.1 Synimet e NjMP

Synimet e NjMP përfshijnë:

- Mundësimin e qasjes në edukimin relevant dhe trajnimin;
- Përshtatjen e trajnimit me nevojat specifike të nxënësve;
- Shkurtimin e kohës së shpenzuar në trajnim;
- Mundësinë e qasjes në tregun e punës përmes certifikimit;
- Konvertimin e certifikatave me më pak kredibilitet në certifikata të njohura;
- Vendosjen e kandidatëve në një nivel të duhur në programin e trajnimit.

6.2 Procesi i NjMP

Procesi i NjMP në AAP përcaktohet në katër faza kryesore si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimi, informimi dhe udhëzimi për kandidatët

Në këtë fazë kandidatët e interesuar për NjMP duhet të informohen nga koordinatori i NjMP për të gjithë procesin. Kjo përfshinë: mundësinë e marrjes së një kualifikimi të plotë ose kualifikimi të pjesshëm përmes NjMP, kriteret dhe standardet, domosdoshmërinë për të paraqitur një dosje të provave, burimet e mbështetjes dhe udhëzimet në dispozicion për kandidatin, afatet kohore, procedurat e ankimimit dhe implikimet financiare.

2. Dokumentimi i provave

Nëse kandidati vendos ti nënshtrohet procesit të NjMP, ai duhet të mbledhë prova të vlefshme, të mjaftueshme për ta fituar modulin/kualifikimin nëpërmjet NjMP. Provat strukturohen në formën e një portofoli i cili përmban:

- CV-në;
- Përshkrimin e përvojës së kandidatit në lidhje me rezultatet e të nxënit të modulit/kualifikimit, për të cilat aplikon për certifikim;
- Dëshmi (diploma, certifikata, raport të notave, etj.) për përfundimin e programeve arsimore dhe trajnimeve;
- Dëshmi mbi përvojat në edukimin joformal dhe trajnime (certifikata të pjesëmarrjes, raporte, punë në grup, etj.);
- Dëshmi mbi përvojën e punës të fituar në fushën përkatëse ose në tema të caktuara që lidhen me kualifikimin e zgjedhur;
- Dëshmi tjera përkatëse që mbështesin punën dhe përvojën e jetës së kandidatit;
- Një deklaratë për dosjen/dokumentet e dorëzuara, etj.

Për ta siguruar vlefshmërinë e dëshmive në dosje, të gjitha pjesët e ofruara të dëshmive duhet të lidhen me rezultatet përkatëse të të nxënit të modulit/kualifikimit. Shembull; kur përdoren fotografitë, procesi i punës në fotografi duhet të elaborohet dhe të lidhet me pjesën përkatëse të modulit/kualifikimit.

3. Vlerësimi

Në këtë fazë, pas përpilimit të dosjes, kandidati i nënshtrohet vlerësimit të dëshmive të paraqitura, për ta fituar modulin/kualifikimin nëpërmjet NjMP nga paneli i vlerësuesve të vlerësimit. Paneli përbëhet nga, të paktën, tre vlerësues, njëri prej tyre duhet të jetë vlerësues i jashtëm. Përbërja dhe numri i vlerësuesve në panelin e vlerësimit përcaktohet gjatë procesit të akreditimit nga AKK, në varësi të llojit dhe madhësisë së kualifikimit. Kandidati duhet ta bëj regjistrimin e vlefshëm të paktën 20 ditë pune përpara (koha e nevojshme për kandidatin për të përpiluar një dosje të mjaftueshëm dhe autentike të provave) për vlerësim.
Përveç dorëzimit të provave nëpërmjet dosjes, kandidati i nënshtrohet një vlerësimi përfundimtar që do ti vlerësojë aftësitë dhe kompetencat e kërkuara nga rezultatet e të nxënit, të fituara nga mësimi paraprak. Me fjalë tjera, dorëzimi i dosjes është parakusht që kandidati të jetë në gjendje ti nënshtrohet vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar duhet të jetë i dizajnuar për ti vlerësuar të gjitha rezultatet e të nxënit të modulit, njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat. Prandaj, nëse një kandidat dëshiron ta fitojë kualifikimin e plotë, detyra përfundimtare duhet të jetë e dizajnuar për ti vlerësuar rezultatet e të nxënit të të gjitha moduleve në kualifikim.
Kohëzgjatja e vlerësimit përfundimtar ndryshon varësisht llojit dhe madhësisë së modulit/kualifikimit (psh. sektori i ndërtimit mund të ketë disa module që kërkojnë shumë përgatitje dhe kohë për ti demonstruar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e kërkuara, ndërsa floktarët mund të jenë në gjendje të demonstrojnë shumë module në një ditë). Instrumentet janë të njëjta, sikurse për kandidatët që ndjekin rrugën formale të mësimit për vlerësim, siç janë demonstrimi i aftësive praktike, vëzhgimi, simulimi, etj.
Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm dhe i besueshëm për ta siguruar integritetin e kualifikimit dhe të sistemit NjMP.
Vendimi i vlerësimit për detyrën përfundimtare të realizuar nga kandidati mund të jetë:

- "kalon", kur kandidati vlerësohet ti ketë përmbushur kriteret e mjaftueshme të vlerësimit;
- "kalon pjesërisht", kur kandidati vlerësohet ti ketë përmbushur kriteret e vlerësimit për një pjesë të rezultateve të të nxënit brenda modulit ose kualifikimit të zgjedhur;
- "nuk kalon", kur kandidati vlerësohet të mos ketë përmbushur kriteret e kërkuara të vlerësimit.

Paneli i vlerësimit i informon personat përgjegjës të ofruesit për vendimin e vlerësimit. Kandidati do të informohet për vendimin jo më vonë se 5 ditë pune nga data e vlerësimit.

4. Procedura e certifikimit dhe e ankimimit
Pas vlerësimit se një kandidat ka siguruar prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme, sipas standardeve dhe rezultateve të të nxënit për të fituar një kualifikim të plotë ose të pjesshëm, ofruesi i akredituar do të lëshojë një certifikatë/diplomë në përputhje me arritjet e kandidatit.
Kur një kandidati i është dhënë një certifikim i pjesshëm dhe dëshiron ta marrë kualifikimin e plotë, atëherë, kjo duhet të bëhet brenda një periudhe jo më shumë se tri vjet nga data e parë e vlerësimit. Mentori do ta këshillojë kandidatin për trajnime të mëtejshme të nevojshme dhe mundësitë e trajnimit për të marrë certifikim të plotë.

Certifikatat/diplomat e marra nëpërmjet NjMP janë të njëjta me ato të marra nëpërmjet një certifikimi përmes rrugëve formale ose joformale.

Nëse një kandidat dëshiron të ankohet kundër vlerësimit të tij/saj, ai duhet ti ndjekë procedurat standarde të ankesave të ofruesit. Ankesa do të shqyrtohet nga vlerësuesit e pavarur të brendshëm dhe të jashtëm. Nëse ankesa mbetet e pazgjidhur atëherë kandidati do ti referohet AKK për shqyrtim.

Ky proces do të mbështetet nga ekipi i profesionistëve të NjMP brenda institucionit që zbaton NjMP si në vijim:

- **Koordinatori i NjMP**
  Është përgjegjës për koordinimin e mekanizmave të NjMP për sigurimin e cilësisë, komunikimin ndërmjet personelit të përfshirë në çfarëdo aspekti të NjMP, ofrimin e informatave për dokumentacionin e kandidatit, dëshmitë dhe përshkrimin e dosjes si dhe mbështetjen e kandidatëve përgjatë të gjitha fazave të procesit të NjMP, duke u ofruar informata, këshilla dhe udhëzime të nevojshme.

- **Mentori i NjMP**
  Është përgjegjës për këshillimin dhe mbështetjen e kandidatëve për krijimin e dosjes me dëshmi të nevojshme, që lidhen me rezultatet e pritshme (rezultatet e mësimit modulit/kualifikimit të zgjedhur).

- **Vlerësuesi i brendshëm i NjMP**
  Është përgjegjës për mbështetjen e procesit të përpilimit të dosjes, duke validuar dëshmitë e mbledhura kundrejt rezultateve të mësimit të modulit/kualifikimit përkatës.

- **Vlerësuesi i jashtëm i NjMP**
  Është përgjegjës ta vlerësojë dosjen e dorëzuar dhe ta vlerësoj detyrën e fundit të kandidatit kundrejt rezultateve të mësimit të modulit/kualifikimit.

6.3 Sigurimi i cilësisë së NjMP

NjMP mund të zbatohet vetëm nga institucionet e akredituara nga organet rregullatorë, siç janë, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ose Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AKA). Korniza e qartë ligjore ekziston për akreditimin e institucioneve për zbatimin e NjMP në AAP, që përcakton mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të Sigurimit të Cilësisë (SC). Për t'u akredituar për zbatimin e NjMP, institucionet duhet ti plotësojnë kriteret specifike siç janë mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë, pajisjet specifike, etj.
Kriteret e akreditimit që duhet të përmbushen nga ofruesi që aplikon për ta zbatuar NjMP në AAP janë si më poshtë:

• Ofruesi duhet ta ketë hartuar një politikë të shkruar të NjMP, në përputhje me dokumentin e politikës kombëtare të miratuar nga AKK. Politika duhet ti marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Kandidatët potencialë;
- Kualifikimet e ofruara;
- Financimin dhe financuesit;

- Burimet e ofruesit dhe objektivat e rritjes;
- Trajtimin e barabartë;
- Mbrojtjen e të dhënave;
- Sigurimin dhe monitorimin e cilësisë.

• Ofruesi duhet të ketë zhvilluar një sistem për ta mbështetur dhe regjistruar vlerësimin e NjMP për secilin kandidat (rregullore përkatëse, udhëzime, manuale, etj.);
• Ofruesi duhet të ketë zhvilluar një sistem të brendshëm për ta siguruar cilësinë e vlerësimit dhe certifikimit të NjMP për secilin kandidat (rregulloret relevante, udhëzimet, manualet, etj.);
• Ka personel të caktuar me kualifikime të përshtatshme për ta mbështetur dhe siguruar procesin e NjMP (koordinatorë të NjMP, mentorë të NjMP, vlerësues të brendshëm dhe vlerësues të jashtëm);
• Përveç personelit të caktuar, ofruesi duhet të ketë një skemë trajnimi për të gjithë personelin e përfshirë me ndonjë aspekt të NjMP;
• Ofruesi duhet të ketë një proces të ankimimit së bashku me hollësitë se si ofruesi siguron që kandidatët të dinë sesi t'i qasen procesit të ankimimit;
• Ofruesi duhet të ketë një stabilitet institucional dhe financiar, duke detajuar se si procesi i NjMP është i qëndrueshëm.

Akreditimi bëhet për secilin kualifikim të AAP për një periudhë të caktuar kohore. Ofruesit do të duhej të aplikojë për riakreditim.
Procedurat e monitorimit pas akreditimit janë pjesë integrale e sigurimit të jashtëm të cilësisë për zbatimin e NjMP.

6.4 Kostoja e procesit të NjMP

Kur bëhet fjalë për kostot e procesit të vlerësimit, tarifat do të llogariten nga ofruesit e akredituar bazuar në llojin dhe madhësinë e modulit/kualifikimit, që do të vlerësohet në përputhje me parimet e udhëzimeve evropiane dhe procedurave të brendshme.[6]
Udhëzimet evropiane ofrojnë tri mundësi për llogaritjen e kostos së procesit të NjMP-së:[7]

• Tarifat bazuar në kohën e kaluar për përfundimin e vlerësimit;
• Tarifat e zakonshme, pavarësisht nga koha e kaluar ose numri i certifikatave;
• Tarifat bazuar në vëllimin dhe nivelin e certifikatave.

[6] *Shiko referencat 1*
[7] *Udhëzime Evropiane për vërtetimin e mësimit informal dhe joformal, CEDEFOP, 2009*

STANDARDET NË KKK

7. STANDARDET NË KKK

7.1 Standardet për kualifikimet e AAP

Kualifikimi profesional është njohje zyrtare e të arriturave të kandidatit pas realizimit të kënaqshëm në një test apo provim, e cila shpie deri te një diplomë ose certifikatë në arsimin dhe aftësimin profesional. Në një kuptim më të gjerë, dëshmon të arriturat e kandidatit brenda një profesioni të caktuar. Gjithashtu, përcakton kërkesat e kandidatit për të hyrë apo për të bërë përparim brenda një profesioni.
Kualifikimet profesionale hartohen për ti plotësuar kërkesat në vendin e punës apo profesionit, pra ato lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e sektorit përkatës dhe tregut të punës.
Ekzistojnë tri komponentë, të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të kualifikimeve profesionale për ti plotësuar nevojat e punësimit:

• **Punësueshmëria,** psh. çfarë njohurish, shkathtësish dhe kompetenca duhet ti zotërojë një kandidat, që të jetë në gjendje ta ushtrojë në mënyrë kompetente funksionin apo profesionin;
• **Të mësuarit,** psh. çfarë duhet një kandidat të përvetësojë apo arrijë që ta ushtrojë funksionin apo profesionin;
• **Vlerësimi,** psh. si do të vlerësohen të arriturat e kandidatëve në mënyrë që të dëshmohet se kandidati është në gjendje ta ushtrojë funksionin apo profesionin.
Me kompetencën profesionale kuptojmë, atë që individi është në gjendje ta bëjë në mënyrë efektive në profesionin e caktuar, duke i plotësuar kërkesat e tregut të punës.
Treguesit se kërkesat e tilla janë plotësuar njihen si standarde. Nocioni i standardeve vendos një theks të veçantë në rezultate dhe nënkupton se ato duhet të jenë të matshme, duke u bazuar në kriterin objektiv me të cilin të arriturat e tyre mund të vlerësohen.
Sistemi i AAP përfshinë karakteristikat e punësimit, kërkesat e mësimit dhe vlerësimit duke u bazuar në standarde si bazë për specifikimin e kërkesave të kualifikimit.
Nocioni i "standardeve" është ngushtë i lidhur me konceptin e kualifikimeve profesionale. Megjithatë, termi "standarde" mund të përdoret në një numër kontestesh të ndryshme, ku secila prej tyre ka një domethënie të veçantë. Për shembull:


• standardi i kualifikimit i referohet cilësisë së kualifikimit në përgjithësi ose kritereve për ofrimin e një kualifikimi;
• masat kur kandidati i plotëson kërkesat për provim apo vlerësim iu referohen standardeve të vlerësimit dhe testimit;
• masave të cilësisë mund t'u referohemi edhe si standarde të cilësisë.
Si përmbledhje, ekzistojnë koncepte të ndryshme të standardeve, por:
• Standardet bazohen në rezultate;
• Standardet gjithmonë duhet të jenë të matshme;
• Standardet duhet ti përfshijnë kriteret objektive për t'u vlerësuar nëse ato janë arritur.

7.2 Standardet e profesionit

7.2.1 Përkufizimi i standardeve të profesionit

Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional i përcakton standardet e profesionit si: "Standardet e profesionit" janë njësi për ta matur shkallën deri në të cilën një individ mund ti përmbushë kërkesat për realizim në një profesion të veçantë ose grup profesionesh, me qëllim që të hyjë ose përparojë në kuadër të një profesioni ose fushe përkatëse profesionale.

Ato caktohen në nivel kombëtar për individët e punësuar që punojnë brenda një profesioni ose fushe profesionale të veçantë, si dhe ofrojnë bazën për zhvillimin e kurrikulës profesionale dhe vlerësimit.
Zhvillimi i standardeve të profesionit sipas formatit të caktuar mundëson konsistencën kombëtare, ndihmon duke siguruar se këto standarde janë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e ndryshëm, pra nga punëdhënësit, administruesit e burimeve njerëzore, mësimdhënësit, trajnerët, personat e ndryshëm, etj.
Standardi i profesionit është pikënisje për zhvillimin e kualifikimit, kurrikulës, programit, kritereve të vlerësimit, rezultateve mësimore, etj.



Standardi i profesionit zhvillohet në bashkëpunim: MAShT, MPMS, ministritë tjera relevante, partnerët socialë dhe shoqatat e zejtarëve. Standardi i profesionit zhvillohet duke u bazuar në metodat për zhvillimin e tyre si dhe bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Standardi i profesionit verifikohet nga AKK. Standardi i profesionit i cili kalon në procesin e verifikimit dhe miratohet nga KAAPRr quhet standard kombëtar i profesionit.
Gjatë përcaktimit të standardit të profesionit për kualifikim është e nevojshme që të analizohet profesioni, në mënyrë që të identifikohet qëllimi i tij, përmbajtja dhe kërkesat e performancës.

Standardet e profesionit zhvillohen duke pasur parasysh këto kritere:

• Qëllimin kyç të profesionit dhe vendin e tij në strukturën e përgjithshme të profesioneve dhe Librin e Klasifikimit të profesioneve në Kosovë;
• Funksionet kryesore të ushtruara brenda profesionit;
• Aktivitetet kyçe të përfshira gjatë ushtrimit të funksioneve;
• Kërkesat e performancës për secilin aktivitet;
• Një mori kontestesh dhe kushtesh brenda të cilave përmbushen aktivitetet, përfshirë pajisjet, veglat, furnizimet, etj. që përdoren gjatë kryerjes së detyrës në një profesion.

Këto elemente janë të domosdoshme gjatë përcaktimit të performancës së kërkuar dhe, gjithashtu, ndihmojnë në përcaktimin e sjelljeve, qëndrimeve, shkathtësive dhe njohurive të kërkuara.

Zhvillimi i standardeve të profesionit kërkon përfshirjen aktive të institucioneve, tregun e punës, partnerët socialë dhe shoqërinë civile.
Në Kosovë Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (KAAPARr), ka rol kryesor për propozimin e standardeve të profesionit. Është përgjegjësi e këshillit që të sigurohet se standardet e propozuara i plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe kanë mbështetje nga palët e interesit.

Zhvillimi i një standardi të profesionit kërkon të dhëna të përgjithshme dhe të sakta rreth shkathtësive, njohurive dhe kompetencave të nevojshme për performancë të mirë.
Fillimisht, zhvillimit të standardit të profesionit i paraprin analiza e profesionit nëpërmjet së cilës mblidhen të dhënat dhe informacionet e nevojshme. Mirëpo, kjo analizë e profesionit realizohet nëpërmjet dy metodave:
• Metodës së analizës funksionale;
• Metodës së DACUM

7.3 Metoda e analizës funksionale

Analiza funksionale u zhvillua në Britaninë e Madhe në vitet "80" ndërsa tashmë promovohet nga ETF (Fondacioni Evropian për Trajnime) dhe përfshinë qasjen nga "lart-poshtë" të bazuar në hulumtim.
Kjo metodë është më e përshtatshme për profesionet e reja të kërkuara nga tregu i punës dhe për të cilat nuk ekziston praktika paraprake.
Qëllimet e kësaj analize janë:

• Identifikimi i qëllimeve kyçe të arritura sipas profesionit;
• Përkufizimi i funksioneve të cilat kontribuojnë në arritjen e qëllimit;
• Zbërthimi i funksioneve në pjesë përbërëse deri në identifikimin e listës së aktiviteteve të punëve individuale;
• Përkufizimi i kritereve të performancës për secilin aktivitet;
• Identifikimi i parametrave të performancës në kontekste dhe rrethana të ndryshme.
Metoda e analizës funksionale përshkruhet edhe me shembuj praktikë, në dy udhëzues për përdorimin e standardeve profesionale, gjatë zhvillimit të moduleve si dhe zhvillimit dhe verifikimit të standardeve profesionale.

7.4 Metoda DACUM

Metoda DACUM (akronim për "Zhvillim të kurrikulës") është zhvilluar në ShBA si mjet i përkufizimit të kompetencave për menaxhmentin në ndërmarrje dhe programet e zhvillimit të stafit. Kjo metodë kryesisht është përdorur për zhvillimin e programeve të Bankës Botërore dhe agjencitë ndërkombëtare dhe përfshinë qasjen nga "poshtë-lart".
Sipas kësaj metode, profesioni përshkruhet në kuadër të detyrave të cilat i kryejnë punëtorët me performancë të suksesshme. Kjo është drejtpërdrejt e ndërlidhur me njohuritë, shkathtësitë, mjetet dhe qëndrimet të cilat punëtorët duhet ti kenë për ti përmbushur detyrat.
Suksesi i përdorimit të kësaj metode varet nga pjesëmarrja aktive e palëve me përvojë (punëdhënësve), me qëllim të identifikimit të listës së detyrave kryesore dhe përcaktimin e tyre në funksione kryesore të profesionit. Gjithashtu, identifikohen edhe mjetet, pajisjet, burimet e përdorura, shkathtësitë dhe njohuritë e kërkuara.

Metoda DACUM përshkruhet me shembuj praktikë në dy udhëzues për përdorimin e standardeve profesionale, gjatë zhvillimit të moduleve si dhe zhvillimit dhe verifikimit të standardeve profesionale.
Të dy metodat përfshijnë hulumtime rreth sektorit në fjalë, përshirë vizitat në terren si dhe identifikimin e "hartës" së përgjithshme të profesionit dhe strukturës organizative brenda profesionit për të cilin zhvillohet standardi.

Të dyja metodat varen nga përfshirja aktive e njerëzve me përvojë nga sektori, ndonëse në mënyra të ndryshme. DACUM kërkon pjesëmarrjen aktive në punëtori, ndërsa, analiza funksionale përfshinë një qasje më fleksibile në formë të konsultimit.
Nëse nuk ka kushte për zbatimin e metodës DACUM, atëherë analiza funksionale siguron një alternative më të përshtatshme.

Zhvillimi i standardeve të profesionit përcaktohet me Udhëzimin Administrativ për kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit.
Standardi i profesionit zhvillohet nga profesionistët e fushës përkatëse dhe organizohen në formën e punëtorive, ku ndihmësi duhet të kujdeset për përgatitjet fillestare, duke përfshirë vizitat në ndërmarrje për ti mbledhur informatat relevante rreth strukturës organizative dhe sektorit përkatës.

Punëtoritë zakonisht përfshijnë 8-10 pjesëmarrës, ku fokusi bazohet në këto çështje:

1. Orientimi
2. Rishikimi i pozitës apo përshkrimi i punës profesionale
3. Identifikimi i fushave të përgjithshme të përgjegjësive
4. Identifikimi i detyrave specifike të kryera në secilën fushë të përgjithshme të përgjegjësive
5. Rishikimi dhe përmirësimi i përshkrimeve të detyrave
6. Renditja dhe përshkrimi i detyrave
7. Identifikimi i njohurive të përgjithshme dhe shkathtësive të kërkuara të profesionit, mjetet, pajisjet, furnizimet, materialet, tiparet e dëshirueshme të punëtorit dhe qëndrimet.
8. Opsionet e tjera sipas nevojës (psh. identifikimi i niveleve të pranimit).

Në cilindo rast, rezultatet përfundimtare, në kuadër të mbledhjes së të dhënave dhe zhvillimit të draft standardeve, duhet të ishin të njëjta.
Para finalizimit drafti i standardeve të profesionit duhet të verifikohet nga një grup më i gjerë i punëdhënësve. Pas finalizimit, standardet e profesionit dorëzohen në KAAPRr, pastaj përcillen për verifikim në AKK. Kualifikimet do të zhvillohen pas finalizimit të standardeve të profesionit.

Gjithashtu, standardet mund të verifikohen duke përdorur standardet e vendeve të tjera si burim i krahasimit - në një ekonomi botërore të globalizuar në rritje, ekziston arsyeja pse duhet të ketë ndryshime madhore ndërmjet standardeve të profesionit në vende të ndryshme. Në të vërtetë, kompanitë ndërkombëtare tentojnë ta presin nivelin e njëjtë të performancës - realizimit nga punonjësit e tyre, kudo që ata punojnë.

7.5 Parimet për zhvillimin e standardeve të profesionit

Zhvillimi i standardeve të profesionit duhet ti ndjekë disa parime si në vijim:

• Emërtimi dhe kodifikimi duhet të bëhet sipas Librit mbi Klasifikimin e Profesioneve në Kosovë, Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Standardeve Ndërkombëtare për Klasifikimin e Profesioneve (ISCO 08);
• Përzgjedhja e metodës së zhvillimit të standardit të profesionit;
• Përshkrimi i saktë i qëllimit, funksioneve, aktiviteteve kyçe, kritereve të performancës etj. brenda profesionit të caktuar;
• Përzgjedhja e foljeve të përdorura në standard për përcaktimin e performancës të nevojshme, duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme. Në çdo aktivitet përshkrues, duhet të përdoren foljet aktive. Përdorimi i foljeve duhet të jetë i bazuar në taksonominë e Blumit;
• Mbikontekstualizimi i aktiviteteve mund ta kufizojë procesin e transferimit (posaçërisht aktivitetet e përbashkëta për më shumë se një profesion);
• Shmangia e aktiviteteve lidhur me disa procese apo pajisje të caktuara të punës, të cilat mund të ndryshojnë me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës. Rezultati i njëjtë mund të arrihet në mënyra të ndryshme.
Struktura e standardit të profesionit duhet ti përmbajë këto ndarje:

• Funksionet

Para përcaktimit të funksioneve duhet të bëhet identifikimi i fushave të shkathtësive brenda profesionit. Me shkathtësi nënkuptohen fushat e shkathtësive kryesore që gjenden brenda një profesioni, të cilat janë teknike dhe profesionale si dhe janë kompetente për këtë profesion.
Funksioni nënkupton një komponentë të punës në një profesion, i cili integron njohuritë dhe shkathtësitë. Një funksion duhet ti përfshijë këto veçori: të jetë relevant për profesionin dhe i njohur për njerëzit të cilët punojnë në këtë profesion, realizimi i të cilit i integron njohuritë dhe shkathtësitë, ndërsa zbatimi i tij është i transferushëm nga një vend në një vend tjetër;

• Aktivitetet kyçe

Aktivitetet mbështesin standardin e profesionit. Ato duhet të jenë më të gjëra se detyrat specifike ose procedurat dhe funksionet, si dhe duhet t'i integrojnë njohuritë dhe shkathtësitë;

• Kriteret e performancës

Kriteret e performancës lidhen me aktivitetet kyçe të funksionit. Ato janë një sërë deklaratash, të cilat identifikojnë karakteristikat e cilësisë që janë arritur nëse puna e përshkruar në funksion dhe aktivitetet përkatëse duhet të kryhen me sukses;

• Njohuritë e nevojshme për ta përmbushur funksionin

Këtu, duhet të paraqiten njohuritë që kërkohen për ta përmbushur funksionin dhe mundësojnë përdorimin e njohurive për kryerjen e funksionit;

• Shkathtësitë

Duhet të paraqiten shkathtësitë e kërkuara për zbatimin praktik dhe të menduarit për ti zgjidhur problemet;

• Kushtet e realizimit të funksionit

Kushtet e realizimit të funksionit janë mekanizma të dizajnuar për të ofruar informata mbi kontekstin e zbatimit të aktiviteteve të përshkruara për njësinë e kompetencës.

Poashtu, këto kushte kanë të bëjnë me kontekstin brenda të cilit duhet të arrihet performanca (hapësirat, llojet e mjeteve, materialet, klientët, etj.);

• Deklarata e dëshmive

Deklaratat e dëshmive mundësojnë lidhjen e vlerësimit përfundimtar të standardit. Dëshmia përdoret për ta treguar llojin që kërkohet gjatë vlerësimit të performancës në një funksion të veçantë. Poashtu, deklaratat e dëshmive tregojnë se individi është kompetent.
Formati i standardit të profesionit është ilustruar në diagramin në vijim.

Funksioni 1:

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e kërkuara për kryerjen e funksionit	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe

Më shumë informacione rreth procesit të zhvillimit të standardeve të profesionit gjenden në udhëzuesit që mbështesin zbatimin e KKK, si në: Udhëzuesin mbi zhvillimin dhe verifikimin e standardeve të profesionit, Udhëzuesin për zhvilluesit e standardeve të profesionit, Udhëzuesin për zbatimin e anketës me punëdhënësit, si dhe Udhëzuesin për transformimin e standardit të profesionit në standard të kualifikimit.

Standardet e profesionit janë referencë për zhvillimin e kualifikimeve profesionale në KKK. Ato përdoren për ti përcaktuar modulet dhe rezultatet e të nxënit që përfshihen në secilin kualifikim. Në përgjithësi, funksionet kryesore në standardet e profesionit definojnë specifikisht modulet dhe përmbajtjen e tyre.

Modulet, janë struktura e kualifikimeve, duke përfshirë sistemin e akumulimit të kredive dhe mundësinë e transferimit të tyre. Kualifikimet profesionale bazohen në module obliguese dhe zgjedhore dhe mundësojnë shkallë përzgjedhjeje për arritjen e kualifikimit.
Rezultatet e të nxënit janë formë përshkruese e shkathtësive, njohurive dhe kompetencave që një kandidat duhet ti arrijë nëpërmjet një kualifikimi. Këto formulime bazohen në standardet e profesionit.

Për më shumë informacione rreth procesit të përshtatjes së kualifikimeve profesionale në standarde të profesionit, mund ti gjeni udhëzuesit që mbështesin zbatimin e KKK si: Udhëzuesin mbi përdorimin e standardeve profesionale gjatë zhvillimit të moduleve mësimore si dhe Udhëzuesin për përcaktimin e niveleve të kualifikimit, moduleve dhe rezultateve të të nxënit.

7.6 Formati i kualifikimeve profesionale

Kualifikimet profesionale kanë një format standard të kualifikimeve, në të cilin kualifikimet/modulet përshkruhen.

Kualifikimet e AAP kanë këtë format:

Titulli i kualifikimit:.....
Titulli i modulit:.....
Vlera e kredive:.....
Niveli i modulit në KKK
Rezultatet e mësimit:

1. …....
2. …....

Rezultati i mësimit 1:

- Performanca (vlerësimi) kriteri…
- Performanca (vlerësimi) kriteri…
- Performanca (vlerësimi) kriteri…

Lista e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve (kushteve, pajisjeve, mjeteve, etj.)
Strategjia e vlerësimit

- Dëshmitë e nevojshme (format dhe numri i dëshmive)
- Metodat e vlerësimit

Rezultatet e mësimit 2:

- Performanca (vlerësimi) kriteri…
- Performanca (vlerësimi) kriteri…
- Performanca (vlerësimi) kriteri…

Lista e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve (kushteve, pajisjeve, mjeteve, etj.).
Strategjia e vlerësimit

- Dëshmitë e nevojshme (formati dhe numri i dëshmive)
- Metodat e vlerësimit, etj.

VLERËSIMI DHE CERTIFIKIMI NË KKK

8. VLERËSIMI DHE CERTIFIKIMI NË KKK

8.1 Vlerësimi i kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm

Bazuar në KKK, vlerësimi në nivel klase përfshinë vlerësimin formativ përgjatë gjithë vitit shkollor, vlerësimin përfundimtar (pas përfundimit të vitit shkollor) dhe vlerësimin sumativ (pas përfundimit të një nga shkallëve kryesore të kurrikulës). Vlerësimi formativ, përveç metodave të tjera joformale të vlerësimit, gjatë gjithë procesit të mësimit, përbëhet nga një shkallë e vlerësimit që përdor sistemin e notimit nga 1 deri në 5. Vlerësimi përfundimtar ndodhë në fund të secilit vit shkollor dhe pasqyron nivelin e performancës së nxënësit gjatë tërë vitit.

Vlerësimi i nxënësit i paraqitur më lart, menaxhohet tërësisht nga mësimdhënësit në shkolla, ndërsa, shkollat dhe komunat kanë rol monitorues për këto procese të vlerësimit.

Divizioni për standarde dhe vlerësim në MAShT është përgjegjës për përgatitjen, administrimin dhe vlerësimin e të gjitha testeve të jashtme të standardizuara. Vlerësimet e standardizuara shtetërore/kombëtare organizohen pas përfundimit të klasës së 5, 9 dhe 12. Vlerësimet shtetërore/kombëtare fokusohen në matjen e nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore.

Vlerësimi shtetëror në fund të klasës së 5, i referohet nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kyçe, të shprehura në Kurrikulën bërthamë përmes rezultateve të të nxënit për shkallën kryesore të kurrikulës. Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës së 9, i referohet nivelit të arritjeve për zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura në kurrikulën bërthamë. Ky vlerësim, përdoret si instrument për ta përcaktuar orientimin e nxënësve në nivelin e shkollave të mesme të larta.

Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës së 12, i njohur edhe si Provimi i Maturës Shtetërore, ka për qëllim, që ta matë nivelin e arritjeve për zotërimin e kompetencave kryesore, të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit për shkallë kryesore të Kurrikulës. Provimi i maturës, vlerëson nëse nxënësit, kanë arritur nivelin e përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, si dhe përcakton nëse nxënësit janë gati të kalojnë në arsimin e lartë. Sa i përket pranimit në arsimin e lartë, provimit të maturës i janë caktuar 50% e pikëve të pranimit në universitet.

8.2 Vlerësimi i kualifikimeve profesionale

Në Ligjin për Kualifikimet (Ligji 03-L-060) vlerësimi definohet si: vlerësimi nënkupton proceset, përfshirë provimet dhe testet, që shfrytëzohen për të mbledhur, interpretuar dhe vlerësuar dëshminë në mësim të individit. Vlerësimi për kualifikime mund të kryhet vetëm nga institucionet ose organizatat e aprovuara nga AKK për këtë qëllim dhe të njohura si institucione të vlerësimit.

Vlerësimi është proces i vlerësimit të dëshmive, i të arriturave të kandidatit/nxënësit (njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat) kundrejt kërkesave të kualifikimeve.

Vlerësimi i kandidatëve/nxënësve bëhet për qëllime të ndryshme, vlerësimi për përcaktimin e nivelit të kualifikimit, përparimit të kandidatëve, etj.

Ekzistojnë dy forma të vlerësimit: vlerësimi formativ dhe sumativ.
Vlerësimi formativ apo i pjesshëm, është thelbësor për të mësuarit efektiv dhe iu mundëson nxënësve/kandidatëve dhe vlerësuesve matjen e përparimit drejt arritjes së rezultateve.

Vlerësimi sumativ apo përfundimtar, shpie drejt rezultatit final të kualifikimit. Qëllimi i këtij vlerësimi është që të sigurojë dëshmi për të arriturat e kandidatit që shpie në një kualifikim.

Për ta siguruar kredibilitetin e vlerësimit sipas KKK, vlerësimi duhet të jetë:

- I drejtë dhe objektiv;
- Fleksibil;
- Valid;
- I besueshëm;
- I mjaftueshëm;
- Praktik;
- Me kosto efektive;
- Transparent.

Vlerësimi i drejtë dhe objektiv duhet të sigurojë se:

- Procesi i vlerësimit është krejtësisht i lirë nga paragjykimet dhe diskriminimi pozitiv apo negativ;
- Nxënësit/kandidatët, pavarësisht nga niveli dhe formimi i tyre, kanë qasje të vlerësimit pa pengesa, psh. instrumentet e vlerësimit nuk duhet të paraqesin kushte apo kërkesa, të cilat nuk janë relevante apo nuk përputhen me atë çfarë vlerësohet.

Për të qenë fleksibil, praktikat e vlerësimit duhet të:

- Reflektojnë një qasje e cila e vendos nxënësin/kandidatin në qendër të mësimit, proceset e vlerësimit përshtaten me nevojat individuale të kandidatit kurdo që është e mundur;
- Shfrytëzojnë të gjitha mundësitë në dispozicion që nxënësit/kandidatët ti demonstrojnë të arriturat e kërkuara, duke mundësuar vlerësimin gjatë aktiviteteve praktike, procesit mësimor apo në vendin e punës.

Për të qenë valid një instrument i vlerësimit, duhet:

- Të jetë në funksion të qëllimit (psh. vlerësimi praktik përdoret për ti vlerësuar shkathtësitë specifike praktike);
- Ti mbulojë të gjitha rezultatet e përcaktuara të të nxënit;
- Ta sigurojë mundësinë që kandidatët ti dëshmojnë të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë për kualifikim;
- Të sigurojë gjithëpërfshirje.

Për të qenë i besueshëm vlerësimi duhet të:

- Bazohet në dëshmi, të cilat janë punë autentike e nxënësve/kandidatëve që janë duke u vlerësuar;

• Bazohet në dëshmi që dalin nga instrumentet valide të vlerësimit dhe të gjykuara në harmoni me kriteret e përcaktuara;
• Jetë në përputhje me kriteret e vlerësimit, pavarësisht vendit ku bëhet vlerësimi;
• Jetë i mjaftueshëm (praktikat e vlerësimit duhet të sigurojnë numër të dëshmive përkatëse t'u mundësojnë vlerësuesve marrjen e vendimeve të vlefshme dhe të besueshme).

Për të qenë praktik vlerësimi, duhet të:

• Përshtatet me kohën, resurset e disponueshme dhe pajisjet mbështetëse;
• Shmangë kërkesat burokratike në lidhje me ofrimin e dokumentacionit, i cili duhet të jetë adekuat dhe në funksion të qëllimit.

Vlerësimi për të pasur kosto efektive, duhet:

• Të mos përbëjë ngarkesa të panevojshme si për institucionin ashtu edhe për nxënësin/kandidatin (psh. shmangia e situatave që kërkojnë kosto pajisjesh apo kohë shtesë për t'u realizuar).

Për të qenë transparent vlerësimi, duhet që:

• Të dhënat për të arriturat e nxënësve/kandidatëve duhet të jenë të qasshme, në mënyrë që vendimi për vlerësim të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për palët relevante.

8.2.1 Funksioni i vlerësuesve

Vlerësuesit e IAAP janë përgjegjës për vlerësimin e nxënësve/kandidatëve, në përputhje me kërkesat e kualifikimit si dhe dorëzimin e rezultateve për certifikim.
Institucionet e akredituara të vlerësimit, janë përgjegjëse për t'u siguruar se të gjithë personat e përfshirë në vlerësimin e kandidatëve për kualifikime janë kompetentë si: mësimdhënës, trajnues, instruktorë apo personat e angazhuar si vlerësues të jashtëm (psh. përfaqësuesit e partnerëve socialë të përfshirë në procesin e vlerësimit).

Për të qenë vlerësues kërkohet:

• Njohuri për kualifikimin, kriteret dhe kërkesat e vlerësimit;
• Identifikim, përzgjedhje dhe përdorim të metodave dhe instrumenteve të vlerësimit;
• Përshtatje e vlerësimit të nxënësve/kandidatëve me aftësi të kufizuara;
• Planifikim të procesit të vlerësimit në bashkëpunim me nxënës/kandidatë;
• Mbledhje dhe vlerësim të të dhënave dhe rezultateve të nxënësve/kandidatëve;
• Përpunim dhe publikim të rezultateve të vlerësimit;
• Sigurim të brendshëm të cilësisë që mbështet sigurimin e jashtëm të cilësisë.

8.2.2 Procesi i vlerësimit

Institucionet e akredituara të vlerësimit janë përgjegjëse për sigurimin e sistemit të vlerësimit, aplikimin e instrumenteve të vlerësimit si dhe raportimin e rezultateve të vlerësimit.
Kualifikimet përfshijnë specifikat e rezultateve të të nxënit, kriterin e realizimit/performancës si dhe dëshmitë e tjera.

Kriteri i realizimit/performancës përfshinë formën përshkruese të produkteve, rezultateve, detyrave dhe aktiviteteve të përshkruara që duhet të përmbushen.
Për t'u vlerësuar arritja e rezultateve të mësimit, nxënësit/kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të mjaftueshme se kriteret e performancës, të shoqëruara me rezultatet e të nxënit janë përmbushur. Kjo nënkupton se kërkesat janë përmbushur dhe nxënësi/kandidati ka kaluar fazën e vlerësimit. Ndërsa, kur dëshmitë nuk janë të mjaftueshme, nxënësve/kandidatëve u ofrohen informata kthyese dhe u jepet mundësia për mbledhje të dëshmive të reja dhe rivlerësim.

Procesi i vlerësimit ndahet në këto faza:

Faza e planifikimit të vlerësimit:

• Procesi i vlerësimit kërkon planifikim të kujdesshëm dhe përgatitje;
• Identifikim dhe zbatim të politikave të vlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat e kualifikimit, duke përfshirë nxënësit/kandidatët në planifikimin e procesit të vlerësimit.

Mbledhja e dëshmive:

• Aplikimi i metodave të përshtatshme, përkatësisht instrumenteve për mbledhjen e dëshmive të kërkuara.

Gjykimi i dëshmive për rezultatet e vlerësimit:

• Verifikimi se dëshmitë e mbledhura i përmbushin kërkesat e dëshmive në aspektin sasior dhe cilësor;
• Vendosja nëse kriteret janë përmbushur apo jo;
• Sigurimi i informatave kthyese për nxënësit/kandidatët.

Evidentimi i rezultateve të vlerësimit:

• Sigurimi se rezultatet e vlerësimit janë mbledhur sipas mënyrës së kërkuar;
• Sigurimi i evidencave të verifikueshme për qëllime të sigurimit të cilësisë.

8.2.3 Metodat e vlerësimit

Është e rëndësishme që metodat e vlerësimit, përkatësisht instrumentet e përzgjedhura, sigurojnë mënyrën më të përshtatshme për mbledhjen e dëshmive të kërkuara për realizmin e kualifikimit.

Vlerësimi përfshinë:

• Mbikëqyrjen, që nënkupton vrojtimin e nxënësve/kandidatëve gjatë kohës kur ata kryejnë një aktivitet praktik, real apo të simuluar;
• Testimin e produkteve, që nënkupton verifikimin e produktit që nxënësi/kandidati e ka krijuar ose prodhuar gjatë apo pas përfundimit të produktit;
• Pyetjen, që nënkupton pyetjen e nxënësve/kandidatëve me shkrim apo me gojë.
Pyetjet mund të lidhen me aktivitetet e përshkruara në rezultatet e të nxënit, ato mund ti testojnë aftësitë e nxënësit/kandidatit. Metoda e të pyeturit është mjet i rëndësishëm për dëshmimin dhe verifikimin e njohurive dhe të të kuptuarit.

Kërkesat e dëshmive për secilin rezultat të të nxënit duhet gjithmonë ti bëjnë të qarta kriteret e vlerësimit. Ekzistojnë lloje të ndryshme të instrumenteve të vlerësimit siç janë:

- Pyetjet
- Detyra
- Testi për dëgjim
- Studimi i rastit praktik
- Pyetjet për përfundimin e formulimit
- Të kuptuarit
- Aktiviteti i dizajnimit
- Kontributi në diskutim
- Pyetje me përgjigje të zgjeruar
- Pyetje tabelore
- Hulumtim
- Ditari
- Pyetjet për krahasim
- Pyetje me alternativa
- Pyetje me shumë përgjigje
- Intervistë me gojë
- Prezantim
- Realizim
- Ushtrim praktik
- Projekti
- Pyetësori
- Lista e pyetjeve
- Pyetjet me përgjigje të kufizuara
- Loja me role
- Pyetjet me përgjigje të shkurtra
- Lista e kontrollit etj.

Personi përgjegjës për vlerësimin e pjesëve të veçanta të kualifikimit brenda institucionit përdor instrumentet e vlerësimit, të cilat duhet të jenë të përcaktuara para se të ofrohet kualifikimi.

Instrumentet e vlerësimit dizajnohen në mënyrë që të sigurohet optimalizimi i shfrytëzimit të burimeve në dispozicion, ta përkrahë mësimin efektiv, ta lehtësojë qasjen dhe përparimin dhe ta inkurajojë besueshmërinë. Zgjedhja e instrumenteve të përshtatshme të vlerësimit varet nga një numër faktorësh:

• Qëllimi në funksion të kërkesave të kualifikimit duhet të kontrollohet me kujdes, për të parë se, çfarë instrumente të vlerësimit kërkohen apo priten për secilin rezultat të mësimit (psh. kur kemi të bëjmë me vlerësimin e shkathtësive praktike, detyrat praktike preferohen të aplikohen para testit teorik);
• Mundësitë për përdorimin e vlerësimit të integruar duke kombinuar vlerësimin me rezultate të ndryshme të të nxënit;
• Nevoja që të ofrohet bazë e besueshme për vlerësimin e rezultateve, përfshirë dëshmitë e matshme për arritjen e kualifikimit;
• Maksimalizimi i mundësive për punë ekipore për të gjithë ata që janë të përshirë në procesin e vlerësimit.

Me rastin e përpilimit të metodave të vlerësimit duhet të shmanget çfarëdo paragjykimi gjinor, kulturor, racial apo religjioz. Vështirësitë e pyetjeve dhe detyrave të veçanta mund të ndikohen nga veçoritë e caktuara:

• Mënyra e të menduarit: Pyetjet/detyrat bëhen më komplekse gjatë interpretimit, gjykimit, analizës, ideve dhe koncepteve.

• Gjuha/tema abstrakte: Pyetjet/të shprehurit bëhet më kompleks varësisht nga shkalla e përdorimit të termave konkrete ose abstrakte.

• Terminologjia e veçantë e lëndës: Duhet të përdoret vetëm nëse është e njohur dhe e kuptueshme për nxënësit/kandidatët.

• Fokusi i pyetjes/detyrës: Një pyetje e fokusuar mprehtë mund të jetë më e lehtë sesa ajo që ka fokusim më të gjerë.

• Thjeshtësia e gjuhës: Formulimi i pyetjeve/detyrave duhet të jetë i thjeshtë, i qartë dhe me qasje në të gjitha nivelet dhe duhet mënjanuar shumëkuptimësinë.

8.2.4 Ofrimi i kushteve për vlerësim për kandidatët me aftësi të kufizuara

Kriteret për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave duhet të jenë të njëjta për nxënësit/kandidatët me aftësi të kufizuara. Megjithatë, duhet përshtatur instrumentet e vlerësimit dhe elementet e tjera plotësuese. Kushtet që duhen konsideruar:

- Kohëzgjatja e vlerësimit;
- Mjedisi ku bëhet vlerësimi;
- Qasja ndaj vlerësimit;
- Prezantimi se si një vlerësim është bërë për një kandidat.

Informatat shtesë janë dhënë në "Udhëzime për modifikimet dhe përshtatjet e nevojshme për zhvillimin e qasjes në programet dhe kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional për nxënësit me aftësi të kufizuar apo me nevoja tjera të veçanta".

8.2. 5 Mbledhja e dëshmive

Mbledhja e dëshmive është proces i vazhdueshëm, ku dëshmitë identifikohen, mblidhen dhe vendosen në portofolin e nxënësit/kandidatit. Dëshmitë mund të jenë të shumëllojshme dhe sigurohen nga burime të ndryshme. Dëshmitë për vlerësimin e praktikës janë gjithmonë parashikueset më të mira që tregojnë se nxënësi/kandidati mund ta dëshmojë performancën e kërkuar. Të gjitha dëshmitë duhet të jenë autentike.

Dëshmitë ndahen në dëshmi të realizimit dhe njohurive:

Dëshmitë e realizimit:

• produktet e punës së nxënësve/kandidatëve (janë produkte që dëshmojnë punën e nxënësit/kandidatit të prodhuara gjatë aktiviteteve të ndryshme: dëshmia mund të jetë vetë produkti, fotografi, etj.);

• mbikëqyrja e punës së nxënësve/kandidatëve (është vrojtim i nxënësve/kandidatëve gjatë aktiviteteve të ndryshme: raportet e ndryshme, audio/videoregjistrime, lista e kontrollit), etj.
Që të jenë dëshmitë valide duhet ta kenë datën dhe nënshkrimin e vlerësuesit dhe nxënësit/kandidatit. Poashtu, dëshmitë duhet të jenë të qarta dhe specifike për aktivitetin e kërkuar.

Dëshmitë për njohuri përfshijnë:

• Njohuritë për procedurat dhe faktet;
• Të kuptuarit e parimeve, teorive, etj;
• Aplikimin e njohurive për vlerësimin e kompetencës;
• Zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme;
• Transferimin dhe aplikimin e mësimit në kontekste të ndryshme.

Dëshmitë e njohurive sigurohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vrojtimet apo produktet gjatë realizimit praktik (në kuadër të projekteve apo detyrave).

Për testim sistematik të njohurive, testet dhe provimet me shkrim dhe me gojë ofrojnë mjete të përshtatshme për kontrollimin e gjerësisë dhe thellësisë së njohurive dhe të kuptuarit të nxënësve/kandidatëve. Poashtu, parashtrimi i pyetjeve joformale është një mënyrë efektive për vlerësimin e njohurive.

Kushtet për vlerësim

Me rastin e aplikimit të instrumenteve të vlerësimit vlerësuesit duhet të dinë se ekzistojnë kushte të caktuara, në mënyrë që vlerësimi të jetë i vlefshëm dhe i besueshëm. Ekzistojnë lloje të ndryshme të kushteve të vlerësimit dhe që të gjitha duhet të zbatohen në mënyrë efektive për të gjithë nxënësit/kandidatët.

Nxënësve/kandidatëve duhet siguruar:

• ambient pa zhurmë ku bëhet vlerësimi;
• kohë të nevojshme për testim (përveç nëse ka kërkesa të veçanta për vlerësim);
• mundësi për konsultim literature, shënime, materiale ose përdorim kalkulatori, etj.

Përdorimi i portofolit për vlerësim

Për ti përmbushur kërkesat e vlerësimit, pas arritjes së kualifikimit, duhet të regjistrohen dhe arkivohen informatat në vijim:

• dokumenti identifikues;
• fletëregjistrimi i nxënësit/kandidatit (mund të jenë forma të ndryshme të dokumenteve si kontratë, marrëveshje, etj);

• dëshmi mbi shkollimin paraprak;
• teste të ndryshme (nga vlerësimi formativ dhe sumativ);
• listat e kontrollit;
• punime, detyra, prezantime, produkte, etj.;
• rezultatet finale të vlerësimit;
• certifikata/diploma.

Nuk ka ndonjë formë unike të dosjes së dëshmive nga ofruesit për nxënësit/kandidatët. Përmbajtja e dosjes është e ndryshme dhe mund të përfshijë: shembuj, foto, video, etj. Dëshmitë në dosje ruhen në formë fizike dhe elektronike.

8.2.6 Gjykimi dhe regjistrimi i rezultateve të vlerësimit

Nëpërmjet vlerësimit të nxënësve/kandidatëve në AAP ata vlerësohen nëse janë aftësuar për ushtrimin e profesionit ose jo. Ata janë të aftë kur dëshmojnë performancë të mjaftueshme rreth njohurive, shkathtësive dhe kompetencave. Në përfundim të vlerësimit formativ është esenciale që t'u jepen informata kthyese nxënësve/kandidatëve rreth performancës së tyre, sidomos në rastet kur ka nevojë për përmirësime.

Në rastet kur nxënësit/kandidatët nuk kanë qenë të suksesshëm për demonstrimin e të arriturave, ata mund të rivlerësohen. Kjo nënkupton se IAAP duhet ti zbatojë instrumentet e vlerësimit dhe afatet e rivlerësimit. Rivlerësimi akordohet ndërmjet IAAP dhe nxënësve/kandidatëve para çdo rivlerësimi. IAAP vlerëson nëse nxënësit/kandidatët duhet të rivlerësohen në tërësi apo vetëm për pjesë të caktuara.

IAAP duhet të mbajë një regjistër vlerësimi për çdo nxënës/kandidat ku regjistrohet se çka është vlerësuar, kur dhe nga kush. Vlerësimi duhet të nënshkruhet nga nxënësi/kandidati dhe paneli vlerësues. Të gjitha vlerësimet duhet të ofrojnë mundësinë e auditimit të plotë.

Vlerësimi formativ dhe sumativ duhet të regjistrohet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme. Regjistrimi i vlerësimit formativ dhe informatat kthyese i ndihmojnë nxënësit/kandidatët që të përparojë. Faktorët kyç që kontribuojnë te regjistrimi i suksesshëm i vlerësimit janë:

• Verifikimi: Vendimet dhe regjistrimet e vlerësuesve të brendshëm dhe të jashtëm duhet të jenë transparente, të qasshme dhe të lexueshme për të gjithë;

• Pranueshmëria: Procesi i regjistrimit është i pranueshëm dhe koherent për të gjitha palët;

• Fleksibiliteti: Rezultatet e regjistrimit duhet të jenë fleksibile dhe të dobishme për të gjithë;

• Thjeshtësia: Rezultatet e regjistrimit duhet të jenë sa më praktike dhe mos të jetë ngarkesë për nxënësit/kandidatët dhe vlerësuesit.

8.2.7 Ankesat

Gjatë procesit të vlerësimit nxënësit/kandidatët mund të mos pajtohen me vendimet e vlerësimit. Në raste të tilla, IAAP duhet ti ketë procedurat ankimore të cilat duhet të jenë të qarta dhe publike.
Parimi thelbësor prapa cilësdo procedurë të ankesës është se ato duhet të jenë të pavarura dhe duhet të shqyrtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e vlerësimit duhet të njoftohen me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre lidhur me ankesat. IAAP duhet ta evidentojë dhe arkivojë çdo ankesë së bashku me rezultatet e tyre.

8. 2.8 Certifikimi

Ligji për Kualifikimet Kombëtare definon procesin e certifikimit të kualifikimeve si:

"Certifikimi" është proces i njohjes së të arriturave të kandidatëve për kualifikim nëpërmjet dhënies së certifikatës ose diplomës;

"Certifikata" është një dokument zyrtar që dëshmon përfundimin e një kursi, programi të arsimit ose aftësimit ose përmbushjen e kërkesave nga një individ për kualifikim si dhe evidenton përfundimin e pjesshëm të një kualifikimi.

"Diploma" nënkupton dokumentin i cili jepet pas përfundimit të suksesshëm të një programi të gjatë arsimor.

Gjithashtu, ky ligj bën të qartë se certifikimi është përgjegjësi e institucionit vlerësues, por certifikatat dhe diplomat e dhëna për kualifikime në KKK duhet të miratohen me vulë nga AKK. Miratimi dhe vulosja vërteton se kualifikimi në fjalë është në KKK dhe se ky kualifikim është lëshuar nga një institucion i akredituar.

Të gjitha certifikatat/diplomat e miratuara në KKK duhet të përfshijnë:

· Të dhënat e kandidatit;
· Llojin e kualifikimit në KKK;
· Titullin e kualifikimit/modulit;
· Datën dhe vendin e lëshimit;
· Nivelin e kualifikimit/modulit;
· Vlerën e kredisë;
· Institucionin lëshues të kualifikimit.

Certifikatat/diplomat duhet të shoqërohen me shtojcën e certifikatës/diplomës që shpjegon më gjerësisht rreth përmbajtjes së kualifikimit të arritur.

Certifikatat/diplomat duhet të ruhen për një periudhë më të gjatë kohore dhe në rast të nevojës së lëshimit të duplikatit kjo procedurë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me procesin e vlerësimit, IAAP duhet ti zhvillojë politikat dhe procedurat për:

- organizimin e vlerësimit të brendshëm (metodat dhe instrumentet për vlerësim duke përfshirë kriteret e notimit, etj.);
- implementimin dhe monitorimin e vlerësimit;
- statistikat e regjistrimit dhe të rezultateve të arritura (regjistrin mbi të arriturat e kandidatit, përfshirë vlerësimet formative dhe sumative);
- konfidencialitet të kandidatit, etj.

8.3 Vlerësimi i kualifikimeve të arsimit të lartë

Institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe të studimit të nivelit 6, 7 dhe 8, të KKK, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe UA për Akreditim, gëzojnë liri akademike në formën e ofrimit të programeve. Syllabuset, format e vlerësimit dhe çështje tjera të lidhura me formën e ligjërimit janë pavarësi e plotë e Institucioneve të Arsimit të LArtë (IAL) dhe stafit të tyre akademik. Agjencia e Kosovës për Akreditim sigurohet që, përmes procesit të vlerësimit, IAL dhe programet e tyre të studimit kanë krijuar mekanizma, të cilat e garantojnë këtë liri akademike dhe ekziston një procedurë e njohur brenda institucionit, përmes së cilës këto syllabuse janë të standardizuara dhe aprovuara.

Agjencia e Kosovës për Akreditim si zbatuese e Deklaratës së Bolonjës dhe anëtare e mekanizmave evropianë për sigurim të cilësisë, zbaton praktikat e përcaktuara në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, përfshirë ngarkesën e orëve ECTS dhe limitin e ngarkesës për një ECTS, standardet e vlerësimit, etj.

Përmes standardeve dhe udhëzuesve të brendshëm me te cilët AKA bën vlerësimin e programeve, sigurohet se syllabuset përmbajnë, së paku; objektivat, përmbajtjen, rezultatet e të nxënit, shpërndarjen e orëve mësimore, sistemin e vlerësimit të studenteve dhe literaturën.

RREGULLIMI I KUALIFIKIMEVE DHE INSTITUCIONET NË KKK

9. RREGULLIMI I KUALIFIKIMEVE DHE INSTITUCIONET NË KKK

Kualifikimet në arsimin e përgjithshëm jepen në fund të programit mësimor nga MAShT. Zhvillimi i kualifikimeve dhe sigurimi i cilësisë bëhet nga Departamenti i Arsimit Parauniversitar i MAShT, bazuar në standardet kombëtare për kualifikimet dhe fushat e tyre kurrikulare. Si të tilla, ato janë automatikisht pjesë e KKK.

Kualifikimet e AAP vendosen në KKK nëpërmjet mekanizmave që zhvillohen dhe zbatohen nga AKK. Këto mekanizma zbatohen nëpërmjet proceseve për validimin dhe miratimin e kualifikimeve si dhe për akreditimin e ofruesve që ofrojnë këto kualifikime.

Agjencia e Kosovës për Akreditim është institucioni përgjegjës për arsimin e lartë në Kosovë. Vendosja e kualifikimeve të arsimit të lartë në KKK bëhet nëpërmjet procesit të akreditimit.

9.1. Vendosja e kualifikimeve të arsimit të përgjithshëm në KKK

Struktura formale e arsimit është e bazuar në programin e arsimit, shumica e të cilave çon në rezultate të prekshme, të përcaktuara në drejtim të standardeve të pranuara kombëtare.

Niveli 1: Arsimi fillor është pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe zgjat pesë vjet (klasat 1-5). Në fund të klasës së pestë (5) nxënësit i nënshtrohen një provimi kombëtar të arritjeve dhe u jepet certifikata dalëse.

Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët është, po ashtu, pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe zgjat katër vjet (klasat 6-9). Në mënyrë që ta përfundojnë arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), nxënësit duhet ta kalojnë provimin kombëtar ose gjysmëmaturën dhe u jepet certifikata dalëse. Bazuar në rezultatet e arritura, nxënësit mund ta vazhdojnë arsimimin e tyre të mëtejshëm në AAP ose arsim të përgjithshëm. Certifikata dalëse e arsimit të mesëm të ulët është e nivelit 2 të KKK.

Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë përbëhet nga lloje të ndryshme të gjimnazeve (klasat 10, 11, 12), i cili përfundon me provimin kombëtar të maturës. Nxënësit pas përfundimit të klasës së dymbëdhjetë (12) mund ta vazhdojnë arsimimin postsekondar. Nxënësit të cilët e kalojnë provimin kombëtar të maturës marrin diplomë dalëse dhe mund të vazhdojnë në arsimin e lartë. Diploma e arsimit të mesëm të lartë është në nivelin 4 të KKK.

9.2. Vendosja e kualifikimeve të AAP në KKK

Procesi i validimit të kualifikimeve është i lidhur me kontrollin e cilësisë së kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK, psh. për të siguruar se kualifikimet përputhen me kriteret e kërkuara. Në anën tjetër, procesi i akreditimit siguron se kapacitetet e institucioneve që ofrojnë kualifikime përmbushin standardet e cilësisë.
Procesi i validimit dhe i akreditimit zakonisht zhvillohet paralelisht, por mund të jenë edhe si dy procese të ndara.

Procesi i validimit mbështetet në këto parime:

1. Kualifikimet ose modulet e ndonjë fushe të arsimit dhe aftësimit duhet të validohen për t'u përfshirë në kornizë;
2. Çdo institucion që dëshiron të zhvillojë një kualifikim ose modul dhe ta përfshijë atë në KKK duhet ta kërkojë validimin e kualifikimit ose modulit nga AKK;
3. Validimi i kualifikimeve mund të bëhet në të njëjtën kohë kur bëhet akreditimi i institucionit ofrues ose vlerësues apo si një proces i ndarë;
4. Validimi shpie në aprovimin ose mosaprovimin e kualifikimit. Aprovimi do të jepet për një periudhë të caktuar, pas së cilës mund të dërgohen për riaprovim;
5. Procesi i validimit duhet të jetë transparent dhe i bazuar në kritere të cilat normalisht duhet të përfshijnë standarde që mundësojnë krahasueshmëri kombëtare dhe ndërkombëtare;
6. Të gjitha kriteret, proceset dhe raportet duhet të bëhen publike.

Për llojet e kualifikimeve të AAP aplikohen kritere të veçanta të validimit të cilat janë të paraqitura sipas legjislacionit në fuqi.

Validimi i kualifikimeve zbatohet në katër faza.
1. **Faza 1:** Aplikacioni duhet të dorëzohet nga institucioni aplikues. Aplikacioni duhet të përfshijë një arsyetim të hollësishëm për kualifikimin/modulin dhe të dhënat e tjera të kërkuara nga AKK, për përfshirje në KKK;
2. **Faza 2:** Vlerësimi i aplikacionit bëhet nga ekipi i ekspertëve të përzgjedhur nga AKK. Puna e ekipit mbështetet nga AKK. Draft-raporti me rekomandime nëpërmjet AKK i përcillet institucionit aplikues, i cili mund të japë sqarime shtesë apo komente në fakte të paraqitura brenda një afati kohor të caktuar nga AKK;
3. **Faza 3:** Raporti vlerësues i jashtëm i përcillet Këshillit Drejtues të AKK i cili merr vendim për validim me shumicë të votave;
4. **Faza 4:** Kualifikimet/modulet pas miratimit, përfshihen në KKK dhe bëhen publike nga AKK.

Procedura e paraparë për validimin e kualifikimit nuk duhet ta tejkalojë periudhën prej 6 muajsh nga data e miratimit të aplikimit.

Kualifikimet/modulet dorëzohen për validim dhe aprovim sipas formatit të aplikimit dhe procedurave të përcaktuara nga AKK.
Ekipi i ekspertëve vlerëson dokumentacionin e nevojshëm të kualifikimit/modulit dhe dokumentet e tjera që mbështesin kualifikimin sipas udhëzuesve të AKK.
Procesi i validimit bazohet në verifikimin e dokumentacionit. Ekipi i ekspertëve për validim mund të realizojë takime me zhvilluesit e kualifikimeve ose sipas nevojës ata mund të konsultohen edhe me njohës të sektorit apo fushës përkatëse.

Ekipi i validimit mund të bëjë rekomandime si në vijim:

1. Kualifikimi aprovohet për një periudhë të caktuar kohore deri në pesë vjet (kjo periudhë mund të ndryshojë varësisht nga trendet e zhvillimit dhe nevojat);
2. Nëse kualifikimi ka nevojë për përmirësime të caktuara, ai aprovohet pas plotësimit të tyre brenda një afati të caktuar kohor;
3. Kualifikimi nuk aprovohet.

Ekipi i ekspertëve harton raportin bashkë me rekomandimet përkatëse, i cili i përcillet zhvilluesit të kualifikimit sipas procedurave, ndërsa vendimi final mbi aprovimin e kualifikimeve/moduleve bëhet nga Këshilli Drejtues (KD) i AKK.

Procesi i akreditimit siguron se institucionet përmbushin kriteret dhe standardet e cilësisë për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimeve/moduleve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Procesi i akreditimit mbështetet në këto parime:

1. Akreditimi do të bëhet për kualifikime specifike;
2. Çdo institucion i cili dëshiron të akreditohet për të ofruar kualifikim në KKK duhet të aplikojë për akreditim në AKK;
3. Akreditimi do të jepet për një periudhë të caktuar kohore pas së cilës institucioni mund të kërkojë riakreditim;
4. Institucionet ofruese apo vlerësuese të akredituara duhet ti përmbushin kriteret e akreditimit. Mospërmbushja e këtyre obligimeve do të rezultojë me refuzim të akreditimit;
5. Procesi i akreditimit duhet të jetë i drejtë, transparent dhe që shpie në gjykimin e drejtë nga personeli kompetent;
6. Institucionet aplikuese duhet ta dëshmojnë përmbushjen e kritereve të përcaktuara nga AKK përmes procesit të vetëvlerësimit dhe dokumenteve tjera relevante;
7. Propozimi për akreditim merret pas vlerësimit të informatave dhe dëshmive të ofruara nga institucioni aplikues;
8. Procesi i vlerësimit të institucionit për akreditim përfshinë një vizitë në institucion në mënyrë që të verifikohen dëshmitë e ofruara;
9. Institucionet e akredituara kanë të drejtë për pranimin e kandidatëve të AAP për kualifikimet në KKK;
10. Kualifikimet e lëshuara nga institucionet e paakredituara nuk njihen nga AKK.

Për t'u akredituar institucionet duhet të dëshmojnë se i përmbushin kriteret si në vijim:

1. Strukturë të përshtatshme institucionale e cila funksionon me bazë të qëndrueshme financiare;
2. Qasje efektive në vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së vlerësimit;
3. Dokumentacionin dhe bazën e të dhënave që mbështet në mënyrë efektive sigurimin e cilësisë dhe verifikimin e të arriturave të kandidatëve;
4. Qasje efektive në certifikimin dhe menaxhimin e cilësisë së certifikatës/diplomës;
5. Politika të përshtatshme dhe procedurat për zhvillimin e stafit në lidhje me kërkesat për vlerësim, verifikim të brendshëm dhe certifikim;
6. Politika dhe procedura të përshtatshme për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara;
7. Qasje për vlerësim dhe certifikim për të gjithë, duke përfshirë edhe kandidatët të cilët përcjellin programe të veçanta të mësuarit, përfshirë njohjen e të arriturave nga të mësuarit joformal dhe informal;
8. Sisteme për njohje dhe transferim të kredive të fituara prej kandidatëve;
9. Dëshmi se vlerësimi do të bëhet në kushte të sigurta dhe mjedis të shëndoshë;
10. Kapacitet për të përmbushur kërkesa për kualifikime specifike siç janë:

10.1. Hapësirë e domosdoshme për ofrimin ose vlerësimin e kualifikimeve dhe moduleve;
10.2. Burime materiale të domosdoshme për ofrimin ose vlerësimin e kualifikimeve/moduleve;
10.3. Apo edhe ndonjë kërkesë tjetër të veçantë për kualifikime specifike.

11. Stafi dhe kualifikimet e tyre që ndërlidhen me ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve/moduleve duhet të jenë adekuate për kualifikimin përkatës;
12. Institucioni aplikues duhet të ofrojë kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhën e caktuar.

Akreditimi i institucioneve zbatohet në katër faza:

Faza 1: Institucionet marrin informata dhe udhëzime nga AKK dhe zhvillojnë një vetëvlerësim bazuar në kriteret e AKK. Institucioni e paraqet aplikacionin, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionet e tjera shtesë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK.
Faza 2: AKK përzgjedh ekipin e ekspertëve për vlerësimin e institucionit që aplikon për akreditim. Ekipi i ekspertëve do ta:
- Vlerësojë aplikacionin, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionet e tjera shtesë të ofruara nga institucioni aplikues;
- Viziton institucionin aplikues;
- Harton draft-raportin dhe rekomandon;
- Paraqet draft-raportin tek AKK.

Faza 3: Draft-raporti me rekomandime përmes AKK i përcillet institucionit aplikues, i cili mund të japë sqarime shtesë apo komente në faktet e paraqitura brenda një afati kohor të caktuar nga AKK. Raporti i vlerësimit të jashtëm i përcillet KD të AKK i cili merr vendim.
Faza 4: AKK publikon vendimin final dhe lëshon dokumentacionin e nevojshëm duke konfirmuar statusin e institucionit.
E drejta e ankesës së institucionit aplikues për proces të validimit dhe akreditimit ushtrohet brenda afateve kohore dhe procedurave ligjore në fuqi.

9.3 Vendosja e kualifikimeve të arsimit të lartë në KKK

AKA është përgjegjëse për zbatimin e sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Kosovë. Vendosja e kualifikimeve të arsimit të lartë në KKK bëhet përmes procesit të akreditimit. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është autoriteti shtetëror përgjegjës për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.
Agjencia është përgjegjëse për akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë dhe programeve të tyre akademike, si dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë në institucionet e akredituara dhe programet e tyre. Procesi dhe kriteret e akreditimit janë të rregulluara nga AKA me legjislacion përkatës. Procesi i akreditimit zhvillohet në nivel të institucionit dhe në nivel të programeve.

Kriteret për vlerësim dhe procedurat për akreditimin e IAL janë:

1. Fushëveprimi dhe numri i programeve;
2. Krahasueshmëria e programeve të studimit dhe rezultateve të përgjithshme të arsimit me institucione të ngjashme në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL/EHEA);

3. Dëshmimi i kontratave ligjore për stafin e kualifikuar për ti përmbushur standardet ndërkombëtare shkencore, artistike dhe profesionale;
4. Objekti, përfshirë hapësirën adekuate dhe pajisjet (psh. kompjuterët, bibliotekën, etj.);
5. Liria akademike në hulumtim dhe mësimdhënie;
6. Hulumtimi dhe kontributi i tij për mësimdhënie;
7. Politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe titujt;
8. Kriteret e pranimit dhe planet studimore (kurrikulat e detajuara) dhe rregulloret e provimeve.

Pas akreditimit të programeve dhe institucioneve, vendimi publikohet nga AKA.
Pas miratimit të akreditimit nga AAK-ja, IAL private i nënshtrohen një procesi të licencimit nga MAShT.

SIGURIMI I CILËSISË NË KKK

10. SIGURIMI I CILËSISË NË KKK

Kredibiliteti i KKK dhe reformat në sistemin e kualifikimeve bazohen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Sigurimi i cilësisë është një prej objektivave që mbështet KKK. Sigurimin e cilësisë në KKK e mbështesin planet, strategjitë dhe dokumentet e tjera. Institucionet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë: AKK, AKA dhe MAShT.
Brenda sistemit është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet 'kontrollit të cilësisë', 'sigurimit të cilësisë' dhe 'përmirësimit të cilësisë'.
Kontrolli i cilësisë (KC) është një proces për ruajtjen e standardeve e jo përmirësimin e tyre kontrolli u referohet teknikave të përditshme operacionale dhe aktiviteteve të përdorura për ti përmbushur kërkesat e cilësisë duke e rregulluar performancën.
Sigurimi i cilësisë (SC) nënkupton të gjitha veprimet e planifikuara dhe sistematike të nevojshme, për t'u siguruar se produkti ose shërbimi i plotëson kërkesat e specifikuara për cilësi. Aktivitetet e SC nuk e kontrollojnë drejtpërdrejt cilësinë, por ato përcaktojnë shkallën në të cilën cilësia do të kontrollohet.
Përmirësimi i cilësisë (PC) përfshinë të gjitha aktivitetet të cilat sjellin ndryshime të dobishme në performancën e cilësisë. Ky është një proces i ndryshimit të procedurave, proceseve ose performancës përmes monitorimit, vlerësimit, analizës dhe veprimeve korrigjuese.
Në kuadër të KKK sigurimi i cilësisë fokusohet kryesisht në drejtim të:

Ofrimit të sigurimit të cilësisë, vlerësimit dhe dhënies së kualifikimeve të validuara dhe aprovuara brenda KKK; dhe
Sigurimi i cilësisë në institucionet e akredituara.

Informacionet më të zgjeruara lidhur me SC janë të paraqitura në udhëzuesit përkatës për SC.

10.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë

10.1.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin e përgjithshëm

MAShT dhe komunat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë sipas legjislacionit në fuqi. MAShT është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e përgjithshëm, siç parashihet në Ligjin për Arsimin Parauniversitar. Megjithatë, ligji për arsim në komuna ia ka ndarë përgjegjësitë nivelit komunal në aspektin e nevojës për monitorimin e cilësisë së ofrimit të arsimit në shkolla.

Me miratimin e strategjisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, sigurimi i brendshëm i cilësisë (procesi i vetëvlerësimit) është prezantuar në arsimin e përgjithshëm (shkolla fillore, shkolla të mesme të ulëta dhe gjimnaze). Dokumentet e nevojshme ligjore, legjislacioni dhe udhëzimet për ta mbështetur zbatimin e strategjisë së sigurimit të cilësisë janë zhvilluar (UA për departamentet profesionale, UA për koordinatorët e cilësisë në nivel të shkollës, UA për planin zhvillimor të shkollës dhe UA për procedurat e vlerësimit të performancës së shkollës). Të gjitha këto dokumente, bazohen në ciklin për sigurimin e cilësisë në lidhje me përfshirjen e grupeve të interesit në procesin e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin.

10.1.2 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional

Sigurimi i brendshëm i cilësisë përfshinë vetëvlerësimin nga institucionet/ofruesit dhe dëshmon përkushtimin e tyre për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Raporti i vetëvlerësimit hartohet në baza vjetore dhe reflekton përfundimin e procesit vjetor të vetëvlerësimit.
Raporti pasqyron performancën e institucionit/ofruesit; çfarë është bërë mirë, çfarë është e kënaqshme dhe cilat janë mangësitë. Raporti i vetëvlerësimit është mekanizëm për zbatimin e Kornizës Kombëtarë të Sigurimit të Cilësisë (KKSC). KKSC ka gjashtë parime të cilësisë dhe secila nga to përmban një numër të caktuar të kritereve të cilësisë, në bazë të të cilave vlerësohet performanca e institucionit përmes procesit të vetëvlerësimit.
Dokumenti i KKSC është dokument i veçantë nga KKK i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK.

KKSC është e bazuar në Kornizën e Përbashkët Evropiane për Sigurim të Cilësisë (KPESC) në AAP dhe ka këto parime:

1. Qëllimi dhe plani - përgjegjësitë e menaxhmentit
2. Qëllimi dhe plani - menaxhimi i resurseve
3. Qëllimi dhe plani - dizajnimi dhe zhvillimi
4. Implementimi - mësimi, vlerësimi dhe certifikimi
5. Vlerësimi dhe verifikimi - procesi i vetëvlerësimit
6. Informata kthyese dhe ndryshimet - procesi i përmirësimit

Vetëvlerësimi është hapi i parë drejt zhvillimit të cilësisë së mirëfilltë brenda institucionit dhe përfshinë planifikimin afatgjatë gjatë implementimit.
Gjatë vetëvlerësimit është e domosdoshme të japim përgjigje në pyetjet:
- Sa jemi të mirë?
- Sa mund të jemi të mirë?
- Si mund të bëhemi më të mirë?
- Si mund të mësojmë nga të tjerët?

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të kërkuara sipas kritereve të cilësisë, institucioni duhet ta vetëvlerësojë secilin princip të cilësisë, për këtë qëllim përdoret sistemi i notimit si në vijim:
4 - përparësi: realizim shumë i mirë, që është mbi kërkesat optimale dhe mbi nivelin e pritur të performancës/realizimit;
3 - mirë: realizim i kënaqshëm, që përmbush kërkesat optimale e që ka mundësi të zhvillohet në përparësi;
2 - mjaftueshëm: pjesërisht i kënaqshëm, i përmbush kërkesat minimale, ka nevojë për përmirësim dhe adaptim;
1 - jo i mjaftueshëm: realizim jo i mjaftueshëm, që nuk i përmbush kërkesat, ekzistojnë zbrazëtira (mangësi) serioze, që duhet të merren në konsideratë për përmirësim.

Çdo vlerësim dhe notim duhet të mbështetet me dëshmi. Për shembull, nëse konsiderohet se proceset e mësimdhënies ose trajnimet brenda institucionit/ofruesit janë pozitive, atëherë kjo duhet dëshmuar me fakte në lidhje me atë se çfarë saktësisht zhvillohet në atë institucion.

Një prej mënyrave më efektive të hartimit të raportit të vetëvlerësimit është gjithëpërfshirja e stafit dhe aktorëve të tjerë (menaxhmenti, mësimdhënësit/trajnerët, koordinatori për SC, nxënësit/kandidatët, etj.), të cilët kontribuojnë me informata në lidhje me çështjet që ata i konsiderojnë përparësi apo dobësi.

Koordinatori i SC është përgjegjës për koordinimin e procesit të vetëvlerësimt. Për t'u siguruar që ka vazhdimësi në procesin e vetvlerësimit, është i nevojshëm evidentimi i informatave të raporteve të vetëvlerësimit dhe planit të përmirësimit përgjatë viteve. Kjo e mundëson matjen e performancës dhe ecurinë e rezultateve nga viti në vit.

Ngritja e cilësisë varet nga plani i përmirësimit. Plani i përmirësimit i adreson dobësitë të cilat duhet të trajtohen sipas prioriteteve dhe afateve të caktuara.
Plani i përmirësimit duhet të monitorohet dhe rishikohet rregullisht përmes raporteve të vetëvlerësimit. Përparimi i bërë duhet të pasqyrohet në planin e përmirësimit në vazhdimësi.
Përgjegjësitë e koordinatorit për SC, kriteret dhe procedurat për SC në institucionet e AAP, proceset e brendshme, janë të rregulluara me legjislacionin sekondar dhe pakon e udhëzuesve për implementimin e SC.


10.1.3 Sigurimi i brendshëm i cilësisë në arsimin e lartë

Institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen vetëvlerësimit të rregullt dhe kanë organe të veçanta të cilat i kryejnë këto procese. Është e detyrueshme që të gjitha IAL e akredituara të krijojnë dhe funksionalizojnë njësitë e sigurimit të cilësisë ose zyrat të cilat janë përgjegjëse të kryejnë në baza të rregullta vlerësimin studentor të kurseve, sondazheve, analizave dhe përgatitjen e vetëvlerësimit.

IAL private zakonisht kanë zyra për sigurimin e cilësisë, të cilat koordinohen nga koordinatorët, ndërsa IAL publike kanë zëvendësrektorët për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë rregullohet kryesisht nga statutet e IAL, rregulloret e veçanta ose në disa raste nga strategjitë për sigurimin e cilësisë.

Sa i përket sigurimit të brendshëm të cilësisë të IAL, nëpërmjet procesit të akreditimit, AKA siguron që të gjitha IAL dhe programet e tyre të studimit kanë sistem të sigurimit të cilësisë për mësimdhënie, hulumtim dhe shërbime.

Diagrami në vijim prezanton Modelin e Cilësisë së AKA-së. Ky cikël është i bazuar në katër hapa.


Institucioni aplikues
Agjencia e Akreditimit e Kosovës/AAK
Aplikimi
Pajtueshmëria e IAL për përbërjen e ekipit të ekspertëve
Kontrolli i kritereve bazë të aplikimit
Plotësimi i aplikacionit
Përzgjedhja e ekspertëve
Vizita në institucion
Komentet në RE
Raporti i Ekspertëve/RE
Vendimi për akreditim/KKC

Diagrami në vijim prezanton Modelin e Cilësisë së KKSC-së. Ky cikël është i bazuar në katër hapa:



Monitorimi

11. MONITORIMI

11.1 Monitorimi i insitucioneve të arsimit të përgjithshëm

Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA) është përgjegjës për mbledhjen, hartimin dhe përpunim e statistikave të arsimit. Për më tepër, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë nëpërmjet monitorimit dhe raportimit mbi menaxhimin dhe funksionimin e arsimit në komuna. Ato janë, gjithashtu, përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe inspektimin e procesit të arsimit në përputhje me udhëzimin e lëshuar nga MAShT.
Vlerësimi dhe monitorimi i jashtëm i shkollave kryhet nga Departamenti i Inspektoratit të Arsimit.

Procesi i inspektimit kryhet në mënyrë që të sigurohet:

• Pajtueshmëri me detyrat dhe funksionet përkatëse të institucioneve në përputhje me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi;
• Funksionimi i kënaqshëm i trupit drejtues të institucionit, këshillat e prindërve dhe nxënësve, operacionet financiare, saktësia e regjistrave të numrit të nxënësve sipas nivelit dhe shkallës, saktësia e dokumenteve pedagogjike dhe shkollore, organizimi i klasave dhe ekzaminimet e jashtme;
• Numri, kualifikimi dhe angazhimi për zhvillimin profesional të stafit;
• Mjedisi i punës, përfshirë këtu përputhjen me standardet shëndetësore dhe të sigurisë së nxënësve dhe stafit, mbajtjen e të dhënave për veprimet disiplinore dhe rezultatet e tyre;
• Përputhshmëria me Kornizën Kurrikulare të Kosovës, përfshirë këtu kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën e bazuar në shkollë, vlerësimin dhe procedurat e brendshme të ekzaminimit si dhe përdorimin e teksteve të miratuara, burimet arsimore të mësimnxënies dhe materialet e mësimnxënies.

11.2 Monitorimi i institucioneve të AAP

Zbatimi i procesit të monitorimit të IAAP-it nga AKK përcaktohet me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. Procesi i monitorimit zbatohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të cilat në mënyrë të qartë përshkruajnë kërkesat e përputhshmërisë për IAAP të cilat duhet të monitorohen nga AKK.
Monitorimi është proces i kontrollit të cilësisë dhe zbatohet periodikisht dhe përmbledh informacione sasiore dhe cilësore në mënyrë sistematike. Procesi i monitorimit përfshinë rishikimin dhe raportimin mbi të gjeturat për implementimin e SC.
Përveç monitorimit të vazhdueshëm ka edhe monitorim sipas nevojës (ad hoc) dhe bëhet qoftë me apo pa paralajmërim. Monitorimi realizohet nga ekspertët për sigurim të cilësisë dhe ekspertë të kualifikimeve. Kjo i mundëson AKK që të ketë pasqyrë të qartë për vlerësimin e performancës në IAAP. AKK, mbi këtë bazë, bën radhitjen e IAAP, ndërsa, në rast të dështimit të përmbushjes së kritereve të përcaktuara me rastin e akreditimit, institucionit përkatës mund ti tërhiqet akreditimi.
Procesi i monitorimit ofron qasje përkrahëse dhe këshillëdhënëse për IAAP, për veprime efektive që duhet të ndërmerren për ta siguruar cilësinë. Për këtë qëllim, është zhvilluar udhëzuesi për monitorimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimi profesional (IAAP), i cili ka për qëllim përcaktimin e procedurave të monitorimit të IAAP të akredituara nga AKK.

11.3 Monitorimi i institucioneve të AL

AKA bën monitorimin e cilësisë në IAL përmes kontrollit periodik, i cili konsiston në dy vizita brenda vitit. Ky proces performohet nga ekspertë ndërkombëtarë të cilët angazhohen nga AKA. Përmes këtij procesi Këshilli Shtetëror i Cilësisë(KShC) i AKA merr vendim në bazë të gjetjeve në raporteve.

AKA përmes udhëzuesve dhe standardeve për monitorim do ti delegojë përgjegjësitë e monitorimit te zyrtarët e saj profesional. Përveç AKA, procedura të monitorimit dhe inspektimit kryen edhe Inspektorati i Arsimit.

FJALOR I TERMAVE

12. FJALOR I TERMAVE

Përkufizimet e përgjithshme:

AKREDITIMI - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit autoriteti përgjegjës i njeh dhe autorizon institucionet/ofruesit që ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë kualifikime të validuara në KKK. Institucionet e akredituara duhet të jenë objekt i monitorimit dhe auditimit nga autoritetet gjegjëse.

APROVIMI - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit autoriteti përkatës i njeh kualifikimet. Aprovimi jepet për një periudhë të caktuar dhe në fund të kësaj periudhe, kualifikimi duhet ti nënshtrohet riaprovimit.

VALIDIMI - përfshinë procesin në të cilin kualifikimet i nënshtrohen vlerësimit nëse i plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në KKK.

ANKESA - nënkupton kërkesën formale e cila bëhet nga një institucion/ofrues apo individ rreth një vlerësimi ose vendimi apo akt tjetër formal.

VLERËSIMI - i referohet proceseve, përfshirë provimet dhe testet, që shfrytëzohen për të mbledhur, interpretuar dhe vlerësuar dëshminë në mësim të individit. Vlerësimi për kualifikime mund të kryhet vetëm nga institucionet e akredituara.

KANDIDATI (për kualifikim) - është çdo person që kërkon të certifikohet për të arriturat në mësim, të përfituara qoftë nëpërmjet mësimit formal, joformal ose atë informal.

NXËNËSI - nënkupton çdo individ të regjistruar në cilindo program të arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

INSTRUKTOR - është personi i angazhuar në zbatimin e mësimit praktik në institucionin e akredituar të arsimit dhe aftësimit profesional ose teknik.

DIPLOMA - është dokument i cili lëshohet nga një institucion arsimor për të dëshmuar se individi ka fituar një gradë, apo një cikël të plotë ose ka përfunduar me sukses një program të caktuar të studimit.

CERTIFIKATA - nënkupton çdo dokument që jepet pas përfundimit të suksesshëm të kursit, programit të arsimit ose aftësimit ose pas dhënies së provimeve në institucionin e arsimit dhe aftësimit.

CERTIFIKIMI - është proces i njohjes së të arriturave të kandidatëve për kualifikim nëpërmjet dhënies së certifikatës ose diplomës.

DIPLOMA DHE SHTESA E DIPLOMËS - është një dokument që përshkruan njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga individët dhe jep informacione shtesë për atë që përfshihet në gradën/diplomën dhe/ose transkriptimin, duke e bërë më të lehtë kuptimin, veçanërisht nga punëdhënësit apo institucionet jashtë vendit.

KOMPETENCA - është aftësia për ti kryer aktivitetet kundrejt standardeve të kërkuara, duke përdorur njohuri të duhura praktike dhe teorike, shkathtësi kreative dhe praktike.

KREDITI - është një vlerë numerike që i jepet kualifikimit ose pjesëve të kualifikimit dhe që paraqet vëllimin e të mësuarit të nevojshëm, për ta arritur kualifikimin ose një pjesë të kualifikimit. Kreditë mund të akumulohen gjatë një kualifikimi ose mund të transferohen në mes kualifikimeve ose sistemeve të kualifikimit.

AKUMULIMI I KREDIVE - i referohet faktit se ato mund të akumulohen gjatë një periudhe të kohës deri në arritjen e kredive të mjaftueshme për dhënien e një kualifikimi të plotë.

TRANSFERI I KREDIVE - i referohet procesit të njohjes së kredive të fituara të një individi nga një institucion në një institucion tjetër.

VLERA E KREDISË - është vlera numerike e cila i jepet kualifikimit ose pjesës së kualifikimit brenda sistemit të kredisë.

SISTEMI I KREDIVE - është sistem i përgjithshëm në të cilin mund të akumulohen ose transferohen kreditë drejt kualifikimeve.

NJOHJA E MËSIMIT PARAPRAK - nënkupton procesin e vlerësimit të njohurive, shkathtësive ose kompetencave më të gjëra, të cilat një individ i ka arritur më herët nëpërmjet mësimit formal, joformal ose informal.

ECTS - SISTEMI EVROPIAN I AKUMULIMIT DHE TRANSFERIMIT TË KREDIVE - është një standard për krahasimin e arritjeve dhe performancës së studentëve të arsimit të lartë në Bashkimin Evropian dhe vendeve të tjera evropiane. Për studimet e përfunduara me sukses, jepen kreditë ECTS. Një vit akademik korrespondon me 60 kredi ECTS, të cilat janë të barasvlershme me 1500 - 1800 orë mësimi, në të gjitha vendet pavarësisht nga standardi ose lloji i kualifikimit dhe përdoret për ta lehtësuar transferimin dhe përparimin përgjatë Bashkimit Evropian.

ECVET - SISTEMI EVROPIAN I KREDIVE PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL - synon ta lehtësojë validimin, njohjen dhe akumulimin e shkathtësive të lidhura me punë dhe njohuri, duke krijuar një kornizë teknike për ti përshkruar kualifikimet në kuadër të njësive, të rezultateve të mësimit, përfshirë procedurat e vlerësimit, transferimit, akumulimit dhe njohjes. Secila njësi është e shoqëruar me numër të caktuar të pikëve - kredive ECVET, të zhvilluar mbi bazën e standardeve të përgjithshme: 60 pikë ECVET janë vendosur për rezultatet e mësimit të arritura në një vit të AAP me kohë të plotë studimi.

KURRIKULI - përvoja e të nxënit gjithëpërfshirës e planifikuar në bazë të qëllimeve, vlerave, iniciativave, burimeve dhe aktiviteteve në rregullimet formale dhe joformale.

MATURA SHTETËRORE - është provim përfundimtar i standardizuar, i monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë që ta dëshmojë përfundimin e nivelit të shkollës së mesme të lartë, e cila dëshmon nivelin e njohurive të kandidatit për punë dhe vazhdimin në arsimin terciar në përputhje me procedurat përkatëse të regjistrimit.

MËSIMI GJATË GJITHË JETËS - është ndërtim i vazhdueshëm dhe zhvillim i shkathtësive dhe njohurive përgjatë jetës së një individi, që përfshinë të gjitha veprimtaritë e mësimit që ndërmerren gjatë gjithë jetës për zhvillimin e kompetencave dhe kualifikimeve, qoftë në ambiente formale apo informate.

MËSIMI FORMAL - të mësuarit që ndodh në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar (si në një institucion arsimor, aftësues ose në punë) dhe përcaktohet shprehimisht si proces i të mësuarit (në kuptim të objektivave, kohës ose burimeve). Mësimi formal është i qëllimshëm nga pikëpamja e individit. Kjo zakonisht çon në certifikim.

MËSIMI JOFORMAL - është i përfshirë në aktivitetet e planifikuara që nuk janë përcaktuar shprehimisht si mësim (në kuptim të objektivave të mësimit, kohës së mësimit ose mbështetjes së mësimit), por që përmban një element të rëndësishëm mësimi. Mësimi joformal është i qëllimshëm nga pikëpamja e individit. Ky zakonisht nuk çon në certifikim.

MËSIMI INFORMAL - të mësuarit që rezulton nga aktivitetet e përditshme që lidhen me punën, familjen ose kohën e lirë. Nuk është i organizuar ose i strukturuar në aspektin e objektivave, kohës ose mbështetjes së mësimit. Mësimi joformal në shumicën e rasteve nuk është qëllim parësor nga perspektiva e individit.

NIVELET (e kualifikimit) - janë nivele të përcaktuara në kuadër të hierarkisë së Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve - nivelet janë të modifikuara duke ngritur kompleksitetin, intensitetin dhe pavarësinë e mësimit.

PËRSHKRUESIT E NIVELIT - janë sqarim i kritereve që përshkruajnë rezultatet e mësimit për përcaktimin e nivelit të kualifikimit.

TREGUESIT E NIVELIT - janë sqarim i kualifikimeve dhe specifikave të tyre sipas niveleve rreth përmbajtjes, llojit, kohëzgjatjes, etj.

MODULI - është pjesë përbërës i kualifikimit, i cili paraqet pjesën më të vogël të kualifikimit i cili mund të certifikohet. Moduli përbëhet nga një mori njohurish, shkathtësish dhe kompetencash të kuptueshme, të shprehura në formë të rezultateve të mësimit dhe kritereve të ndërlidhura të vlerësimit.

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE (KKK) - është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas një grupi të kritereve që i përcaktojnë nivelet dhe llojet e rezultateve të mësimit.

KORNIZA EVROPIANE E KUALIFIKIMEVE KEK - është mekanizëm që ka për qëllim ti bëjë kualifikimet kombëtare më të lexueshme në të gjithë Evropën, duke promovuar lëvizjen e fuqisë punëtore dhe të nxënësve/kandidatëve mes vendeve dhe për ta lehtësuar mësimin e tyre gjatë gjithë jetës.

SISTEMI I KUALIFIKIMEVE - i referohet tërë sistemit brenda të cilit kualifikimet jepen dhe certifikohen, i cili përfshinë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe aranzhimet për rregullimin e dhënies së kualifikimeve.

AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE (AKK) - është agjenci e krijuar me ligj, e cila e hartuar Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe rregulluar Sistemin e Kualifikimeve Kombëtare (Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

OFRUES - do të thotë çdo institucion ose strukturë tjetër e autorizuar që ofron shërbime arsimore të nivelit në arsim të lartë (Rregullorja Nr. 2003/14, sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës).

KUALIFIKIMI - është njohje zyrtare e të arriturave, me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimit, ose realizimi i kënaqshëm në një test ose provim" (Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

TITULLI I KUALIFIKIMEVE - Tregon emrin e kualifikimit dhe fushën e tij të mbulimit (fushën profesionale ose lëmine), llojin e tij dhe nivelin në KKK.

CILËSIA - i referohet natyrës ose karakterit të një gjëje, të cilës i jepet një vlerë e caktuar. Kjo paraqet matjen e përsosmërisë ose gjendjen e të qenit i lirë nga defektet, pa- mjaftueshmërinë ose variacionet e rëndësishme dhe, në kontekstin e arsimit dhe aftësimit, mund të matet në kuadër të faktorëve të tillë si; efikasitet dhe efekteshmëri e ofrimit të arsimit dhe shkallën e mjaftueshmërisë në pjesë të nxënësve dhe aktorëve.

MONITORIMI - është proces i kontrollimit të ndonjë gjëje për një periudhë, në mënyrë që të shikohet se si është zhvilluar, që të mund të bëhet ndonjë ndryshim i domosdoshëm. Në këtë mënyrë, monitorimi përbën një proces të vazhdueshëm të mbledhjes së informacioneve sasiore dhe cilësore në mënyrë sistematike. Monitorimi përfshinë rishikimin dhe raportimin për sigurimin e cilësisë së ofruesit dhe institucionit dhënës nga një agjenci kombëtare ose organ ligjor.

KORNIZA KOMBËTARE E SIGURIMIT TË CILËSISË PËR AAP - struktura e përdorur nga ministritë, institucionet kombëtare, autoritetet dhe agjencitë për ta përcaktuar dhe siguruar nivelin e cilësisë të kualifikimeve profesionale, është bazuar në një numër të parimeve të cilësisë. Një mori e kritereve të cilësisë ku secili parim i cilësisë përcakton nivelin e pritur të përmbushjes. Korniza përbëhet nga komponentë të ndryshëm, të cilët së bashku mbulojnë të gjitha aspektet e kualifikimeve profesionale: akreditimin e kualifikimeve, aprovimin e ofruesve, licencimin e personelit, certifikimin e nxënësve, inspektimin e ofruesve/bartësve dhe vetëvlerësimin e ofruesve.

KKSC - është KORNIZA KOMBËTARE E SIGURIMIT TË CILËSISË PËR AAP NË EVROPË, e miratuar nga Komisioni Evropian në maj 2004.

SIGURIMI I CILËSISË - nënkupton procesin përmes të cilit mirëmbahet cilësia dhe pajtueshmëria e standardeve të kualifikimit, vlerësimit dhe certifikimit (Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

VETËVLERËSIMI - është një proces brenda të cilit një person ose institucion reflekton performancën e vet dhe i vlerëson dëshmitë para prezantimit të tyre për gjykim. "Vetëvlerësimi" zakonisht përdoret në kornizën e sigurimit të cilësisë për t'iu referuar procesit me të cilin institucionet ofruese vlerësojnë performancën e tyre, kundrejt kërkesave të standardeve ose treguesit tjetër të performancës, si bazë për identifikimin dhe zhvillimin e strategjive të përmirësimit.

TREGUESIT E PERFORMANCËS - është pakoja e informacioneve e dizajnuar për ti definuar sjelljet e pritura apo për të treguar veprime. Treguesit e performancës kyçe janë niveli i krahasueshmërisë sasiore kombëtare, kundrejt të cilit ofruesit mund ta matin performancën e tyre.

PARTNERËT SOCIALË - janë organizatat që përfaqësojnë në mënyrë kolektive punëdhënësit dhe punëtorët (Ligji Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

REZULTATET E MËSIMIT - secila njësi ose modul i kualifikimit përbëhet nga rezultatet e mësimit. Rezultatet janë detyrat ose funksionet që përshkruajnë; çfarë dhe si duhet të performojnë nxënësit për të demonstruar se ata janë kompetentë në atë njësi apo modul.

STANDARDET - janë tregues të matshëm të të arriturave, që caktohen sipas kritereve kualitative ose kuantitative dhe duhet të arrihen nga kandidatët që duan të kualifikohen (Ligji Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

STANDARDET PROFESIONALE - janë njësi për ta matur shkallën deri në të cilën një individ mund ti përmbushë kërkesat për realizim në një profesion të veçantë ose grup profesionesh, me qëllim që të hyjë ose përparojë në kuadër të një profesioni ose fushës përkatëse profesionale. Ato caktohen në nivelin kombëtar për individët e punësuar, që punojnë brenda një profesioni ose fushe profesionale të veçantë, si dhe ofrojnë bazën për zhvillimin e kurrikulës profesionale dhe vlerësimit. Çdo pako e standardeve është e lidhur me një profil profesional në të cilin bazohet kurrikula" (Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, nr. 02/L-42, shkurt 2006).

MËSIMDHËNËSI - është personi i kualifikuar me përvojë pedagogjike dhe profesionale, që i mëson nxënësit në institucionin e arsimit profesional për lëndët e përgjithshme ose profesionale (Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, nr. 02/L-42, shkurt 2006).

VERIFIKUESI I BRENDSHËM - është përgjegjës për verifikimin e vlerësimit në nivel të ofruesit dhe për hartimin e raporteve të verifikimit të brendshëm.

VERIFIKUESI I JASHTËM - është përgjegjës për monitorimin e vlerësimit dhe procedurave të verifikimit të brendshëm të ofruesit. Verifikuesi i jashtëm harton raporte të verifikimit të jashtëm për institucionin përgjegjës për dhënien e kualifikimeve dhe sigurimin e informatave kthyese për ofruesin.

ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL (AAP) - është arsim dhe aftësim që synon pajisjen e njerëzve me shkathtësi të punësimit. Termi mund të përdoret për t'iu referuar sistemit për sigurimin e arsimit dhe aftësimit që pajis njerëzit me shkathtësi të punësimit.

AFTËSIMI PROFESIONAL - përfshinë të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim të ofrojnë njohuri dhe shkathtësi praktike, për realizim efikas të aktiviteteve, në kuadër të një profesioni ose grupi profesionesh (Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr. 02/L-42, shkurt 2006).

13. Shtojcë

AKK beson se puna e bërë në plotësimin dhe ndryshimin e këtij dokumenti u ofron mundësi të gjitha palëve të interesuara, dhe të gjithë atyre që do të përfshihen në sistemin e kualifikimeve në Kosovë për periudhën e ardhshme afatmesme. Ky dokument pasqyron zhvillimet në sistemin kombëtar të kualifikimeve dhe është në linjë me kërkesat e tregut të punës dhe trendet evropiane.

Duke pas parasysh se, sistemi i kualifikimeve është dinamik dhe i ndryshueshëm, krahas zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve do të angazhohet që KKK ti adresojë kërkesat dhe nevojat e sistemit kombëtar të kualifikimeve edhe në të ardhmen.

Grupi bërthamë për rishikimin dhe plotësimin e KKK

- Lah Nitaj	AKK
- Milot Hasangjekaj	AKK
- Bleta Kadriu	AKK
- Kaltrina Mulliqi	AKK
- Donjeta Nimani Binçe	AKK
- Anita Rukovci	AKK
- Avni Gashi	AKA
- Teuta Danuza	Konsulente e jashtme

Kontribuuesit tjerë - Gjatë rishikimit dhe plotësimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve janë organizuar takime, punëtori, konsulta me shume institucione dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe aftësimit në Republikën e Kosovës, të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar. Me idetë, propozimet dhe plotësimet e tyre e kanë pasuruar përmbajtjen e këtij dokumenti.

Duke qenë se në këtë proces kanë qenë të përfshirë një numër i madh i institucioneve dhe personave kontribuues, me këtë rast duam të shprehim mirënjohjen dhe falënderimin tonë për: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe ministritë e linjës; Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Financave. Poashtu, ndihmë të vyer kanë dhënë edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve, Agjencia e Punësimit e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, HandiKos, shkollat profesionale, universitetet publike, kolegjet private, qendrat e aftësimit profesional, partnerët tjerë socialë, organizatat e ndryshme evropiane si dhe partnerët tanë zhvillimorë, etj.

Në mënyrë të veçantë falenderojmë për kontributin e dhënë anëtarët e grupeve punuese:

- Blerina Vula
- Drita Rezniqi
- Sauda Pantinaj
- Bastri Maloku
- Arta Kollqaku
- Elmi Kelmendi
- Fisnik A. Gashi
- Hajrije Shaipi
- Ejup Zariqi
- Agim Mjaku
- Besim Ilazi
- Ramush Kurti
- Bejtë Çela
- Valbonë Beka
- Likana Celina
- Aurora Zuna Krasniqi
- Hajriz Neziri
- Donikë Maxharaj
- Luljeta Kabashi
- Agron Hajdari
- Darsej Rizaj
- Abdurahman Simnica
- Binak Gërguri
- Skender Berisha
- Burim Ahmeti
- Muhamer Ibriqi
- Radica Berishaj
- Ajvaz Rama
- Petrir Hasanaj
- Zenel Bunjaku
- Mimoza Jashari
- Sami Rama
- Vildane Kelmendi
- Majlinda Qato
- Neserete Juniku
- Fatmire Salihu
- Ahmet Mustafa
- Burhan Selmani
- Sinan Gashi
- Dëshira Mustafaj
- Almira Selmani
- Rrahman Sefedini
- Mërgim Mestani
- Zejnullah Rrustemi
- Aferdita Jaha
- Albënore Durmishi
- Ramadan Dërvishi
- Majlida Rizvanolli
- Vehbi Neziri
- Petrit Olluri
- Sylë Kasumaj
- Mehreme Llumnica
- Ilmi Sijarina
- Dardan Shala
- Alba Besimi
- Anyla Zajmi
- Safet Emini
- Nita Selimi
- Ahmet Gashi
- Blerim Haliti
- Jetmir Berisha
- Ryve Prekorogja
- Ferdeze Agaj Mehmeti
- Gëzim Berisha
- Valbona Kadrijaj
- Gani Ismajli
- Agon Jusufi
- Entela Ademi
- Genta Xheladini
- Besnik Skenderi
- Shahin Ahmetxhekaj
- Gëzim Bekqeli
- Besart Kostanica
- Ramë Likaj
- Valbona Fetiu Mjeku
- Shaban Tërstena
- Agim Krasniqi
- Bleta Zeqiri
- Shkëlzen Gërxhaliu
- Shkëndije Thaqi
- Arta Sylejmani
- Hajdar Shyti

- Blerim Jahiu
- Imrane Ramadani
- Qemajl Ahmeti
- Rrustem Gashi
- Faruk Kukaj
- Edlira Hetemaj
- Hazir Gashi
- Fetije Huruglica
- Georg Brugger
- Binak Morina
- Lulzim Krasniqi
- Sanije Bajrami
- Rexhë Gashi
- Florim Metaj
- Diedon Ahmetaj
- Anton Gojani
- Luan Sopi
- Tomë Frrokaj
- Gëzim Isufi
- Donika Berisha
- Afrim Tejeci
- Agim Tahiri
- Fadil Avdyli
- Besim Mustafa
- Alma Murati

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Adresa: Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p. n.
Prishtinë, 10000, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 212-595
Fax: +383 (0) 38 213 433
www.akkks.rks-gov.net